

dhuna e maj gray në familje në Shqipëri


si të eksploroje
Raport i përgatitur nga Adriana Bahan

unicef 
United Nations Children's Fund

Një studim i dedikuar
grave viktima të dhunës në familje,
si një herë publik për vrasjet,
fardën dhe gjurmën e tyre.

Adriens Saben

PARATHËNIE	
FALËNDERIME	
PËRMBLEDHJE	
HYRJE	
KONTEKSTI SHQIPËTAR	
QËLLIMET E STUDIMIT DHE METODOLOGJIA	
Objektivat	
Pjesëmarrësit në studim	
Metodat	
Procedura	
Analiza e të dhënave	
PËRFUNDIME	
Ëndra për martesë	
Martesa si ideal	
Martesa si shpëtim	
Martesa si normë	
Përballimi me realitetin	
Marrëdhëniet gjinore dhe jeta shtëpiake	
Pabarazia gjinore në rolet familjare	
Procesi i marrjes së vendimeve	
Dhuna e ushtruar	
Abuzim psikologjik	
Kërcënime fizike dhe verbale	
Dhunë fizike	
Terrorizim	
Dhunë seksuale	
Izolim social	
Abuzim ekonomik	
Të qenit grua e abuzuar	
Trupi dhe dhuna	
Trajtimi i traumës	
Jetesa me pasojat	
Shqetësimi për fëmijët	
Fëmijët si viktima	
Vështirësitë si prind	
Humbja e pafajësisë së fëmijërisë	
Përballimi i dhunës	
Arsyet e dhunës	
Ndjenja e zënies në kurth	
Negocijimi për një identitet të ri	
Thyerja e heshtjes	
Fuqizimi i grave	
Hapsira sociale për dhunën	
KONKLUSIONE	
SHTOJCA 1	
BIBLIOGRAFIA	



Heshtja është armik. Dhuna në familje mbroth në vetminë e shtëpisë, shkatërron viktimat e veta dhe mbjell farë tek të rinjtë dëshimtarë të brezit të ardhshëm. Të dhënat paraprake tregojnë se kjo dhunë – e shfajësuar si sjellje e keqe por që në realitet është një akt kriminal – është mjaft e përhapur dhe në rritje, si rezultat i rënies në vakumin shoqëror të krijuar nga tranzicioni.

Ky studim për situatën e grave në lidhje me abuzimet në familje, është pjesë e përpjekjeve të UNICEF për ta vendosur këtë çështje në krye të programeve të shoqërisë. Vetëm kështu kjo çështje që përbën kërcënim publik për shkatërrimin e të ardhmes së Shqipërisë, nuk mund të injorohet nga udhëheqësit e vendit dhe mund të trajtohet siç duhet.

Roberto Laurenti
Përfaqësues i UNICEF në Shqipëri

Ky studim u realizua si një nismë e përbashkët e UNICEF-it, Shqipëri dhe Institutit të Studimeve të Opinioneve Publikë. Falenderoj në mënyrë të veçantë Judith Léveillé, oficerë e projektit 'Të rinjtë dhe çështjet gjinore', për mbështetjen dhe ndihmesën e saj të vazhdueshme. Ajo gjithashtu kontribuoi me sugjerimet dhe komentet e saj konstruktive gjë që e përmirësuan mjaft raportin përfundimtar. Shpreh mirënjohjen time të veçantë edhe për Dr. Lenin Guzman, kordinator programi, për mbështetjen e vlefshme dhe dashamirëse gjatë kohës që isha në Shqipëri, si dhe gjatë gjithë studimit.

Dëshiroj të falenderoj Profesor Edmond Dragotin, Drejtor i 'Institutit të studimeve të opinionit publik', për mbështetjen e tij gjatë studimit si dhe për kryerjen e punës brenda afatit dhe me cilësi. Gjithashtu dua të shpreh falënderimet e mija të përzemërta për kolegët e institutit që ai drejton, mbështetja teknike e të cilëve ishte me shumë vlerë.

Falenderoj Denada Hoxhën për punën e shkëlqyer në seminarin e kualifikimit për punonjësit e terrenit, për përkthimin profesional nga anglishtja në shqip.

Do të doja të falënderoja ekipin vendas të studimit, për profesionalizmin dhe entuziazmin e tyre, dhe veçanërisht Nazire Bidollari, Zana Nikolla, Fatbardha Kaduku dhe Manushaqe Tabaku, për punën e tyre të përgjegjshme dhe të realizuar me sukses, pavarësisht vështirësive sociale dhe psikologjike.

Falënderime edhe për kolegen time Aurora Szentagotai komentet e të cilës i dhanë raportit informacion të detajuar për analizën e të dhënave.

Së fundmi, do të doja të përmendja bujarinë e atyre grave që pranuan të intervistoheshin dhe të tregonin përvojat e tyre të dhimbshme. Ky studim nuk do të ishte bërë i mundur pa gatishmërinë e tyre për pjesëmarrje. Ne u jemi mirënjohës për angazhimin dhe kontributin e tyre. **A.B.**

Hyrje

Dhuna ndaj grave, ndonëse është shkelja më e përhapur e të drejtave të njeriut në botë, vazhdon të jetë më pak e vlerësuar. Dhuna është gjithashtu një problem i thellë shëndesor që ka pasoja vdekjen dhe plagosjen, cënon mirëqenien e grave dhe shkatërron dinjitetin dhe vetëvlerësimin e tyre. Tashmë dihet se dhuna në familje i kapërcen të gjitha kufijtë dhe është prezente në të gjitha kulturat. Studimet e kryera për dhunën në familje kanë vërtetuar se abuzimi ndaj grave është një problem kompleks dhe shumë dimensional. Shpjegimi për këtë duhet parë tek faktorët kulturorë, shoqërorë, familjarë dhe individualë, që ndikojnë në mundësitë që gratë të bëhen viktimat e dhunës.

Historik

Si rezultat i traditave të forta patriarkale të Ballkanit, shoqëria shqiptare ka qënë historikisht e dominuar nga meshkujt. Grave u është diktuar prej kohësh që të pranojnë rolin e të nënshtruarave. Gjatë regjimit komunist u krijua një hendek i thellë midis teorisë për emancipimin e gruas dhe realitetit të saj përditshëm. Më 1991, pas përmbyesjes së rregjimit komunist, Shqipëria kaloi një periudhë ndryshimesh të mëdha, shpesh herë dramatike sociale, politike dhe ekonomike që ka krijuar një ndikim të thellë në jetën e shqipëtarëve. Barazia gjinore është për shoqërinë shqiptare një princip i ri, që nuk është përqaftuar ende nga një përqindje e konsiderueshme e popullsisë.

Qëllimet e studimit

Në Shqipëri nuk janë bërë për një kohë të gjatë studime për dhunën në familje. Si një hap përpara në drejtim të rritjes së njohurive në këtë drejtim, ky studim eksplorues për dhunën në familje në Shqipëri, synon të: (i) identifikojë gamën e formave më të zakonshme të dhunës së ushtruar brenda familjes; (ii) bëjë të ditur se cilat sjellje janë abusive sipas perceptimit të

grave dhe në ç'rrethana; (iii) zbulojë se ç'strategji përdorin gratë për t'i dhënë fund dhunës apo për të zvogëluar pasojat e saj; (iv) dokumentojë pasojat e dhunës në familje tek gratë, fëmijët, vetë familja dhe e gjithë shoqëria; (v) identifikojë qëndrimet e grave përkundrejt abuzuesve të tyre dhe marrëdhënieve abuzive; (vi) përcaktojë kufizimet sociale që i privojnë shumë gra nga barazia me burrat në sferën private.

Metodologjia

Për këtë studim u kryen intervista të thelluara me 55 gra viktimat e dhunës, nga qyteti i Tiranës, Shkodrës dhe Beratit. Qëllimi i kampionimit ishte gjetja e grave me prejardhje sociale të ndryshme si dhe me karakteristika të ndryshme demografike. Udhëzuesi për intervistat përfshin një shumicë pyetjesh të hapura për përvojën që gratë kishin patur në lidhje me abuzimin. Të gjitha intervistat u regjistruan në kasetë dhe më pas u shkruan. Analiza e intervistave u bë sipas teknikës së zbërthimit tematik, kryesisht sipas analizës fenomenologjike dhe atë të bashkëbisedimit. Për gjetjen, përpunimin dhe kodimin e të dhënave u përdor programi 'The Atlas.ti' i kompjuterit.

Përfundime

Si rezultat i analizës që u bë intervistave, sidomos për të gjetur tek rëfimet e grave ngjashmëritë, u evidentuan shtatë grupime kryesore temash. Midis tyre ka edhe përputhje me njëra-tjetrën.

Ëndra për martesën

Shumica e grave e kuptojnë martesën si një qëllim në jetë, megjithëse disa përmendin se motivi i tyre për t'u martuar ka qënë dëshira për t'u larguar nga shtëpia e prindërve, varfëria apo dhuna. Nga bashkëbisedimi me gratë, martesa përshkruhet si një normë dhe gjendje e dëshiruar

për statusin social të grave. Akoma ekziston tradita patriarkale e martesave me shkes. Gratë presin që martesa t'u krijojë mundësinë për një jetë të mirë dhe të lumtur, por shumë shpesh ajo u shëndrohet në një tablo poshtërimi, tensioni, kërcënimi dhe konflikti, dhe jo mundësi për plotësimin e ëndrave.

Përballimi me realitetin

Për shumë gra, realiteti është krejt i ndryshëm nga ëndra e tyre për një martesë ideale. Rezultatet e studimit tregojnë se burrat e dhunshëm janë pró roleve dhe përgjegjësive tradicionale familjare. Bashkëshortët e dhunshëm rezultojnë se janë imponues në marrjen e vendimeve familjare, ndërkohë që për gratë duan që t'i mbajnë shtëpinë, të kujdesen për fëmijët dhe t'u binden atyre. Një burrë mund të reagojë në mënyrë të dhunshme nëse bindet që gruaja e tij nuk e kryen si duhet rolin e saj, apo i kalon kufijtë e të drejtave duke ndërhyrë në kompetencat e tij. Gratë supozohet se duhet të kënaqen me rolin e tyre si bashkëshorte dhe nëna, dhe të pranojnë se duhet të sakrifikojnë edhe jetën e tyre për hatër të martesës.

Dhuna e ushtruar

Nga rëfimet e grave, rezultojnë se abuzimi është një fenomen kompleks dhe i formave të ndryshme që variojnë nga poshtërimi, kërcënimi, izolimi social, seksi me dhunë dhe rrahja. Dhuna ndaj grave bëhet e vazhdueshme dhe shpesh thellohet nga më e lehta në akte dhunë tepër serioze. Dhuna fizike fillon nga një shpullë e deri tek goditja me armë. Shumë gra jetojnë me frikë jo vetëm për jetën e tyre por edhe për jetën e fëmijëve dhe familjes së tyre. Përvoja e grave të dhunuara seksualisht vërteton se dhuna bëhet e vazhdueshme dhe varion nga forma jo fizike të saj si tallje, kërcënime, fjalë poshtëruese dhe presion për t'i detyruar të kryejnë seks pa dëshirën e tyre, e deri në rrahje dhe përdhunim. Dhuna fizike shpesh shoqërohet me tentativa për të kontrolluar ndërveprimet shoqërore të grave dhe lëvizjet e tyre. Disa burra i ndalojnë gratë që të shkojnë në punë. Pjesëmarrëset në studim përmendin si formë të abuzimit edhe abuzimin ekonomik. Kontributi financiar i grave në familje nuk ndikon apo zvogëlon pozitat dominuese të burrave të tyre në familje.

Të qenit grua e abuzuar

Dhuna fizike e vazhdueshme, e shoqëruar me abuzime emocionale, seksuale dhe ekonomike shkakton efekte të shumfishta tek gratë. Për disa gra, abuzimet bëhen aq të padurueshme sa fillojnë të mendojnë edhe vetëvrasjen. Pasoja e dhunës së burrave nuk janë vetëm mavijosjet, plagët dhe frakturat. Abuzimi është shkak i shumë gjymtimeve fizike, dështimeve dhe lindjeve të parakohëshme. Prandaj nuk është aspak çudi që gratë që janë abuzuar fizikisht, psikologjikisht apo seksualisht, kanë shqetësime emocionale. Shenjat më të zakonshme që përmendin gratë janë ankthi, depresioni, lodhja, nervozizmi, dhimbjet e kokës dhe probleme të mospërqëndrimit dhe pagjumësisë. Ato përmendin edhe ftohjen emocionale. Abuzimi i partnerëve shkatërron vetëvlerësimin e gruas dhe ndjenjën e kompetencës si person, grua, bashkëshorte, nënë dhe punonjëse. Disa gra i konsiderojnë pasojat psikologjike të abuzimit më serioze se efektet fizike të tij. Me kërkesën e partnerëve, gratë gjithashtu rrallojnë aktivitetet sociale. Këtë e bëjnë nga turpi ose për të mbrojtur fëmijët dhe miqtë.

Shqetësimi për fëmijët

Fëmijët janë tejet të ndikuar nga jeta në një mjedis dhune, frike dhe kërcënimi, pavarësisht nëse ata dhunohen ose jo fizikisht. Tek fëmijët krijohen shumë probleme emocionale, njohëse dhe të sjelljes. Nënata e tyre dëshmojnë se ata kanë rezultate të këqija në mësim, janë të turpshëm, shmangin kontaktet shoqërore, kanë ndjenjën e fajit, janë të acaruar dhe me sjellje agresive. Disa fëmijë kanë ankesa psikosomatike si dhimbjet e kokës dhe të barkut, ose shfaqin sjellje regresive si urinimi në krevat gjatë natës ose pagjumësi. Nënata janë tepër të shqetësuara se fëmijët e tyre do të përsërisin të njëjtat sjellje të dhunshme si edhe baballarët.

Përballimi i dhunës

Përfundimet tregojnë se gratë, bazuar në faktorët socialë, kulturorë, familjarë dhe personalë, përdorin strategji të ndryshme për t'ia dalë mbanë situatave abusive. Një hap i

rëndësishëm për përballimin e dhunës është procesi i njohjes së shkaqeve të saj. Megjithëse informatorët kanë identifikuar shkaqe të shumëfishta të dhunës në familje, gratë përpiqen ta shpjegojnë atë kryesisht të lidhur me ndryshimet e mëdha sociale që kanë ndodhur në Shqipëri pas vitit 1991. Dhuna e burrave ndaj grave paraqitet si një sëmundje mes shumë të tjerash. Nisur nga ky këndvështrim, natyra gjinore e dhunës nuk pasqyrohet ashtu si duhet. Shkaqe të tjera që përmenden shpesh janë përdorimi i alkoolit dhe xhelozia e burrave. Dhuna në familje krijohet edhe si rrjedhojë e problemeve emocionale të burrave si depresioni ose mungesa e vetë-vlerësimit. Disa gra të tjera i konsiderojnë burrat si qenie njerëzore agresive prej natyre.

Megjithatë janë gratë ato prej të cilave pritjet që të kujdesen për mbarëvajtjen e familjes, nuk është aspak çudi që 30 gra nga 55 të intervistuar besojnë akoma se ato duhet të sakrifikojnë nevojat e tyre personale për të rindërtuar marrëdhëniet dhe për ta mbajtur familjen të bashkuar, ndërkohë që 19 gra i kanë lënë partnerët e tyre. Burimet e pamjaftueshme që

grate kanë për të bërë jetë të pavarur, i pengojnë gjithashtu ato për t'u shkëputur nga marrëdhënie të tilla të dhunëshme. Gratë që i nënshtrohen marrëdhënieve abuzive fitojnë aftësi të tilla mbijetese si të shpresuarit, shmangia, arsyetimi i abuzimit duke e parë situatën nga një këndvështrim tjetër dhe kompromisi. Gratë që janë ndarë nga partnerët e tyre përpiqen në maksimum për të rigjetur vendin e tyre në shoqëri si dhe për të zbuluar mundësi të reja për jetën.


Thyerja e heshtjes

Nëpërmjet tregimit të historive të tyre, pjesëmarrëset në këtë studim thyen heshtjen që mbështjell dhunën në familje në Shqipëri. Dilemat personale të grave dhe vështirësitë e tyre për t'u shprehur për dhunën vihen re qartë në refimet e tyre. Ndërgjegjësimi i tyre për të kuptuar se heshtja është e gabuar, dhe se mbi të gjitha ato kanë mundësi të ndërmarrin hapa për ta përmirësuar situatën në të cilën ndodhen, janë strategjitë kyçe për zhdukjen e dhunës. Refimet e grave vënë në dukje kulturën e tolerancës ndaj dhunës në familje, gjë që reflektohet në besimin se dhuna midis njerëzve të afërt të familjes është një çështje private.

Konkluzione

Ky studim eksplorues prezanton kompleksitetin e kontekstit familiar në një kulturë patriarkale. Dëshmitë e këtij raporti vënë në dukje faktin se marrëdhëniet tradicionale gjinore u kushtojnë shtrenjt grave. Studimi zbulon mënyrat se si i rrezikon gratë ndaj dhunës pabarazia gjinore në Shqipëri, si dhe kompleksitetin e faktorëve kulturorë, socialë, ekonomikë dhe ndërpersonalë të këtij fenomeni. Përfundimet e studimit hedhin poshtë mitin se dhuna në familje është më tepër një problem i njerëzve të varfër dhe të pashkolluar. Ai vërteton se abuzimi

i kapërcen kufijtë social-ekonomikë. Dëshmitë e këtij raporti vënë në dukje se marrëdhëniet tradicionale gjinore përbëjnë një barrë të rëndë për këto gra. Megjithëse në vitet e fundit në Shqipëri kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme, gratë vazhdojnë të kenë statusin e të nënshtuarës. Intervistat vërtetuan tragjedinë shumë-vjeçare të jetës së grave, dëshmuar se disa prej tyre janë plagosur thellë nga dhimbja e fshehur, sikurse bënë të njohur edhe rezistencën e bërë nga shumë prej tyre.





Në mbarë botën, shkak kryesor i vdekjes dhe plagosjes së grave është dhuna e ushtruar nga partnerët e tyre (Mills, 1996). Ky është një problem serioz dhe me shtrirje të gjërë që i kapërcen të gjitha kufijtë dhe kulturat. Megjithatë, ekzistojnë disa shoqëri, sidomos në vendet në tranzicion, ku problemi ka mbetur pothuajse i padukshëm dhe shpesh nuk pranohet dhe nuk raportohet. Në ndryshim nga dhuna e rrugës, që në përgjithësi konsiderohet si krim, dhuna në familje ndaj grave dhe fëmijëve është parë si legjitime, e pranueshme, ndonjëherë edhe e dëshirueshme, ose injorohet për arsye se është dukuri që ndodh në sferën private të familjes. Të njëjtat akte të dënueshme nëse këto i drejtohen një punonjësi, të njohuri apo një personi çfarëdo, shpesh as që përfillen nëse i drejtohen grave brenda familjes. Megjithatë në dekadën e fundit, një numër gjithnjë e më i madh organizatash dhe insitucionesh, kanë pranuar se mund të luajnë një rol kyç në trajtimin e problemit të dhunës. Si një hap përpara për rritjen e njohurive në këtë fushë, ky studim synon të mbledhë informacion në lidhje me qëndrimet, perceptimet dhe ushtrimin e dhunës ndaj gruas në familje, në shoqërinë Shqipëtare.

Në lidhje me përkufizimin e dhunës në familje nuk ekziston ndonjë marrëveshje. Kjo pjesërisht për faktin se aktet e abuzimit kanë forma të ndryshme dhe se në to burrat dhe gratë përfshihen edhe si viktimas ashtu edhe si autorë të aktit. Megjithatë, statistikave zyrtare tregojnë se për gratë ka shumë më tepër gjasa se sa për burrat, që të jenë viktimas të abuzimit dhe të pësojnë dëmtimeve serioze nga bashkëshortët e tyre. (Reporti për popullsinë, 1999). Termi "dhunë ndaj grave" i referohet llojeve të ndryshme të sjelljeve të dëmshme ndaj grave dhe vajzave, për arsye të seksit të tyre. Në 1993, kur Asambleja e Përgjithshme përshtati Deklaratën për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, Kombet e Bashkuara hartuan përkufizimin e parë zyrtar për këtë lloj dhune. Sipas këtij përkufizimi dhuna ndaj grave përfshin: *çdo akt dhune me bazë gjininë, që sjell si pasojë ose që*

mund të sjellë si pasojë dëmtimin fizik, seksual ose psikologjik, ose që shkakton vuajtje tek gratë, duke përfshirë edhe kërcënimin për akte të tilla, detyrimin apo privimin arbitrar të lirisë, pavarësisht nëse këto ndodhin në publik apo në jetën private. (Raporti i OKB, 1993). Në këtë raport ne i referohemi dhunës në familje si dhunë që ushtrohet nga partnerët më të afërt dhe anëtarët e tjerë të familjes, dhe që manifestohet nëpërmjet:

Abuzimit fizik si shpulla, rrahje, përdredhje krahësh, goditje me thikë, mbytje, djegie, shkelmime, kërcënime me armë dhe vrasje. Këtu përfshihen gjithashtu edhe praktika tradicionale të dëmshme për gratë si ajo e kalimit të pasurisë së një të veje si dhe martesat e saj me vëllain e burrit të vdekur.

Abuzimit seksual si seks i detyruar me kërcënime, me forcë fizike dhe poshtërim, detyrim për akte seksuale të padëshiruara apo detyrim për të bërë seks me të tjerë.

Abuzimit psikologjik që përfshin sjellje që synojnë poshtërimin dhe persekucionin. Këto behen nëpërmjet kërcënimeve, abandonimit ose abuzimit, mbylljes në shtëpi, survejimeve, kërcënimeve se do t'i merret kujdestaria e fëmijëve, shkatërimin të objekteve, izolimit, agresionit verbal dhe poshtërimin.

Abuzimit ekonomik që përfshin akte si mohimi i fondeve, refuzimi për të kontribuar financiarisht, mohimi i ushqimit dhe i nevojave themelore si dhe kontrolli i përfitimit të kujdesit shëndetsor, punësimit, etj. (UNICEF, Innocenti Digest, 2000).

Gjithmonë e më shumë po pranohet se abuzimi ndaj grave duhet konsideruar brenda kuadrit 'gjinor' pasi rrënjët e ka pjesërisht në statusin e ulët të grave në shoqëri. Statusi i pabarabartë i grave është dukuri e përhapur në shoqëritë patriarkale. Dhuna në familje konsiderohet si dukuri që mbështetet nga mentaliteti tradicional dhe patriarkal. Marrëdhëniet bashkëshortore në

shoqërinë patriarkale nuk janë të barabarta. Burrat janë dominantë dhe konsiderohen si figura autoritare ndërsa nga grate, si 'seksi i dobët', pritët që të nënshtrohen dhe t'u binden burrave të tyre. Tendencat për t'i parë gratë në marrëdhënie me burrat si mbrapashtesa të tyre rikonfirmon të drejtën dhe detyrimin e burrit për të kontrolluar gruan e vet.

Studimet për dhunën në familje demonstrojnë se ky është një problem kompleks dhe multi-dimensional (Gelles, 1997). Shpjegimet për

këtë përfshijnë faktorë kulturorë, shoqërorë, familjarë dhe individualë që luajnë rol në rritjen apo zvogëlimin e mundësisë që gratë të bëhen viktima të dhunës. Shumica e studimeve për dhunën në familje janë kryer në vendet perëndimore. Në Shqipëri nuk është kryer për një kohë të gjatë ndonjë studim për dhunën në familje (Van Hook, Haxhiymeri and Gjermani, 2000). Gjatë regjimit komunist kjo çështje është konsideruar si tabu. Pas regjimit komunist Shqipëria pati prioritetet e tjera dhe për pasojë kjo çështje u studjua shumë pak.

Shqipëria, një vend me 3.2 milion banorë dhe që ndodhet në pjesën jugperëndimore të Gadishullit Ballkanik, ishte një nga vendet Europiane që njihej më pak. Nga viti 1944 deri në 1991 ishte nën kontrollin e një regjimi totalitar që e kishte izoluar vendin nga pjesa tjetër e botës. Me rrëzimin e regjimit komunist Shqipëria kaloi një periudhë të vështirë dhe shpesh herë dramatike të ndryshimeve sociale, politike dhe ekonomike. Pavarësisht nga reformat ekonomike dhe politike të ndërmarra nga qeveritë post-komuniste për ndërtimin e një sistemi demokratik, kushtet sociale, niveli i paunësisë dhe mesatarja e të ardhurave, janë nga më të ultat në Europë (Raporti i Bankës Botërore, 2002a). Si rezultat i faktorëve të shumtë historikë, politikë dhe ekonomikë, Shqipëria po përballlet si me probleme të trashëguara ashtu edhe të reja.

Si rezultat i traditave të forta patriarkale të Ballkanit, shoqëria Shqipëtare ka qënë e dominuar nga meshkujt për një kohë të gjatë, dhe grave u është diktuar që t'u binden burrave të tyre dhe të pranojnë rolin e të nënshtruarit (Gjipali & Ruci, 1994). Përpara Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria ishte një vend krejtësisht rural ku mbizotëronte kultura fshatare. Kjo do të thotë se vlerat patriarkale tradicionale dominonin në shumicën e shoqërisë dhe përcakttonin rolet dhe marrëdhëniet gjinore që vazhduan edhe gjatë epokës komuniste, dhe deri diku, vazhdojnë edhe në të tashmen.

Familjet rurale patriarkale kultivuan idealin e një gruaje të nënshtruar dhe pasive, të bindur ndaj babait dhe më pas burrit. Superioriteti i burrit ishte thelbësorja e kësaj tradite. Rrënjët e keqtrajtimit të grave shqipëtare nga burrat, datojnë në shekullin e 15^{te} dhe kanë lidhje me kodin zakonor të njohur si Kanuni (UNICEF Raporti, 2000a). Sipas rregullave të Kanunit, një burrë ka të drejtë të rrahë dhe poshtërojë gruan e tij publikisht nëse ajo nuk i bindej atij. Burri ka të drejtë të presë flokët e gruas së tij, ta zhveshë atë, ta përzerë nga shtëpia dha ta fshikullojë atë me kamzhik nëpër të gjithë fshatin. Kanuni përcaktonte se burri mund ta

vrasë gruan e tij për dy arsye: pabesi dhe tradhëti. Ky e ndalonte gruan që të fliste me mysafirët që vinin për vizitë në shtëpinë e saj, ose të hynte në dhomën e burrave pa lejen e burrit.

Në komunitetin Shqipëtar, marrëdhëniet tradicionale vazhduan ndofta në një shkallë më të lartë se sa në çdo grup tjetër etnik të Ballkanit. (Lawson dhe Saltmarshe, 2002). Kanuni vazhdon të jetë i rëndësishëm dhe ndikon në mënyrë domethënëse në përjashtimin social të grave (De Soto, Gordon, Gedeshi dhe Sinoimeri, 2002). Shumë burra, veçanërisht nga zona verilindore e vendit, akoma i binden këtij kodi zakonor tradicional sipas të cilit gratë konsiderohen si plaçkë dhe mund të trajtohen si e tillë. Në disa zona të verilindjes është akoma e pranueshme që të rrëmbesh një vajzë të re për nuse. Shumë gra akoma e shohin pozicionin e tyre social brenda kornizës së këtij kodi zakonor. Megjithëse pozicioni i tyre në familje ndryshon në varësi të klasës ose moshës së tyre, shumica e grave mendojnë se duhet t'u shërbejnë familjeve të tyre, të mbajnë fëmijët dhe të ruajnë kulturën tradicionale shqipëtare. Qëndrimet kulturore në lidhje me nderin e burrave gjithashtu shërbejnë për të justifikuar dhunën ndaj grave dhe për të përkeqësuar pasojat e saj. Dhuna ndaj grave inkurajohet në një kulturë që mbështetet epërsinë dhe dominimin e burrave ndaj grave.

Kanuni është vetëm njëri nga faktorët që ndikon në pozitën inferiore të grave në shoqërinë shqipëtare. Faktorë të tjerë janë niveli i ulët i zhvillimit social-ekonomik, niveli i lartë i varfërisë, niveli i ulët i shkollimit dhe mungesa e kulturës demokratike. Fakti që burrat vazhduan të kenë dominim absolut mbi gratë deri në mes të shekullit të njëzet, e rradhit Shqipërinë në një kategori të veçantë të vendeve Europiane (Gjipali dhe Ruci, 1994).

Doktrina ideologjike e regjimit komunist promovoi formalisht barazinë e grave. Gratë kishin mundësi punësimi, por përveç retorikave

egalitariste, natyra paternaliste e rregullave komuniste përforcoi qëndrimet dhe praktikat patriarkale. Shteti riprodhoi dhe nxiti më tej marrëdhëniet tradicionale të varësisë të familjes patriarkale. Ashtu sikurse edhe në vende të tjera të bllokut komunist, hendeku midis emancipimit të grave në teori dhe realitetit të përditshëm të tyre, e shkatërruan sloganin 'barazia e grave me burrat' (Kligman, 1996).

Rënia e thellë ekonomike, që karakterizoi tranzicionin e shoqërisë Shqipëtare drejt politikave të tregut të lirë, pati një ndikim të madh në jetën e njerëzve. Shumica e familjeve shqipëtare janë të varfëra, me të ardhura të pakta dhe kushte të papërshtatshme banimi. 46.6% e shqipëtarëve jetojnë nën nivelin e varfërisë ndërkohë që një pjesë tjetër e popullsisë prej 17.4%, jetojnë në varfëri ekstreme. Në vitin 2001 niveli i papunësisë ishte 14.6% (UNDP-HDPC Raporti i vitit 2002). Papunësia e lartë e meshkujve po e shkatërron modelin tradicional të burrit si mbajtës i familjes. Burrat po përballen me një tendencë të re – gratë me fitime më të larta. Ata e kanë të vështirë që ta pranojnë këtë fenomen që ishte i panjohur deri një dekadë më parë, sepse kjo kërcënon identitetin e tyre tradicional. (Raport i Bankës Botërore, 2002b).

Sipas Kushtetutës Shqipëtare, grave u jepen të drejta të barabarta me burrat në të gjitha sferat e jetës, por në realitet gratë nuk përfitojnë nga shumë prej të drejtave që u jep ligji. Qytetet me nivelin më të lartë të papunësisë së grave janë Tirana, Berati dhe Vlora (Raporti UNICEF, 2000b). Për më tepër, gratë janë të detyruara që të zenë vende punë që nuk paguhen mirë për arsye të detyrimeve familjare. Gjithmonë e më tepër, migrimi dhe emigrimi i ka detyruar gratë që të marrin rolin e kryefamiljares.

Bazuar në ligj, por edhe në praktikë, gratë nuk janë përjashtuar nga ndonjë post, megjithëse ato nuk përfaqësohen si duhet në nivelet më të larta të profesionit të tyre, sepse në zhvillimin e karrierës ato përballen me diskriminimin. Për shembull, megjithëse gratë përbëjnë 62% të mësuesve të arsimit 8-vjeçar dhe 38.7% të mësuesve të arsimit të mesëm, vetëm 5.8% e profesorëve në universitet janë gra (Raporti

UNDP-HDPC, 2002). Gratë gëzojnë të drejta të barabara për ndjekjen e arsimit të lartë, por ato nuk kanë mundësi për ta ndërtuar karrierën e tyre plotësisht dhe në mënyrë të barabartë. Është e zakonshme për gra të shkolluara të punojnë në punë më pak të kualifikuara ose jashtë fushës së tyre të kualifikimit. Vështirësitë për t'u regjistruar në shkolla si dhe për shkollim të mëtejshëm kanë më tepër ndikim tek femrat. Rritja e prostitucionit dhe e trafikimit të vajzave dhe grave ka bërë që në shumë zona rurale rreth 90% të adoleshenteve të braktisin arsimin e mesëm nga frika e rrëmbimeve (Save the Children Report, 2001).

Në Shqipëri, mesatarja e pagës së grave është vetëm 70% e pagës së burrave. Burrat predominojnë akoma në pozicionet udhëheqëse të qeverisë. Gratë përfaqësojnë 50.1% të popullsisë shqipëtare por ato zenë vetëm 10% të vendeve të punës në qeveri dhe vetëm 5.7% të vendeve në parlament (2001). Nga 2001-2002 kishte vetëm 5 kryetare bashkie, një prefekte dhe dy ministre (Raporti UN-ACER, 2002). Për ndërtimin dhe përforcimin e partneritetit midis burrave dhe grave në jetën publike dhe private, është e nevojshme që të bëhet një rishpërndarje e barabartë e 'detyrave për zgjidhje'. Por kjo ende nuk ka ndodhur. Barra e trefishtë e grave si punonjëse, nëna dhe bashkëshorte, trashëgohet nga mentaliteti i vjetër komunist dhe vazhdon akoma të ekzistojë në Shqipëri.


Migrimi i popullsisë nga fshatrat në qytete ka qenë një nga veçoritë më dramatike të tranzicionit shqipëtar. Popullsia fshatare që populloi qytetet që nga viti 1991, mbarti me vete zakonet, traditat, mentalitetin dhe stilin e jetesës së zonave të ndryshme të Shqipërisë. Papunësia, varfëria dhe ankthi për të ardhmen, sjell si rezultat një nivel të lartë stresi, si dhe probleme psikologjike të cilat mund të bëhen shkak për provokimin e reagimeve agresive ndaj të tjerëve. Incidenca e vdekjeve nga shkaqe jo-natyrore u shtua ndjeshëm. Në 1998 vdiqën nga shkaqe jo-natyrore tre here më shumë njerëz se në 1994, nga të cilët 95% si pasojë e vrasjeve ose aksidenteve me makinë (Raporti UNDP, 2000). Nga burime të policisë, vrasjet qenë krimi më i përhapur në vitin 1999. Megjithëse prostitucioni është pothuajse një

dukuri e re në Shqipëri, vendi mbahet si një nga furnizuesit kryesorë me punonjëse të seksit në vendet fqinjë. Trafikimi i grave dhe vajzave është në Shqipëri një fenomen i ri tragjik (Raporti UNDP-HDPC, 2002).

Tani për tani në legjislacionin Shqipëtar nuk ka as përkufizim për dhunën në familje, dhe as një ligj të veçantë për dhunën në familje.

Megjithatë, ekzistojnë ligje kundër dhunës dhe sjelljeve të dhunshme që mund të përdoren në kontekstin e dhunës në familje. Për shembull, neni 89 i Kodit Penal Shqipëtar parashikon nga gjobë deri në 2 vjet heqje lirie për plagosje të lehtë me dashje, që ka shkaktuar paafësi të përkohshme në punë për më tepër se 9 ditë. Për shumë arsye, është e vështirë që të përcaktosh shkallën e saktë të dhunës ndaj grave në familje. Një nga arsyet më të përgjithshme është mos-raportimi nga ana e viktimave. Një tjetër arsye është mungesa e statistikave nga policia, prokurorët, gjykatësit apo zyra të tjera shërbimi (Raporti i Minnesota Advocates for Human Rights, 1996). Barazia gjinore është një koncept i ri që akoma nuk është përqafuar nga një pjesë e konsiderueshme e popullsisë. Konceptet e përdhunimit martesor dhe ngacmimit seksual nuk janë shumë të qarta dhe kjo bën që këto akte të mos konsiderohen si krime. Qëndrimet dhe vlerat sociale e mbështesin pozicionin e burrit si kryetar i plotfuqishëm i familjes, fuqia absolute e të cilit nuk duhet vënë në diskutim. Kultura e pranimit si dhe mungesa e reagimit nga ana e policisë ka sjellë si rezultat që shumica e abuzimeve të mos raportohen. Në studimin më shkencor të kryer në lidhje me këtë çështje dhe që është realizuar në 11 rrethe, pothuajse 40% të grave të vëzhguara kanë dëshmuar se mbi to ushtrohej dhunë fizike rregullisht, dhe 64% se i ishin nënshtruar dhunës fizike dhe psikologjike (Shoqata e Gruas Refleksione, 1996). Shtrirja e dhunës në familje mund të kuptohet nga të dhënat e Qendrës për Këshillimin e Grave dhe Vajzave. Që nga koha e themelimit të saj në vitin 1996, në këtë qendër kanë telefonuar më shumë se 5,000 gra dhe vajza dhe janë kryer më shumë se 400 këshillime ballë për ballë. E vetmja qendër pritëse për viktimat e dhunës në familje është në Tiranë, dhe kjo nuk mund të përballojë

kërkesat për akomodim (Raporti UNICEF, 2000a). Të gjitha këto të dhëna, dëshmojnë se dhuna në familje është një problem serioz në Shqipëri. Numri i grave të vrara ose të plagosura fizikisht dhe emocionalisht nga partnerët e tyre abusive, nuk duhet të injorohet apo tolerohet më nga shoqëria shqipëtare.



Objektivat

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të sigurojë mirkuptim të plotë për dhunën në familje në Shqipëri. Studimi fokuson aktet e dhunës psikologjike, fizike, seksuale dhe ekonomike, që kryen ndaj grave nga partnerët e tyre intimë. Si pjesë e këtij objekti, vlerësimi cilësor i dhunës në familje në Shqipëri ka për qëllim të:

- Identifikojë gamën e formave të dhunës që janë më të zakonshme në familje;
- Zbulojë se cilat janë sipas perceptimit të grave sjellje abuzive dhe në ç'rrethana ndodhin ato;
- Zbulojë strategjitë që përdorin gratë për të shmangur dhunën ose për të zvogëluar pasojat e saj;
- Dokumentojë pasojat që sjell dhuna në familje tek gratë, familja, dhe mbarë shoqëria;
- Identifikojë qëndrimet e grave përkundrejt abuzuesve të tyre dhe marrëdhënieve abuzive;
- Përcaktojë kufizimet sociale që privojnë shumë gra nga barazia me burrat në sferën private.

Studimi gjithashtu ka për qëllim që të sigurojë kushtet dhe mjedisin e përshtatshëm për një fushatë në mjetet e informimit masiv, për rritjen

e ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me ekzistencën, natyrën dhe pasojat abuzimit martesor, dhe për pasojë, reduktimin dhe parandalimin e tij. Studimi do të sigurojë gjithashtu edhe informacion, si dhe do të rekomandojë masat që duhen ndërmarrë nga hartuesit e politikave. Së fundi, studimi ka për qëllim të fuqizojë viktimat e dhunës, që ato të mund të thyejnë rrethin vicioz të heshtjes dhe izolimit.

Pjesëmarrëset në studim

Grupi i pjesëmarrëseve përbëhej nga 55 gra që kishin përvojë në marrëdhëniet abuzive ose që kishin pësuar dhunë ndërpersonale (Shtojca 1). Qëllimi i kampjonimit ishte identifikimi i grave viktime të dhunës në familje, me prejardhje shoqërore të ndryshme si dhe me karakteristika të ndryshme demografike. (Tabela 1). Megjithëse këto gra përfaqësojnë rajone dhe karakteristika social-demografike të ndryshme, kampjonimi nuk mund të konsiderohet si shembull për të gjithë Shqipërinë. Pjesëmarrëset në studim nuk përfaqësojnë gjithë popullsinë femërore Shqipëtare. Megjithatë vihet re se zakonet dhe përvojat që gratë kanë shprehur në këto intervista, mund të jenë karakteristike për shumë gra shqipëtare.

Tabela 1: Profili demografik i të intervistuarave

Banimi		Feja		Shkollimi		Puna që bëjnë	
Tiranë	28	Muslimane	35	Fillor		Profesionale	10
Berat	13	Ortodokse	11	8 vjeçar		Teknike	32
Shkodër	14	Katolike	9	I mesëm		Të papuna	14
				Universitar		Studente	1
Moshë		Numri i fëmijëve		Gjendja civile			
Nën 20	2	Asnjë	2	Të martuara	30		
21-30	9	1	14	Të divorcuara	19		
31-40	31	2	20	Të fejuara	2		
41-50	8	3	14	Të veja	2		
51-60	4	4	1	Që bashkëjetojnë	2		
61-70	1	5	3				
Moshë mesatare	34	6	1				

Metoda

Për të zbuluar se si e konceptonin gratë e abuzuara përvojën e tyre personale, ne përdorëm metoda të kërkimit cilësor. Për intervistat e thelluara me 55 gratë viktime të dhunës në familje, u përdor teknika e grumbullimit të të dhënave. Duke u bazuar në përvojat e mëparshme, si dhe për të mbuluar një gamë të gjërë çështjesh, u hartua një udhëzues interviste që bazohej në formatin e intervistës gjysëm të strukturuar. Për hartimin e udhëzuesit për intervistat, ne u përpoqëm që të hartonim pyetje sa më neutrale që të ishte e mundur, në mënyrë që të zbulonim interpretimin lokal të çështjes. Intervistat mbuluan disa tematika, disa nga të cilat kishin lidhje me dhunën, ndërkohë që të tjerat kishin lidhje me jetën e përditshme të çiftit. Temat në lidhje me dhunën mbulonin pyetje që varionin që nga arsyet e krijimit dhe negocijimit të konfliktit, zënkat e veçanta si pasojë e konflikteve, e deri tek ngjarjet e dhunshme dhe pasojat e tyre për të dy partnerët. Në sferën e jetës së përditshme, pyetjet përfshinin ndarjen e roleve brenda familjes, procesin e marrjes së vendimeve, çështjen e aktiviteteve të përbashkëta apo të veçanta brenda familjes, marrëdhëniet intime dhe seksin, marrëdhëniet me familjen e origjinës, kontaktet për mbështetje formale ose jo-formale si dhe këndvështrimet për të ardhmen e marrëdhënieve.

Intervistat përfshinin një seri pyetjesh të hapura mbi përvojën e grave në lidhje me abuzimin. Pyetjet që ishin hartuar për të marë përgjigje konkrete u kombinuan me pyetje të hapura, në mënyrë që të intervistuarat të mund të përshkruanin përvojën me fjalët e tyre. Për pyetjet nuk u përcaktua një sekuencë specifike, dhe intervistueset u trajnuan që të ndiqnin dhe të respektonin rrjedhën e tregimit të të intervistuarave, por duke bërë të mundur që të mbuloreshin të gjitha temat kryesore të udhëzuesit të intervistës. (Kvale, 1996).

Procedura

U zhvilluan katër intervista pilot me gra nga Tirana, Berati dhe Shkoder, për të cilat u përdor udhëzuesi paraprak. Më pas ky udhëzues u

finalizua në një format interviste që u përdor për të gjitha intervistat. Kampjonimi fokusoi ato gra që e konsideronin veten e tyre si viktime, që kishin qenë subjekt kontrolli apo abuzimi të çfarëdo lloji, pavarësisht nëse ky ishte fizik, seksual, psikologjik emocional apo ekonomik. Për të rënë në kontakt me to, intervistuesit identifikuan gratë që kishin qenë në qendrat pritëse apo kishin telefonuar qendrën e këshillimit. Këto gra u informuan që në fillim për qëllimin e këtij studimi. Takimi me secilën grua u përcaktua vetëm pasi ajo binte dakort të intervistohet. Pjestarët e grupit të studimit informuan secilën grua në veçanti në lidhje me studimin. Intervistueset i lexonin secilës prej të intervistuarave një paragraf që përmbllidhte qëllimin e studimit dhe llojet e pyetjeve që do të bëheshin, u siguronte atyre anonimitetin e përgjigjeve, se pjesëmarrja e tyre në këtë studim ishte në baza vullnetare dhe se ato mund të tërhiqeshin në çdo kohë. Pranimit i të intervistuarave u bë gojarisht. Intervistuesit kishin parasysh gjatë gjithë kohës privatësinë e të intervistuarave, duke u lejuar atyre që ta zgjidhnin vetë kohën dhe vendin e përshtatshëm për intervistën, duke u shpjeguar atyre natyrën konfidenciale të intervistës dhe të të dhënave të dala prej saj.

Studimet që kanë të bëjnë me përvojën e grave me dhunën në familje janë konsideruar si "studime mbi çështje të ndjeshme", pasi krijojnë mundësinë e rikujtimit të përvojave që mund të shkaktojnë dhimbje dhe shqetësime emocionale. Aspekte të veçanta të këtyre përvojave, ka gjasa që të mos jenë treguar kurrë më parë. Për arsye se gratë që përjetojnë përvoja të tilla janë shpesh herë të ndjeshme dhe të pambrojtura, intervistueset mbajtën gjatë gjithë kohës një qëndrim simpatizues dhe mbështetës, në mënyrë që ato të ndjeheshin të mbrojtura dhe të sigurta gjatë gjithë intervistimit. Intervistuesit i inkurajuan gratë për t'u shprehur në lidhje me çështje të tilla të ndjeshme, nëpërmjet një qëndrim jo-gjykues, me takt, dhe nëpërmjet ndarjes me to të përvojave të ndryshme.

Intervistat zgjatën nga 45 deri në 80 minuta ose mesatarisht 60 minuta. Të gjitha intervistat u rregjistruan në magnetofon duke marë më parë lejen e të intervistuarës. Më pas intervistat

u shtypën në kompjuter në më shumë se 5,000 faqe tekst, duke përdorur një program 'word-processing'. Gjatë intervistimit u mbajtën edhe shënime.

Procesi i intervistimit zgjati për rreth katër muaj (Gusht - Nëntor 2002) dhe u krye nga katër studjues që kishin përvoja të mëparshme pune me viktime të abuzimit nga partnerët e tyre. Të gjitha intervistueset ishin gra. Përpara fillimit të punës për intervistimin, intervistueset u trajnuan pesë ditë intensivisht në tema si metodologjia cilësore, teknika të intervistimit të thelluar, çështje të etikës, si dhe aspekte emocionale dhe të qëndrimit në intervistimin e grave me probleme. Monitorimi i intervistimit si dhe i procesit të drejtimit në përgjithësi, u krye nga konsulentja e UNICEF –it.

Analiza e të dhënave

Për analizën e të dhënave u përdorën strategji të ndryshme. Kryesisht procesi i analizimit u udhëhoq nga një version që Smith (1999) e ka përkufizuar si *analiza e interpretimit fenomenologjik*, nga hapat e Parkerit (1992) për *analizën e dinamikës së bisedës* dhe nga procedurat e teorisë së fillimit nga zero të (Charmaz, 1999). Për gjetjen e të dhënave si dhe kodimin e tyre u përdor një paketë programesh kompjuterike (Atlas.ti, 1997)

Metoda e parë ka për qëllim të nxjerrë në pah pikpamjet e pjesëmarrësve në lidhje me fenomenin që po shqyrtohet, nga këndvështrimi i tyre. Për këtë studim, fenomenologjia u zgjodh duke u bazuar në besimin se do të shërbente për të fituar më shumë njohuri për përvojat e grave. Këto njohuri do të bazoheshin në historitë individuale të grave dhe jo në supozimet e studjuesve. Metoda fenomenologjike e zgjedhur për këtë studim ishte më tepër ajo e teknikës 'eidetik' (përshkruese) se sa ajo 'hermeneutik' (interpretative). Qëllimi i fenomenologjisë eidetike është të arrijë të përshkruajë domethënien e përvojës sipas këndvështrimit të pjesëmarrësës. Studjuesja, e frymëzuar nga fenomenologjia, nuk ofron një interpretim të qartë dhe të vetin në lidhje me rëfimin e folësës; qëllimi është që rëfimi të prezantohet në mënyrë të tillë që opinion i folësës të merret

parasysh.

Analiza e intervistave u bë sipas teknikës së zberthimit të tematikave. Termi "temë" është përdorur për t'iu referuar identifikimit të bërë nga studjuesja i shembujve koherentë në rëfimin e pjesëmarrësve (Baban, 2002). Procedura u krye në katër hapa: (a) së pari, të gjitha intervistat u lexuan disa herë nga autorja e këtij studimi, derisa materiali u kuptua në detaje; (b) së dyti, nga intervistat u nxorrën deklaratimet më domethënëse, ato që kishin më shumë lidhje me ndodhi të dhunshme; për këto deklarime u hartuan dhe u bashkëngjitën kode operacionale nëpërmjet një procesi të zberthimit të kuptimit; (c) së treti, për të paraqitur temat më të rëndësishme, u identifikuan dhe u grupuan pasazhet që shprehnin më qartë idetë e përsëritura; dhe (d) së katërti, u bënë përgjithësime që bashkonin në kategori më të përgjithshme, disa njësi me kuptime të ndryshme (grupime të temave). Ky ishte një proces përsëritës. Në disa raste, disa nga temat e mëparshme u grupuan sëbashku duke formuar një temë të re. Për çdo grupim të ri u bë krahasimi me transcriptin, për t'u siguruar se përshkrimi i këtij grupimi përputhej me atë që kishin thënë aktualisht pjesëmarrëset. Meqënëse ky proces u përsërit, u krijuan tema dhe konceptime të reja. U vu re se megjithëse përvojat individuale ishin unike, në historitë e grave kishte shumë ngjashmëri. Për arsye të përmasave të kampjonimit, që ishte i madh për një studim cilësor, në analizën finale të intervistave u vu re ndërthurje e tematikave.

Analizimi i dinamikës së diskutimit përfshin trajtimin e objektit të studimit si një tekst (Parker, 1992). Megjithatë, në këtë rast, qe teksti i diskutimeve të grave ai që e shndëroi në fjalë objektin studimit (dhuna në familje dhe marrëdhëniet gjinore). Perceptimi analitik i diskutimit nënkupton që jetët, personat, përvojat dhe kuptimi i tyre, formohen nga dhe nëpërmjet gjuhës, burimeve dhe praktikave ekzistuese kulturore, si dhe nga diskutimi i domethënies së shembujve. Megjithatë, në kuadrin e diskutimit, nuk arrihet vetëm kuptimi i domethënies, por duke mbajtur parasysh shumëllojshmërinë e përgjigjeve për ndonjë çështje, edhe kuptimet mund të jenë të shumfishta. Kjo metodë nuk synon të bëjë të

njohur gjithanshëmritë psikologjike, por më tepër mer në konsideratë kontekstin social nga i cili kanë gjeneruar edhe përgjigjet e pjesëmarrëseve.

Për të siguruar rezultate të vlefshme për të

dhënat cilësore, u ndoqën disa kriteretë specifike. Ëlcott (1994) argumenton se vlefshmëria është rezultati i ngjashmërisë midis përshkrimit dhe interpretimit. Përveç kësaj, ne synuam që t'i paraqesim interpretimet, si thënie direkte të marra nga të dhënat diskriptive.

Përfundime

Si rezultat i analizës së intervistave dhe vëzhgimit të bërë për gjetjen e ngjashmërive midis tyre, u evidentuan shtatë grupe kryesore temash: (1) ëndra për martesë, (2) përballimi i realitetit, (3) dhuna e ushtruar, (4) të qenit grua e abuzuar, (5) shqetësimi për fëmijët, (6) përballimi i dhunës dhe (7) thyerja e heshtjes. Midis këtyre temave ka edhe ndonjë mbivendosje. Secila nga temat kryesore është

zbërthyer në nëntema që e kompletojnë pamjen e dhunës në familje sipas këndvështrimit të grave.

Për të shmangur cënimin e konfidencialitetit, të gjithë emrat e përdorur në prezantimin e përfundimeve janë pseudonime, dhe në raport jepet vetëm ndonjë element për identifikimin demografik të informacionit.

ËNDRA PËR MARTESË

"Unë gjithmonë kam dashur të jem bashkëshorte e mirë, të kem një burrë të mirë dhe familje për së mbari. Dhe si çdo grua tjetër unë ëndëroja të kisha një martesë të lumtur dhe një burrë që përveç të qenit një partner i mirë të ishte për mua edhe shok. Në fillim çdo gjë ishte një mrekulli, perfekte. Problemet u shfaqën më pas dhe me kalimin e kohës u keqësuan. Në marrëdhëniet tona konfliktet dhe kontradiktat u bënë shumë të shpeshta." (Stella, 31 vjeç, mësuese, nënë e dy fëmijëve).

Martesa si një ideal

Shumë nga pjesëmarrëset përmendin ëndrën e tyre për t'u martuar e për të patur një familje të lumtur. Martesa ishte një ndodhi e rëndësishme për gratë e intervistuar, qëllimi më i rëndësishëm i jetës së tyre. Ato mendonin se nëpërmjet martesës do të fitonin respektin dhe aprovimin e shoqërisë, dy elemente këto të një jete të suksesshme dhe me vlerë. Për shumë gra të tjera martesë nuk qe gjë tjetër veçse përmbushja e një ideali. Por ëndrat ishin kundërshtuar shumë shpejt nga realiteti. Denisa, që jeton në Shkodër dhe punon si nënpunëse civile thotë: "Ëndra e çdo vajze është që të martohet dhe të jetojë e lumtur. Por martesë dhe ëndrat janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme. Për shumë vajza ëndrat mbeten gjithmonë ëndra, dhe kështu ndodhi edhe me mua. E ç'mund të bëj? Ky ishte fati im." Evelina, 44 vjeç, përshkruan një përvojë të ngjashme: "Unë dëshiroja të kisha një familje, të kisha një burrë që do të kujdesej për mua dhe fëmijët e mi, dhe doja që t'i jepja mundësi shkollimi të mirë fëmijëve të mi. Asnjë nga dëshirat e mia nuk u plotësua. Unë kisha prejardhje nga fshati, por megjithatë kisha dëshira dhe ëndra për jetën time."

Vatra familjare tradicionalisht është idealizuar si një vend i paqes, afeksionit dhe rehatit. Përkundrazi, shumë shpesh martesë shëndrohet në një arenë të abuzimeve emocionale dhe fizike të grave. Siç përmendet edhe nga Fatmira, një grua e papunë nga Tirana: "Unë ëndërova një martesë të lumtur. Nuk e mendoja se jeta ime do të ishte krejt ndryshe. Që ditën e parë të martesës jeta ime ishte krejt ndryshe nga ç'e kisha ëndëruar. Për mua ka qenë gjithmonë e njëjta gjë, vetëm

vuajtje dhe dhimbje." Erika, një ekonomiste nga Tirana, shprehet: "Ajo çfarë unë ëndëroja për martesën dhe realiteti, janë aq të ndryshme sa edhe dita me natën. Unë shpresoja të kisha një shtëpi, të jetoja me burrin tim dhe të rrisja fëmijët. Por në realitet m'u desh të jetoj me vjerrën, kunetërit dhe kunatën të cilët nuk ishin të martuar. Vjerra ime ishte e plotfuqishme në familjen time."

Shumë gra shprehen se marrëdhëniet e tyre kishin filluar mirë por me kalimin e kohës burrat ishin bërë të dhunshëm dhe kontrollues. Ariana, një banuese në Shkodër, e përshkruan përvojën e saj kështu: "Në fillim marrëdhëniet duket se ishin shumë të mira. Pas një viti ne u bëmë me djalë. Me kalimin e kohës, ndofta nga tranzicioni apo nga vështirësitë ekonomike që po përballonim, mes nesh u krijua një thyerje. Im shoq filloi të pijë, sillej shumë keq me mua dhe nuk i bëhej më vonë për marrëdhëniet tona, filloi të bëhej i dhunshëm me mua, më rrihte. Unë mendova të kërkoja divorcin por isha shtatzanë me fëmijën e dytë. Vazhdoja të shpresoja se ai do të ndryshonte. Linda fëmijën e dytë por situata u bë akoma më e vështirë. Ai u bë akoma më abuziv me mua. Ai filloi të luajë bixhoz, as që i bëhej vonë për martesën dhe familjen e tij. Kështu, marrëdhëniet tona arriti në një pikë tepër kritike dhe po keqësohej nga dita në ditë. Ai bëhej gjithnjë e më abuziv, dhe jo vetëm me mua por edhe me fëmijët."

Martesa si shpëtim

8 gra e kanë perceptuar martesën si e vetmja mënyrë për të shpëtuar nga vuajtjet e shkaktuara nga varfëria dhe babai abuziv. Ndërkohë që ato u larguan nga një mjedis abuziv si fëmijë, për shumë prej tyre ndodhi që

të gjendeshin të përfshira në një marrëdhënie të dhunshme të rriturish. Dafina, një grua shtatzënë me banim në Tiranë thotë: "Arsyeja e vetme pse desha të martohesha ishte dhuna në familjen time. Im atë abuzonte gjithmonë me nënën time dhe pastaj me fëmijët. Kur u martova mendova se do të ishte me mirë se sa kur isha fëmijë. Unë nuk mendoja se edhe im shoq do të abuzonte me mua." Sonila është një grua tjetër që mendon se ëndra e saj për të patur një familje të lumtur kishte dështuar: "Unë shpresoja që të kisha një jetë më të mirë pas martesë. Çdo natë unë ëndëroja për burrin tim të ardhshëm, fëmijët e mi, shtëpinë, të gjitha këto vetëm për veten time. Unë ëndëroja të kisha familje dhe të kujdesesha për të. Mua më pëlqente roli i nënës, i bashkëshortes. Por ëndra ime nuk u realizua." Bojana, një grua 40 vjeçare nga Berati mendon se shpresat e saj ishin shuar: "I isha lutur zotit të më jepte një burrë të mirë dhe një familje të këndshme; Unë jam jetime dhe kam vuajtur shumë. Mendoja se do t'i shërbeja burrit tim sa më mirë, do ta doja familjen e tij, do të kujdesesha për shtëpinë dhe ta mbushja atë me fëmijë. Por pata fat të keq dhe nuk e di se pse më ndodhi kjo"

Martesa si një normë

Në një shoqëri patriarkale, të qenit bashkëshorte dhe nënë përbën dy aspekte kyçe për dinjitetin e një gruaje. Statusi e të qenit e martuar kuptohet nga gratë si diçka normale dhe natyrale. Për Aferditën që banon në Tiranë, të martohesh është një sjellje normative:

"Arsyeja se pse u martova ishte...thjesht diçka që duhej bërë, diçka e detyrueshme, ..., ndofta jo e detyrueshme por çdo vajzë duhet të mendojë se duhet të martohet." Nëse një grua e re mbetet e pa martuar, pavarësisht nga arsyet që ajo ka, automatikisht do të ketë status inferior dhe do të konsiderohet si një barrë për familjen. Diana, një farmaciste 50 vjeçare e përshkruan kështu arsyen se pse u martua: "Përpara se të martohesha kisha qënë e fejuar me një burrë tjetër. Ne u ndamë se ai kishte lidhje me një grua tjetër që mbeti edhe shtatzënë me të. Pas ndarjes jeta në familjen time u bë shumë e vështirë. Ju e dini se në ato kohë të ishe njëherë e ndarë, sikur edhe gjatë fejesës, konsiderohej si diçka shumë e keqe. Më në fund vendosa të martohem sepse nëna

ime dhe unë kishim frikë se nuk do të më kërkonte më asnjëri. M'u desh të pranoj për burrë një burrë të divorcuar që kishte edhe një fëmijë nga martesa e tij e parë, që ishte më pak i shkolluar se unë dhe që nuk e doja. Ëndra ime për të patur një burrë ideal kishte dështuar. Megjithatë unë vendosa që t'i përshtatem rrethanave." Të njëjtin ankth të të mbeturit beqare e shpreh edhe Manjola, një teknike nga Tirana: "Së pari doja që të theksoja se nuk ishte dashuria, por opinioni i të tjerëve që më detyroi të martohesha. Prindërit e mi kishin frikë se unë nuk do të martohesha kurrë."


Për disa gra ka patur presion për t'u martuar, dhe ky presion kishte filluar që në rininë e hershme. Elona, një punëtore 43 vjeçare nga Berati thotë: "E ç'dija unë kur u martova? Unë isha një fëmijë. Për këtë u kujdesën prindërit e mi. Ata më thanë se duhet të martohesha dhe kaq...Ah sikur të isha e re edhe njëherë! Nuk do të isha martuar përpara të njëzetave." Fatjona, nëna e pesë fëmijëve ka të njëjtën përvojë: "Ne ishim 8 fëmijë dhe jetonim në vështirësi ekonomike. Prindërit vendosën të më martonin. Im atë më fejoj dhe pas dy muajsh unë u martova. Unë e konsiderova martesën time si një mënyrë për të ndihmuar familjen time." Etleva, një grua e re 23 vjeç, nënë e dy fëmijëve thotë: "Martesa jonë u bë me nxitim nga prindërit e mi. Babai dhe nëna më thanë se fejesat e gjata nuk përfundonin mirë. Ata kishin frikë se unë do të ngelesha shtatzënë përpara martesë, gjë që do të ishte turp i madh për familjen."

19 nga pjesëmarrëset kanë raportuar se janë martuar me shkes, shpesh të organizuara nga autoriteti mashkullor i familjes (babai ose vëllai). Aferdita tregon: "U bë martesë me shkes. Atë e organizoi babai im. Unë nuk desha por babai më detyroi. Kështu që unë bëra atë që desh babai im. Unë u martova se të dy prindërit kërkuan prej meje që të martohesha." Martesat me shkes dhe pa dëshirën e grave kanë shpesh pasoja negative. Vera nga Shkodra thotë: "Unë isha shumë e re kur më martuan pa dëshirën time. Unë dashuroja një djalë që kishte fe tjetër të cilin familja ime nuk e pranonte. Kështu që unë u detyrova të martohesha me një burrë që nuk e doja, por që i plotësonte të gjitha konditat e familjes time, si feja edhe gjendja ekonomike.

Asgjë nuk u bë ashtu siç donin prindërit e mi.” Rudina, nëna e tre fëmijëve nga Tirana përshkruan një përvojë të ngjashme: “Familja ime, veçanërisht vëllai më nxiste që të merrja një vendim në lidhje me martesën. Unë ia lashë atij që të vendoste. Tani familja ime ndjehet fajtoare që më martuan me të.”

Perceptimi i martesës si një qëllim në jetë mund të bëhet si pikë referimi, megjithëse disa gra

përmendin si motivim edhe dëshirën për t’u larguar nga shtëpia e dhunshme dhe e varfër prindërore. Nga rëfimet e grave, martesë kuptohet si një normë dhe si një situatë e dëshirueshme për statusin social të grave. Tradita patriarkale e martesave me shkes nga një person autoritar mashkull, akoma ndeshet shpesh. Ndodh shpesh që martesë të bëhet një skenë e poshtërimit personal, tensionit, kërcënimeve dhe konflikteve.



PËRBALLIMI I REALITETIT

"Shumica e burrave shqipëtarë nuk e vlerësojnë gruan. Ata i konsiderojnë ato si skllave që duhet të kujdesen për fëmijët, për shtëpinë, të bëjnë të gjitha punët dhe kaq." (Dorina, 22 vjeç, e divorcuar, nënë me një fëmijë).

Marrëdhëniet gjinore dhe jeta shtëpijake

Shumë gra flasin me mllef në lidhje me faktin se shpresat dhe pritshmëritë e tyre për martesën ishin kundërshtuar nga realiteti i përditshëm. Oriola, një juriste 40 vjeçare e divorcuar thotë: "Unë prisja që martesë ime t'i ngjante asaj të prindërve të mi, por për fat të keq unë gjeta një model të ri, modelin e prindërve të tij. Ai ishte rritur në një familje të dhunshme. I ati kishte abuzuar me të ëmën dhe ai donte të bënte të njëjtën gjë me mua." Ashtu si gratë në kultura të tjera patriarkale, gratë shqipëtare janë mësuar që të jenë të nënshtruara, passive, të varura dhe të bindura ndaj meshkujve. Nëse ato nuk binden, për meshkujt është krejtësisht e pranueshme që të ushtrojnë dhunë për t'i disiplinuar ato dhe për të ruajtur kontrollin. Mimoza, një punëtoze ferme shpjegon: "Kur unë u martova nëna më këshilloi: *"Ki kujdes, ai është burri yt dhe ndonjëherë edhe mund të të gjuajë apo të të rrahë."* Shoqet e mija më thanë të njëjtën gjë. Në fillim ne kishim marrëdhënie të mira. Unë isha 20 vjeç kur u martuam dhe ai gjithmonë më bënte komplimenta dhe komente të këndshme për sytë e mi. Por pas dy vjetësh, kur unë akoma nuk kisha mbetur shtatzënë ai filloi të më bërtiste: *"A ke ndër mend të bësh një fëmijë apo jo? Unë nuk u martova me ty për sytë e bukur."* Unë ndjehesha e mërzitur dhe qaja." Një mësuese e divorcuar 31 vjeç nga Tirana kishte marrë të njëjtën këshillë nga nëna e saj: "Unë mësova nga nëna ime se si të isha e bindur ndaj burrit tim. Babai im përfaqësonte modelin mashkullor me tipare kokfortësie dhe gjaknxehtësie ... Burri im, në mënyrë që t'i tregonte të atit se ishte ai që urdhëronte në marrëdhëniet tona, filloi të më godasë, të abuzojë më mua dhe të marrë vendime pa më

pyetur mua aspak. Këtu në Shqipëri e kemi si traditë që problemet t'i zgjidhim me sherre dhe terror."

Zakonet kulturore në lidhje me të qenit e bindur, si dhe traditat e familjes dhe normat e komunitetit, kanë precedencë përpara të drejtave individuale thotë Lira, një mësuese e papunë: "Im shoq ka mbaruar fakultetin por problemi është se ai vjen nga një familje tradicionale ku gruaja duhet të bindet dhe burri duhet të jetë arrogant dhe i plotfuqishëm." Në një traditë të tillë gratë kanë më shumë detyra se të drejta. Denada, një punëtoze nga Shkodra ve në dukje: "Ky është një zakon që e kanë Kosovaret. Gruaja duhet t'i lajë burrit këmbët sapo që ai vjen në shtëpi, t'i japë atij për të ngrënë ndërsa ai shtrihet dhe shikon televizor. Ai nuk duhet të shqetësohet nga fëmijët. Gruaja nuk ka të drejtë që ta pyesë burrin se ku ishte, çfarë bëri dhe a solli ndonjë para në shtëpi. Në mënyrë që të plotësoja zakonet e tij unë duhej të zbatoja të gjitha rregullat e tij. Unë nuk kisha të drejtë të shkoja në asnjë vend, të vishesha mirë apo të bëja makiazh. Edhe kur bëja ndonjë dush përpara se të shkoja në punë ai më pyeste, *"Pse bëre dush?"*

Hendeku gjinor në rolet familjare

Një variabël që lidhet me abuzimin martesor është edhe qëndrimi tradicional përkundrejt roleve në familje. Studimi ve në dukje se marrëdhëniet abuzive midis partnerëve kanë më shumë gjasa që të ndodhin dhe të vazhdojnë nëse çifti, veçanërisht burri mbart qëndrime tradicionale përkundrejt roleve familjare. (p.sh. burri siguron të ardhurat e familjes, gruaja kujdeset për shtëpinë dhe familjen). Në mënyrë të veçantë në një shoqëri patriarkale, burrave u jepet supremaci për sa

kohë ata sigurojnë të ardhurat e familjes. Konkluzione të tilla përputhen me përfundimet tona të cilat tregojnë se çdo burrë ose partner i konsideron punët e shtëpisë si përgjegjësi ekskluzive e gruas së tij. Desantila, një nëpunëse civile nga Shkodra dhe nënë e dy fëmijëve, shpjegon se si janë 'ndarë' punët e shtëpisë në familjen e saj: "Unë bëj çdo gjë në shtëpi. Puna e burrit tim është shkojë në punë, të dalë çdo mbrëmje, të shtrihet dhe t'i gjejë të gjitha gati." Edhe kur gruaja është me arsim të lartë, ajo nuk është e përjashtuar nga barra e punëve të shtëpisë. Diana, farmacistë dhe nënë e një fëmije ve në dukje: "Në Shqipëri kemi një traditë shumëvjeçare sipas të cilës burrat nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për punët e shtëpisë. Unë bëj çdo gjë, pastroj, laj, hekuros, gatuj, etj."

Nga gratë pritet që të mbajnë shtëpinë, të rrisin fëmijët dhe të jenë të bindura dhe të respektueshme me burrat e tyre. Silvana, 31vjeç, mësuese nga Tirana thotë: "Sipas opinionit të burrit tim, gruaja duhet të jetë shtëpiake, duhet të dijë se si të gatujë, të bëjë punët e shtëpisë, të mbajë marrëdhënie të mira me të afërmit e burrit të saj, të pranojë opinionet e të tjerëve, të jetë e ëmbël, e dashur, seksi, tërheqëse, dhe të përmbushë dëshirat e burrit në çdo moment." Merita, robaqepëse nga Tirana, nënë e dy fëmijëve i pranon rolet e saj tradicionale në familje, edhe pse kjo për të do të thotë që të copëtohet nga barra e trefishtë që i duhet të përballojë çdo ditë: "Unë bëj çdo gjë që një grua duhet të bëjë. Unë pastroj, gatuj, dhe kujdesem për fëmijët e mi. Burri im nuk është në punë, megjithatë ai nuk bën asnjë punë shtëpie. Atij as që i shkon në mend që të bëjë ndonjë gjë. Unë as që pres prej tij që të bëjë ndonjë punë shtëpie, por të paktën të më ndihmojë për të pastruar tavolinën pasi ka ngrënë, sepse unë jam aq e lodhur nga puna e përditshme si dhe nga kujdesi për fëmijët."

Nëse një burrë kupton se gruaja e tij ka dështuar në një farë mënyre në përmbushjen e rolit të saj, i ka kaluar kufijtë e saj apo ka ndërhyrë në të drejtat e tij, atëherë ai mund të bëhet i dhunshëm. Kjo pikpamje tradicionale vihet re në komentin e një 40 vjeçareje nga Shkodra, nënë e tre fëmijëve: "Unë kam punuar shumë për familjen time gjatë gjithë martesës.

Im shoq bën vetëm punën në vendin e tij të punës; ai vjen në shtëpi vetëm për të ngrënë dhe për të fjetur. Mua më duhet që të ngrihem në mëngjes në orën pesë dhe të merrem me gjithshka deri në mes të natës. Im shoq nuk është përpjekur asnjëherë që të më ndihmojë mua në zgjidhjen e problemeve të familjes. Për më tepër ai herë e sjell dhe herë nuk e sjell rrogën në shtëpi, por unë nuk kam kurrë kurajo që ta pyes se ku i ka paratë. Pyetje të tilla mund të më kushtojnë shtrenjt." Një grua tjetër e grupit ndan me ne të njëjtën përvojë: "Që ditën e parë unë bëra të gjitha punët që duhet të bëjë një grua pa u ndihmuar aspak nga burri im. Ai e ka shtëpinë si hotel; ha, fle, ndërrohet dhe del. Kur vjen i pirë kam akoma më shumë punë se vjell gjithë kohës. Në rastet më të këqija ai më godet jo vetëm mua por edhe djalin tim. Ndonjëherë unë nuk mundem ta toleroj." Evelina, nënë e tre fëmijëve thotë: "Unë ngrihesha herët në mëngjes, shkoja në punë në fermë dhe kur kthehesha në shtëpi kujdesesha për fëmijët. Unë laja, gatujta, hekurosja, përgatisja dreka dhe darka për burrin tim, të afërmit e tij dhe shpesh herë edhe për miqtë që vinin shpesh tek ne. Ai nuk bënte asgjë. Nëse nuk i pëlqente ndonjë gjë që e kisha bërë unë, fillonte të bërtiste dhe të më shante." Justifikimet për dhunën shpesh vijnë nga normat gjinore për rolet dhe përgjegjësitë e burrave dhe grave. Mimoza shpjegon: "Burri është burrë dhe gruaja duhet t'i vijë atij nga pas, por të paktën ai nuk duhet të abuzojë me gruan e tij, dhe duhet të punojë për të mbajtur familjen."

Procesi i marrjes së vendimeve

Siç deshmohet edhe nga rëfimet e grave, me përjashtim të faktit që gjatë 50 viteve të fundit gratë shqipëtare u bënë gjithmonë e më tepër forcë pune, rolet tradicionale në familje nuk u ndryshuan. "Pengesja e vetme për të patur të drejta të barabarta është mentaliteti i burrave shqipëtarë – megjithëse ai thotë se është burrë i emancipuar evropian, etj, genet e tij mashkullore shqipëtare do t'ia kujtonin se kontrolli është i atij. Edhe nëse do ta kuptonte se gruaja fitonte më shumë të holla ai do të thoshte: *Këtu jam unë dhe të ardhurat e tua i kontrolloj unë,*" thotë Erika, një ekonomiste nga

Tirana. Dafina, një grua e papunë nga Tirana komenton kështu: "Për burrat tanë është turp që t'i lenë gratë të marrin vendime, ose që të pranojnë se gruaja gjykon më mirë. Për këtë arsye ata nuk e marrin në konsideratë gjykimin e saj kur marrin vendime."


Nga tregimet e grave, burrat abuzivë duket se janë më dominantë në marrjen e vendimeve në familje. Bojana, një punëtoreshë nga Berati e përshkruan qartë konceptimin e saj për burrat shqipëtarë: "Në Shqipëri të gjithë burrat janë komandantë. Ka qenë gjithmonë kështu, por ndofta gjërat do të ndryshojnë gradualisht. Burrat shqipëtarë vendosin për çdo gjë. Gruaja punon ndërsa burri jep urdhra, gruaja mban peshën e punëve ndërsa burri mban të hollat."

Gratë duhet të bëjnë të pamundurën që të mbajnë familjen. Ato duhet të përmbushin rolin e tyre si bashkëshorte dhe nëna dhe të jenë të gatshme të sakrifikojnë edhe jetën e tyre për hatër të martesës. Jonida, mjekë, thotë: "Im shoq donte që unë të isha përgjegjëse për ekonominë e familjes, ndërkohë që kujdesi për fëmijët dhe punët e shtëpisë ishin padiskutim detyrat e mia. Do të ishte më mirë nëse do të vendosnim së bashku si për shpenzimet në familje ashtu edhe për edukimin e fëmijëve. Por ai donte që të gjithë të bënin ekzaktësisht atë që thoshte ai. Kështu që filluan zëniet. Unë vendosa që ta toleroj në mënyrë që të shmangia konfliktet dhe të ruaja harmoninë në familje, megjithëse kjo do të thoshte që të pranoja të më trajtonin keq."

Fatmira, një grua e papunë nga Tirana, nënë e dy fëmijëve shprehet kështu: "Ai më dëgjon shumë rrallë, zor se i konsideron idetë e mia. Zakonisht ai vendos për gjithshka. Ai mban edhe të hollat. Unë kurrë nuk kam patur të holla për veten. Unë isha vetëm një grua që duhet të rrija në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijët dhe punët e shtëpisë"

Shumica e grave vënë në dukje se burrat e tyre ishin mbartës të kulturës tradicionale që i dikton gruas nënshtrim ndaj burrit. Në kundërshtim me këtë, shumica e grave nuk ishin pro roleve tradicionale gjinore. Gratë shprehin dëshirën për të qenë të barabarta me burrat e tyre. Por siç vihet re edhe nga deklaratimet e grave, rolet tradicionale gjinore janë të vështira për t'u ndryshuar. "Të drejtat e barabarta midis burrit dhe gruas nuk kanë ekzistuar kurrë në Shqipëri, dhe nuk ekzistojnë edhe në të tashmen. Faktori kryesor ndikues është trashëgimi i një mentaliteti që i konsideron gratë si shërbëtoreshë të shtëpisë," thotë një grua 50 vjeçare nga Berati. Një mësuese 31 vjeçare nga Tirana shpjegon: "Të drejta të barabarta midis gruas dhe burrit do të thotë që burri të mos thotë më: *Unë jam burri i shtëpisë dhe ti duhet vetëm të më dëgjosh mua, të më bindesh, të më respektosh, të kujdesesh për fëmijët dhe punët e shtëpisë.* Këtu në Shqipëri nuk i dëgjon njeri gratë, ndërkohë që bashkëshortët sillen gjithmonë si 'burra' të cilëve duhet t'u binden gratë. Unë mendoj se arsyeja për një situatë të tillë është mentaliteti shqipëtar."

Tregimet e grave vërtetojnë se rolet tradicionale gjinore mund të shkatërrojnë marrëdhëniet e partnerëve. Zakonet e kulturës patriarkale e identifikojnë gruan si pronë të bashkëshortit të saj dhe me status të nënshtruar në martesë. Roli tradicional i gruas shqipëtare në familje është të kujdeset për fëmijët dhe shtëpinë. Burrat shqipëtarë nuk i kuptojnë marrëdhëniet e partneritetit midis burrit dhe gruas për të përballuar punët e shtëpisë. Modeli dominues mashkullor e pengon përfshirjen e gruas në procesin e marrjes së vendimeve. Me rënien e komunizmit, gruaja shqipëtare u çlirua nga shtrëngimi i statusit autokratik dhe represiv. Për fat të keq, kjo nuk solli si rezultat mundësi dhe përgjegjësi të barabarta për burrat dhe gratë. Ato akoma duhet të veprojnë sipas normave të përcaktuara nga burrat.



DHUNA E USHTRUAR

“Vetëm një muaj pas martesë ai filloi të abuzonte me mua. Ai më gjuante me shpulla, me shqelma, me grushta, dhe më godist kokën mbas murit. Unë nuk di se si t’i përshkruaj këto episode. Ai me godistë në shpinë. Njëherë më goditi aq keq sa për një moment nuk munda të marr dot frymë dhe pata dhimbje për më shumë se një javë. Mezi merrja frymë dhe nuk kollitesha dot. Ai u përpoq edhe të më mbyste, më godiste me sende të forta deri sa me dilte gjak. Unë nuk bërtisja se nuk doja të më dëgjonin fëmijët. Ata u trembën aq shumë sa u detyrova të largohesha nga shtëpia dhe t’i merja edhe ata me vete. Ne e kaluam natën jashtë dhe u kthyem në shtëpi kur ai kishte ikur në punë. Kur u kthye nga puna vazhdoi të më mallkojë që isha kthyer. Ai donte që të ikja nga shtëpia por unë nuk kisha ku të shkoja. Mendoja se gjërat do të përmirësoheshin por ai nervozohet sa herë që më shihte. Atij nuk i bëhej vonë edhe pse unë përpiqesha dhe bëja të pamundurën për të qenë e mirë me të.” (Bardha, 42 vjeç nga Tirana, teknike, nënë e pesë fëmijëve).

Dhuna e burrave ndaj grave në përgjithësi karakterizohet nga privatësia, që do të thotë se tenton të shmangë vëzhguesit e jashtëm. Rëfimet e grave dëshmojnë se abuzimi është një fenomen kompleks që përmban forma të ndryshme që variojnë nga poshtërimi, izolimi, prostituimi i detyruar, seksi me dhunë dhe deri tek plagosjet. Abuzimi nga partnerë intimë në përgjithësi është më tepër pjesë e një prototipi sjelljeje abusive dhe kontrolli, se sa një akt izolimi apo agresioni fizik. Stela, një mësuese nga Tirana thotë: “Ai më kërcënonte duke më thënë se do të m’i merte fëmijët. Njëherë unë i thashë atij se do ta divorcoja. Ai ma mori vajzën për një javë. A mund ta mendoni se si u ndjeva unë gjatë atyre ditëve? Ashtu si ç’do të bënte çdo nënë tjetër nëse nuk do të kishte fëmijën e vet, unë isha shumë e trembur dhe nuk munda as të fle. Nuk e dija se ku e kisha vajzën. Dilja nëpër rrugë që në 5 të mëngjesit për ta kërkuar. Më ndihmoi vëllai. Thirrëm policinë. Ndofta ai u tremb nga policia dhe ma solli vajzën në shtëpi.”

Evelina, një grua e papunë, nënë e tre fëmijëve kujton: “Njëherë ai erdhi shumë vonë në shtëpi, kur unë isha 8 muaj shtatzënë. Unë ndjehesha shumë e lodhur ngaqë isha shtatzënë. Filloi të grindej për një çështje pa vlerë. Unë nuk i kisha hekurosur këmbët apo pantallonat dhe për këtë arsye u nevrkos me mua. Filluam të ziheshim dhe ai me goditi me shpullë. Kjo ishte shpulla e parë por që në atë kohë jeta ime ndryshoi. Ai vazhdoi ta bëjë këtë për 15 vjet

rresht. Filloi të më shajë dhe ofendojë duke më tërhequr zvarrë nëpër dhomë për të më rrahur. Në shumicën e rasteve fëmijët ishin present. Nëna e tij i nxirrte ata jashtë që të mos më shihnin duke ulëritur dhe duke qarë.” Një grua tjetër, teknike dhe nënë e dy fëmijëve e përshkruan si më poshtë dhunën e partnerit të saj: “Kur unë them se im shoq është i dhunshëm, unë nënkuptoj me këtë i dhunshëm në të gjitha drejtimet e mundshme. Ai refuzon të flasë me mua, më mbyt për fyti, dhe kur ishte oficer në ushtri, më kërcënonte me armë. Ai i ka provuar të gjitha me mua.”

Procesi i dhunës në familje është më tepër i ndërlikuar dhe fluid se sa i thjeshtë dhe i qëndrueshëm. Fakti që gratë janë shpesh herë të përfshira emocionalisht me ata që abuzojnë me to, krijon implikime të thella në mënyrën se si e përjetojnë ato dhunën. Sonila, një grua e papunë 46 vjeçare nga Tirana, shprehet konfuzë në lidhje me sjelljen e burrit të saj, “Pasi me rrihte ai fillonte të më merrte me të mirë duke më thënë *Unë të dua; Kam nevojë për ty; Unë të rraha se ti më ngrite nervat; Nuk do ta bëj më kurrë; Nëse nuk më beson je e lirë të bësh ç’të duash*. Unë e besoja atë dhe qëndroja me të. Por pas pak ditësh ai fillonte të më rrihte përsëri. Unë nuk mund ta besoja se si mund ta bënte ai këtë gjë me gruan e tij, me mua që për një ditë isha gjithshka për të, dhe të nesërmen fillonte të më rrihte përsëri! Megjithatë unë përpiqesha që ta justifikoja

duke thënë se ndofta unë e zemëroja për një moment, por ai megjithatë më donte mua." Një grua tjetër 31 vjeçare me universitet, e përshkruan marrëdhënien e saj të vështirë me të shoqin kështu: "Atë ditë unë shkova në punë më herët se zakonisht sepse mbledhja e këshillit pedagogjik ishte në mëngjes. Ai erdhi në punën time dhe më mori me vete. Ishte shumë, shumë i zemëruar. Në fillim unë kujtova se kishte ndodhur ndonjë gjë e keqe dhe se ai donte të ma thoshte. Ai filloi të më ulërijë pa

arsye: *Ku ishe?* Pastaj më futi në makinën e tij dhe më rrahu aq keq sa më theu edhe krahun. Unë nuk mund të bëja asgjë për momentin; U luta vetëm që të mbijetoja, të mos vdisja, se ai ishte aq i nxehur si ngjante me një bishë. Më pas vendosa ta lija. Ai filloi të më kërkonte të falur dhe unë mendova ta falja, se meqë kjo ishte hera e parë që më rrihte, ai nuk do ta bënte më. Unë e doja dhe mendoja se edhe ai ndjente të njëjtën gjë. Por e kisha gabim, sherret u përsëritën gjithnjë e më shumë."

Abuzimi psikologjik

"Ne kishim dy vjet që ishim martuar dhe një ditë unë kujtova se isha shtatzënë. Në mëngjes unë zbulova se në fakt nuk isha shtatzënë. Ai filloi të më kërcënonte: *Nëse nuk mbetesh shtatzënë unë do të të kthej tek yt atë.* Unë qava shumë..... Ai nuk erdhi në shtëpi atë ditë. Unë prisja e frikësuar që ai të kthehej. Kur u kthe në darkë, kisha frikë prej tij dhe rrija në cep të krevatit. Ai m'u afrua dhe filloi të më përkëdhelë. Pra, unë isha përsëri me të. Kur mbeta shtatzënë ai nuk më rrahu më.... Arturi ishte jashtë çdo ditë. Kur unë e pyesja: *Ku ishe gjithë ditës?*, ai zakonisht përgjigjej me inat: *Mos më pyet, nuk e kam për borxh që të përgjigjem*, dhe fillonte të më ofendonte: *Je si ato jevgat. Mbylle gojën! Do të të kthej mbrapsh tek jot ëmë, etj.*" (Mimoza, 32 vjeç, punëtore nga Berati).

Shumica e abuzimeve psikologjike ndodhin në kontekstin e formave të tjera të abuzimit si ai verbal, emocional, ekonomik dhe izolimi social. Të gjitha gratë në studim kanë vuajtur lloje nga më të rëndat si të abuzimit fizik ashtu edhe psikologjik. Ky përfundim vë në dukje se burrat që ushtrojnë abuzim fizik, ushtrojnë edhe abuzim emocional. Gratë shpesh shrehen se abuzimi psikologjik si dhe degradimi, janë shpesh herë më të vështirë për t'u përballuar se sa abuzimi fizik. Një farmacistë 50 vjeçare thotë: "Kam jetuar në tmerr për katër vjet. Gjatë kësaj kohe kam vuajtur shumë. Këto qenë vite të errta për mua. Unë e kisha frikë atë. Më vonë vura re se edhe e ëma e kishte frikë atë. Ne kishim vetëm gjashtë muaj që ishim martuar kur ai më tha: *Akoma nuk ke mbetur shtatzënë?* Kjo ishte me të vërtetë e papritur... Unë u gëzova pa masë kur mësova se isha shtatzënë. Edhe ai u gëzua. Megjithatë zëniet tona vazhduan gjatë gjithë shtatzanisë. Shtatzania ime nuk ishte e lehtë; Unë kisha të përzjera vazhdimisht dhe pothuajse gjatë gjithë kohës

m'u desh të qëndroja në krevat. Ai me bërtiste: *Ngrihu! E pse duhet të jesh ndryshme nga gjithë gratë e tjera?*"

Aktet e abuzimit fizik dhe psikologjik shpesh herë i janë drejtuar jo vetëm të intervistuarave por edhe pjesëtarëve të familjes si dhe shokëve. Stela thotë: "Dhuna psikologjike ishte e përhershme deri në ditën që u ndamë, dy javë më parë. Ai më kërcënonte duke më thënë se do bënte këtë – atë mua dhe familjes time. Ai më ofendonte gjithë kohës duke më thënë fjelë të ndyra; më kërcënonte duke më thënë se do të më kthente mbrapsh tek imë, të bërë në copa. Një nga arsyet se pse unë jetova me të ishte se ai më kërcënonte. Unë e kisha frikë se ai ishte i dhunshëm jo vetëm me mua por edhe me të tjerët."

Poshtërimi verbal si ngjitja e nofkave, fjalët e ndyra dhe turpërimi janë raportuar shpesh. "Ai gjithmonë më quante idjote. Nese unë e pyesja ai më përgjigjej: *Ti nuk di asgjë. Je idjote. Nuk*

merr vesh nga jeta. Dhe të gjitha këto ishin të natyrshme për të sepse ai kishte qenë në Itali disa here, ndërsa unë asgjekundi," thotë një grua 20 vjeçare e divorcuar. Fatmira shton: "Ai më poshtëronte duke më bërë që të ndjehesha budallaqe dhe e çmendur. Kur vinte në shtëpi i pirë, ai e kishte zakon të thyente sende në shtëpi si radion, pjatat. Ai gjithashtu na përzinte nga shtëpia."

Rëfimet e grave për abuzimet emocionale ilustrojnë gjithashtu procesin gjatë të cilit gratë fillojnë të demoralizohen dhe të bien në kurthin e marrëdhënieve abusive. Shumë gra përmendin se abuzimi psikologjik ndikon shumë në

vetëvlerësimin e tyre. Një grua 40 vjeçare, punëtore, nga Shkodra thotë: "Ai më quan idjote, budallaqe. Unë ndjehem me të vërtetë e ofenduar, e poshtëruar. Unë e ndjej veten si njeri vetëm kur jam me motrat dhe nënën time." Grave shpesh u thuhet se ato nuk janë tërheqëse fizikisht, janë inferiore ose të pazonjat, nuk mund t'ia dalin mbanë,; apo të kenë sukses të vetme, dhe se nuk janë bashkëshorte, nëna dhe nikoqire të mira. Një grua tjetër e martuar nga Shkodra thotë: "Ai nuk la mënyrë pa përdorur për të më turpëruar. *Unë po të ushqej mirë, prandaj je bërë si lopë,* më tha ai. Unë u përpoqa që të mbroja veten, por pa rezultat. Ai u bë edhe më i egër e më i dhunshëm."

Kërcënimi verbal dhe fizik

"Dhuna ishte gjithmonë e pranishme. Unë kisha menduar edhe më parë për ta divorcuar, por kur i thashë se ai nuk ishte burri i duhur për mua, ai nxori armën dhe ma vendosi në kokë. Ai më tha se nëse do ta lija ai do të më vriste. Kjo ishte arsyeja se pse unë nuk mund të ndahesha prej tij. Unë isha e pambrojtur, se edhe prindërit e mi ishin të divorcuar." (Dafina, 22 vjeç, punëtore nga Tirana, e divorcuar me dy fëmijë)

Në përgjithësi, gratë që rrihen i nënshtrohen edhe formave të tjera të abuzimit si ai psikologjik. Kërcënimet janë më të zakonshmet, ato kanë për qëllim terrorizimin e gruas deri në atë pikë sa partneri mashkull ta ndjejë veten zot të kontrollit. Një mësuese shprehet: "Në fillim ia më kërcënohte duke përmendur divorcing. Ai vazhdon të më kërcënojë duke thënë se do të më marrë djalin, ose nuk do të më paguajë pensionin për fëmijën në rast se do ta divorcoj. Më pas ai filloi të më kërcënojë me armë." Një grua tjetër nga Tirana thotë: "Një herë ai abuzoi aq keq me mua sa unë vendosa ta divorcoja. Ai më bënte shumë presion duke më thënë se nëse do të kërkoja divorcin, ai do ta hidhte shtëpinë time në erë, do të na vriste të gjithëve, dhe se po të largohesha jasht shtetit ai do të më gjente dhe do të më vriste. Ai u përpoq disa herë të më merrte djalin që të më detyronte që

të kthehesha tek ai." Një grua e papunë 20 vjeçare shprehet se nga frika ajo ndjehej edhe e pashpresë: "Në shumë raste që ai hidhte mbi mua ç'të gjente mbi tavolinë: tavllën e duhanit, telefonin, etj. Më pas fillonte të më rrihte. Ai më kërcënonte se do të më vriste nëse do ta lija. Gjithmonë thoshte, *nëse do më lesh, je e vdekur. Unë do të të vras.* Unë kisha frikë prej tij dhe nuk dija se si t'i jepja fund një situatë të tillë rrëqethëse."

Me kalimin e kohës, abuzimi emocional dhe kërcënimet krijojnë tek gruaja një qendrim pasiv, vetëvlerësim të ulët dhe 'pranimin e të qenit të pashpresa' në marrëdhënie me partnerët e tyre. Kjo vihet re tek demonstrimi nga ana e tyre i papërmbajtjes si dhe i mungesës së një marrëdhënie të qartë midis përgjigjes dhe rezultatit.

Dhuna fizike

"Ai më rrihte shumë shpesh. Unë kisha vraga në çdo pjesë të trupit tim sepse ai ishte mësuar të më godiste me çdo gjë që i vinte për mbarë: këpucë, sandale, litar. Unë shkoja në punë me të çara në fytyrë dhe nëpër duar. Më vinte turp nga miqtë e mi dhe përpiqesha të gjeja shpjegime nga më të ndryshmet për plagët që kisha. U largova nga shtëpia disa herë dhe rrija tek prindërit. Pas çdo rasti dhune ai qetësohej dhe më thoshte se unë isha gruaja e tij të cilën ai e donte aq shumë. Ai gjithmonë kërkonte nga unë që të kthehesha tek ai, dhe unë e beja këtë vetëm për hatër të djalit tim." (Aurela, 42 vjeç, mësuese nga Tirana, e divorcuar dhe nënë e një fëmije).

Kur të intervistuarat përshkruajnë dhunën, ato përmendin një sërë incidentesh që varjojnë nga një shpullë e deri tek goditja me armë. Përfundimet kanë vërtetuar se gratë janë goditur me shpulla, grushta, shqelma, janë përplasur pas murit ose orendive shtëpijake, janë tërhequr zvarrë nëpër shtëpi osë hedhur jashtë shtëpie, janë kapur nga flokët ose mbërthyer për fyti. Atyre u kanë thyer krahët dhe mbi to kanë shuar edhe cigare. Grave u kanë vënë armë në kokë, i kanë detyruar të kryejnë seks me pahir dhe i kanë kërcënuar me thika dhe granata. Një grua e martuar, 31 vjeç dhe nënë e tre fëmijëve përmend situatën e mëposhtme: "Ai gjithmonë me rrihte shumë, por më kujtohet një rast kur më rrahu si asnjëherë. Atë ditë ai erdhi në shtëpi shumë vonë dhe krejtësisht i dehur. Filloi të më rrahë dhe unë nuk e kuptoja se pse. Ai rrëmbeu një shishe dhe ma theu në kokë. Mua më rridhte gjak. Duart i kisha të prera. Pastaj ai më tërhoqi zvarrë nga flokët, më nxorri jashtë shtëpie dhe më la atje. Më ndihmoi një komshie. Ajo më mbajti në shtëpinë e saj." Një grua tjetër 44 vjeçare tregon: "Me mua ka abuzuar që në fillim të martesës. Ai më ka dhunuar në mënyrë të vazhdueshme për 25 vitet e fundit... Gjithmonë thoshte se do të më vriste. Më gjuante me shqelma, me gërshtë, pirun, etj. Arsyeja kryesore e kësaj sjelljeje ishte alkooli; im shoq pinte shumë. Por ai ishte i dhunshëm edhe kur nuk ishte i pirë." Një grua 46 vjeçare e divorcuar, nënë e dy fëmijëve tregon një shembull tjetër të dhunës fizike: "Njëherë ai më dogji me cigare. Ai më ka thyer edhe kockat. Unë nuk shkoja as në spital dhe as nuk e raportoja në polici sepse kisha shumë frikë prej tij"

Aktet e dhunës fizike për shumë gra rezultojnë në çarje, përdredhje dhe thyerje kockash. Një grua e papunë nga Tirana tregon: "Ai vinte në shtëpi dhe më rrihte pa asnjë arsye. Vëllezërit e tij më kanë çuar në spital dy tre herë pasi kisha fraktura. Pasi kalonte një orë, ai qetësohej dhe kërkonte prej meje që ta falja. Për një muaj më trajtonte mirë dhe më pas fillonte përsëri."

Dhuna fizike shumë shpesh përfshin edhe sjellje kontrolluese si për shembull monitorimi i lëvizjes së gruas. Mos bindja ndaj roleve dhe pritshmërive gjinore tradicionale, duke përfshirë edhe dyshimin për pabesi nga ana e gruas, sjell gjithashtu si pasojë dhunën fizike. Për shembull, një mësuese 31 vjeçare, nënë e dy fëmijëve shpjegon: "Vajza ime ishte një muajsh kur ai erdhi një mbrëmje në shtëpi dhe filloi përsëri me supozimet e veta: ... *ti ke dalë, ti e ke takuar atë*", ndërsa unë kisha qenë gjithë ditën në shtëpi. Megjithatë ai filloi të më gjuajë me shqelma. Unë kisha vajzën në krahë dhe bëra ç'mos që ajo të mos binte e të vritej. Më pas, këto episode të dhunshme u bënë edhe më të shpeshta. Për më tepër, ai vinte në shtëpi krejtësisht i dehur pothuajse për natë. Hera e fundit që ai përdori dhunë ndaj meje ishte kur isha shtatzënë më djalin. Ai sherr ishte ekstremisht brutal; me goditi me gjithë forcën që mund të godasë një burrë. Ai ishte përsëri i dehur. Të nesërmen në mëngjes kur unë u ngrita nga gjumi nuk e njoha dot veten në pasqyrë, fytyra ime ishte plot të çara."

Dy gra përmendin dhunën brenda brezave: "Mua më rrihte vjehri, kunati dhe burri im. E ç'mund të bëja? Im shoq mund të bënte çdo gjë

që i thoshte i ati. Nëse i ati do t'i thoshte se gruaja e tij nuk ishte një grua e mirë, ai do të më rrihte edhe më shumë. Unë nuk mund të thoja asgjë sepse kisha frikë dhe turp," thotë Amarda, e ve 67 vjeç.

Nëntë nga grate e intervistuar, ishin abuzuar që në fëmijëri ose kishin qenë dëshmitare të dhunës midis prindërve të tyre. Përvojat e grave nga fëmijëria ishin shumë të ndryshme: disa mendonin se fëmijëria e tyre kishte qenë shumë e lumtur, ndonëse me konflikte të vogla; të tjera mendonin se familjet e tyre kishin qenë shumë abuzive. "Kur isha e vogël babai me rrihte shumë. Unë e kam parë tim atë të abuzonte me mamanë time disa herë. Kur im atë e rrihte nënën unë përpiqesha gjithmonë që t'i ndaja, kështu që ai më rrihte edhe mua. Njëherë ai më goditi mua me një shishe në kokë; ai e kishte zakon të gjuante me ç'të kishte në dorë," rikujton një grua e re e divorcuar, 22 vjeçare dhe nënë e një fëmije. Një grua 20 vjeçare e divorcuar tregon duke u dredhur: "Im shoq u soll shumë mirë gjatë muajve

të parë të martesës. Pastaj ai filloi të vinte vonë natën ose të pinte dhe të bëhej xheloz. Kur unë përpiqesha të thoja diçka, ai bëhej nervoz, bërtiste ose më rrihte... Më kujtohen fjalët e gjyshes time: "Nëse nëna vuan, edhe e bija do të vuajë." Unë jam vajzë e vetme në familjen time. Nëna ime ka vuajtur mjaft. Im atë ka abuzuar tmerrësisht me të. Ajo e pranoi këtë realitet. Ajo gjithmonë i lutej zotit që e bija të kishte një fat më të mirë se i saji. Për fat të keq i njëjti fat më priti edhe mua. Im atë ishte i dhunshëm me nënën time, po ashtu edhe burri im me mua." Dafina, një grua e re shtatzënë rikujton fëmijërinë e saj me hidhërim: "Gjithë jetën time i jam nënshtruar dhunës; im atë ka qenë gjithmonë i dhunshëm. Ai pi dhe zihet me nënën, e rreh atë dhe e përze nga shtëpia. Ai i thotë asaj fjalë të rënda. Kur bëhet i dhunshëm ai bërtet, shan, thyen orendi dhe e dhunon nënën time. Ai e godet atë, e shqelmon dhe e kërcënon me thikë. Ndonjëherë unë përpiqem t'i ndaj por ai fillon të më godasë edhe mua. Kur vonë vjen natën, unë i fsheh thikat sepse i di pasojat."

Terrorizimi i partneres

"Ai ka abuzuar me mua për 16 vjet rrjesht me të gjitha mënyrat, seksualisht, fizikisht. Nuk di nga t'ia nis. Herën e fundit që pata probleme me tim shoq ishte kur ai më abuzoi mua fizikisht në mënyrë çnjerzore. Ai kurrë nuk më ka trajtuar mirë, më shqelmonte dhe më përzinte nga shtëpia bashkë me të dy fëmijët e mi. Ai sillte si kafshë, sikur të mos isha e shoqja. Por herën e fundit ai më kërcënoi se do më vriste me revolen e tij. M'u desh të largohesha nga shtëpia dhe të kërkoja strehë në qendrën pritëse. Ai është shumë agresiv dhe nuk i bëhet vonë nëse do t'i duhet të shkojë në polici; Jam përpjekur me të gjitha mënyrat, por atij nuk i bëhet vonë. Unë jam akoma e frikësuar megjithëse jemi të divorcuar. Ai është një burrë i rrezikshëm. Kurrë nuk i dihet se ç'mund të bëjë." (Fatmira nga Tirana, 46 vjeç, e divorcuar dhe e papunë, nënë e dy fëmijëve).

Shumica e grave të intervistuar janë abuzuar disa herë fizikisht nga partnerët e tyre. Në fakt, të intervistuarat e përshkruajnë situatën si një situatë terrori. Një e treta e grave tregojnë se në disa raste, ato kanë patur edhe frikë për jetën e tyre. Terrorizimi motivohet nga dëshira për të ushtruar kontroll ndaj partneres. Problemi i dhunës në familje komplikohet edhe nga niveli i lartë i papunësisë si dhe problemi i strehimit. Shpesh herë, gratë e divorcuara kanë qenë të detyruara të duronin të tillë marrëdhënie abusive sepse nuk kanë patur se ku të shkonin.

Një grua 36 vjeçare, e papunë nga Tirana tregon se si ish burri i saj e terrorizonte atë edhe pse ishin të divorcuar. "Një ditë im shoq më tha: *Unë nuk të dua më. Do kërkoj divorcing*. Kështu që ne u divorcuam por vazhduam të jetonim të ndarë por në të njëjtin apartament. Ai vazhdoi të më kërcënojë. Ai erdhi në shtëpi me granata në duar duke ulëritur se do t'i shpërthente ato. Gjithashtu më kërcënoi se do të m'i merrte fëmijët dhe do m'i shiste në Itali. Kështu që, unë u detyrova që të denoncoj në polici."

Terrorizimi i partnerit shpesh krijon dëmtime serioze si dhe rrezik të lartë për vetëvrasje. Nëntë gra (16% të të intervistuarave) kanë raportuar se janë kërcënuar me armë vdekjeprurëse si revole, granatë ose thikë. Dituria, një punëtoreshë nga Tirana dhe nënë e gjashtë fëmijëve, shprehet e tmeruar nga episodi i fundit i dhunës. Ky rast e kishte bindur atë më në fund që të divorcohej: “Unë shpresoja se ai do të ndryshonte, por kjo nuk ndodhi kurrë. Ai ishte gjithmonë i dhunshëm. Herën e fundit erdhi në shtëpi me një armë dhe ishte shumë agresiv. Në fillim më kërcënonte me thikë, por më pas bleu një armë dhe filloi të më kërcënojë me të. Ai bile edhe më plagosi. Kur përdori armën ishin present edhe tre nga fëmijët e mi. Është e pabesueshme se si mundi të përdorë armën në sy të fëmijëve. Për fat, atyre nuk u ndodhi asgjë. Ai nuk më gjuajti por vetëm më kërcënoi duke gjuajtur me armë në dyshe dhe nëpër mure. Unë u largova sapo gjeta një moment të përshtatshëm. Fëmijët më ndoqën nga pas. Kur ne u larguam ai filloi të na

gjuajë. Fëmijët u tmerruan, ata kujtuan se do të na vriste. Unë u thashë atyre që të vraponin dhe unë vrapova pas tyre. Ai vazhdoi të na gjuajë, plumbi i tretë më plagosi. Unë vazhdova të vrapoja se nuk doja të bija në duart e tij. Fëmijët u tmerruan se më panë të gjakosur. Ata filluan të qanin... Një makinë që ndaloi pranë meje, më mori dhe më çoi drejt e në spital.”

Shumë gra jetojnë me frikë për jetën e tyre por edhe të fëmijëve dhe familjes. Edita, një grua e martuar nga Tirana dhe nënë e dy fëmijëve thotë: “Njëherë ai mori armën dhe donte të më vriste mua dhe fëmijët. Prindërit e mi ishin atje. Ai ishte i dehur si zakonisht dhe donte të shiste shtëpinë që të paguante borxhet. Unë nuk e pranova këtë sepse nuk kisha ku të shkoja. Ai nxori armën dhe më kërcënoi se do më vriste. Pastaj u largua duke e mbyllur derën nga jashtë.”

Sjelljet dominuese dhe abuzimi fizik nuk përdoret vetëm si mjet për t'i kontrolluar gratë por edhe ve në rrezik jetën e tyre.

Dhuna seksuale

“Në të gjitha rastet që më dhunonte fizikisht, më detyronte edhe që të bënim marrëdhënie seksuale. Pasi më gjuante me shqelma dhe trupi im mbulohej me gjak, ai bëhej i dhunshëm edhe seksualisht. Për mua ishte shumë poshtëruese që të bëja marrëdhënie seksuale ndërkohë që isha e dhunuar fizikisht! Ndiheha shumë e poshtëruar. Shpesh e shihja veten në pasqyrë dhe pyesja se cili ishte problemi im. Tani që ka vetëm dy javë që e kam lënë, ndihem më mirë, e ndjej veten njeri. Kurse kur isha me të, e abuzuara, e ofenduar, e akuzuar pa arsye, kisha harruar se isha grua.” (Stela, 31 vjeç, mësuese, nënë e dy fëmijëve).

19 nga 55 gratë e intervistuarat ishin nënshtruar si dhunës fizike ashtu edhe abuzimit seksual (35% e të intervistuarave). Përvoja e grave të dhunuara seksualisht vërteton se dhuna bëhet e vazhdueshme dhe varion nga forma jo fizike të saj si tallje, kërcënime, fjalë poshtëruese dhe presion për t'i detyruar të kryejnë seks pa dëshirën e tyre e deri në rrahje dhe përdhunim. Në një marrëdhënie abusive, seksi është një formë tjetër kontrolli nga ana e meshkujve, me qëllim që të fitohet zotërimi i plotë i gruas. Këto strategji kontrolli shpesh fokusohen drejtpërsëdrejti tek trupi i viktimës dhe seksualiteti i saj. Një akt seksual është i

detyrueshëm kur bëhet në mënyrë të tillë që gruaja të heshtë, të vihet nën kontrollin dhe vrësinë e burrit.

Tregimi i Stelës vërteton se në kontekstin e një marrëdhënie të dhunshme, gratë edhe përdhunohen ose detyrohen të kryejnë seks me dhunë. Gratë nuk janë në gjendje që t'i etiketojnë përvojat e tyre si përdhunime, gjë që tregon se koncepti i përdhunimit martesor është i panjohur në kulturën shqipëtare. Për këto gra, seksi është rezultat i sjelljeve kërcënuese të burrave të tyre. Në raste të tilla seksi i padëshiruar ndodh si rezultat i frikës nga reagimet negative të burrit.

Sonila, një 20 vjeçare e papunë nga Tirana tregon: "Njëherë ai më kërcënoi me thikë. A ulëriu: *Unë do të të vras, do të të vras!* Pastaj donte të bënte dashuri me mua. Filloi të më thonte: *Ti je e imja. Unë nuk do të le njeri të të prekë.* Ai mbante në njëren dorë thikën dhe me tjetrën përpiqej të më zhvishte robot. Ndërsa vepronte kështu, më plagosi pa dashur. Ai nuk donte ta bënte, por mua m'u desh të shkoj tek doktori për ta mjekuar plagën."

Për disa gra, kryerja e seksit është një mënyrë e shpejtë për të ulur zemërimin e burrave si dhe për të shmangur dhunën. Nga përvojat e mëparshme, gratë kanë mësuar se nuk duhet të zihen me burrat dhe se duhet të bëjnë çdo gjë që kërkojnë ata. Fatmira, një grua e divorcuar 37 vjeçare dhe nënë e dy fëmijëve thotë: "Ai kërkonte që të bënim seks pasi më kishte rrahur në mënyrë të tmershme. Unë kisha aq frikë sa e lejoja që të bënte ç'të donte. Kishte edhe raste që vinte i dehur dhe më thoshte se kishte qenë me një grua tjetër."

Disa gra e ndjejnë se janë të detyruara të përmbushin detyrën dhe të bëjnë seks me burrat e tyre. Ky lloj zotërimi e ka bazën tek koncepti se gruaja është e detyruar të përmbushë nevojat e burrit, pavarësisht dëshirës së saj. Susana, një punëtoare 34 vjeçare nga Tirana thotë: "Unë ndjehesha e detyruar të plotësoja dëshirat e tij seksuale sepse isha gruaja e tij. Megjithatë, unë kurrë nuk merja iniciativën për të bërë seks me të. Unë kurrë nuk e dëshiroja seksin me të. Duhej të pranoja kërkesat e tij përndryshe ai do të më detyronte me forcë. Ka patur vetëm disa raste të rralla që unë bëja shaka me të duke i thënë: *Jo, jo! Ik tani. Nuk dua të,* ai më godiste me shqelma dhe më përzinte nga krevati duke më sharë."

Abuzimi seksual përfshin gjithashtu edhe procesin në të cilin burri e turpëron gruan duke i thënë se gratë e tjera janë shumë më 'seksi' dhe më të dëshirueshme se ajo. Një grua 27 vjeçare nënë e tre fëmijëve thotë: "Kur unë refuzoja të bëja seks me të ai më thoshte: *Nuk kam nevojë për ty, Kam një grua tjetër. Ja, tani po shkoj tek ajo,* dhe largohej nga shëpia."

Në marrëdhënie të tjera, abuzimi seksual shoqërohet me aq shumë kërcënime verbale sa që krijohet një atmosferë frike dhe e mbushur

me ankthin se çfarë do të ndodhte nëse do të refuzonte të bënte seks me burrin e alkolizuar. Ky manipulim seksual bëhet nga dhunuesi me qëllim degradimin emocional të partneres së vet. Evelina, nënë e tre fëmijëve, e papunë, tregon: "Sa herë që kthehej në shtëpi vonë dhe i dehur, ai më gjuante që të më zgjonte dhe më detyronte të bëja seks me të. Njëherë ai më tha, *Ik moj! Ti nuk je e zonja për seks, dhe asnjëherë nuk ke qenë.*" Një grua e divorcuar, nënë e tre fëmijëve thotë: "Ai dilte me një grua tjetër. Por mua nuk më bëhej vonë për këtë. E vetmja gjë që doja prej tij ishte të mos më rrihte më. Unë u ndava prej tij dhe shkova të jetoja me prindërit e mi bashkë me fëmijët. Më pas vendosa të kthehesha përsëri tek ai. Por punët u keqësuan akoma më. Ai filloi të vinte në shtëpi me të dashurën. Ai jetonte me të dashurën në të njëjtin apartament ku jetonim edhe ne."

Nga rëfimet e grave mund të vihet re një qëndrim i dyfishtë, sipas të cilit burrat mendojnë se për ta, ndryshe nga gratë e tyre, është e lejueshme që të kenë marrëdhënie jasht-martesore. Gratë që nuk kanë autonomi seksuale shpesh nuk kanë fuqi që të negociojnë për përdorimin e kontraktivëve, dhe për rrjedhojë, janë të rrezikuara ndaj shtatzanive të padëshiruara dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, duke përfshirë edhe infeksionin HIV/AIDS. Një mësuese, nënë e një fëmijë thotë: "Unë kam bërë gjashtë aborte sepse ai refuzonte të përdorte kontraktivë. Kjo bëri që unë të ndjehesha e turpëruar dhe e ofenduar, sepse e mbaja veten për grua të emancipuar, që ishte rritur në Tiranë dhe edukuar në universitetin e Tiranës."

Të intervistuarat gjithashtu përmendin se kanë qenë të detyruara të praktikojnë lloje të tilla seksi që i konsiderojnë të turpshme dhe degraduese. Një grua punëtoare nga Tirana, nënë e dy fëmijëve, në intervistën e saj përmend se si i shoqi e detyronte të shikonte pornografi dhe të bënte akte të ndryshme seksuale. Ajo thotë: "Unë ndjehem me turp që t'u tregoj juve të tilla gjëra. Ai kishte në shtëpi një sirtar plot me videokaseta porno. Shpesh, përpara se të flinim duhet të shikonim një nga këto kaseta. Mua ato më dukeshin të ndyra dhe nuk kisha dëshirë që t'i shikoja. Por ai kërkonte nga unë që të bëja ato që shihte në kasetë. Por

ato ishin aq të ndyra sa nuk mund t'i bëja. Unë i thoja atij se nuk doja të bëja gjëra të tilla por ai më detyronte me forcë."

Denada, 28 vjeçare, nënë e dy fëmijëve e përshkruan kështu përvojën e saj: "Ai u çmend. Një mbrëmje më tregoi për disa shofërë turq që vinin në punën e tij dhe që kishin aq para sa mund të paguanin 5,000 Lek (USD 35) për ta bërë njëherë me një grua. Në fillim unë nuk e kuptova se pse ma tha këtë. Kur e kuptova se ku e kishte hallin u tmerrova. Ai më tha se meqë ne nuk kishim shumë të para, unë mund të fitoja në këtë mënyrë. Ai më tha se mund të mbaja për vete një pjesë të parave dhe t'i jepja atij pjesën tjetër. Nuk munda t'i besoja veshëve. Isha me të vërtetë e llahtaritur. Unë kurrë nuk kisha menduar se një burrë mund të kishte guximin që t'i thoshte gruas së vet gjëra të tilla. Thashë me vete se është çmendur, përderisa një herë bënte si xheloz dhe pastaj kërkonte nga unë që të bëja gjëra të tilla. Unë i thashë atij se nuk isha nga ato gra. Pastaj unë e kisha punën, kisha një rrogë, e pse më duheshin ato para? Kujtova se ia ktheva mendjen por një mbrëmje ai më pyeti përsëri se ç'mendoja për një biznes të tillë. U tërhoja. Nuk munda ta toleroj përsëri. Ai e kuptoi se ishte e pamundur që të më bindte për të bërë atë që dëshironte,

kështu që filloi të përdorë dhunën fizike. Ai filloi të më thotë se nuk i kisha bërë punët siç duhet dhe se nuk kisha larë mirë. Ai nuk gjente dot asnjë arsye tjetër prandaj përdori punët e shtëpisë si arsye për t'u zënë me mua. Ai ishte shumë brutal, kurrë nuk e humbiste rastin për të më goditur, sikur edhe për gjënë më të vogël që mund të kisha bërë. Më shkulte flokët, më godiste me grushta. Isha aq e dëshpëruar."

Në shumë nga këto marrëdhënie, fakti i mosdashjes së seksit është i panjohur nga askush, bile edhe nga burrat; "Ai nuk më pyet asnjëherë nëse dua apo jo të bëj dashuri me të; ai thjesht e bën. Kjo është një nga traditat e tij: kurrë mos e pyet gruan. Gjithashtu, ai nuk pranon kurrë që të përdorë kontraceptivë.... Unë nuk jam e sigurt nëse ai ka ndonjë lidhje jashtë martese, ndofta po. Sipas traditës, kjo është gjithashtu diçka normale," thotë Lira, 28 vjeç, nënë e dy fëmijëve.

Nëpërmjet detyrimit ose kërcënimit për të bërë seks, apo insinuatave ose ekzistencës së marrëdhënieve seksuale me një grua tjetër, burrat jo vetëm i bëjnë gratë e tyre që të ndjehen të pazonjat emocionalisht, fizikisht dhe seksualisht por edhe që të jenë të paqarta për identitetin e tyre si gra.

Izolimi social

"Atij i pëlqen të ketë autoritet mbi gruan e tij sepse ai beson se kështu duhet të sillt një burrë. Abuzonte me mua gjatë gjithë kohës, edhe sepse shkoja tek shtëpia e prindërve. Më izoloi nga familja. Unë nuk i kam folur motrës time për 15 vjet sepse ai nuk më linte. Tek prindërit mund të bëja vetëm ndonjë vizitë të shkurtër. Tek kushërinjtë e mi më lejohej të shkoja vetëm e shoqëruar prej tij, asnjëherë vetëm." (Inisi, 46 vjeç, e martuar me dy fëmijë, punëtore nga Tirana).

Dhuna fizike shpesh shoqërohet me përpjekje për të kontrolluar veprimtaritë sociale të gruas si dhe për të monitoruar lëvizjet e saj. Disa partnerë përpiqen të kufizojnë aktivitetin e grave me mënyra të ndryshme si kufizimi i kontaktit me familjen dhe shoqet, duke i akuzuar ato se i kushtojnë shumë vemendje gjerave ose njerëzve të tjerë, si dhe duke i ndaluar që të shkojnë në punë. Një grua 31 vjeçare thotë: "Në fillim ai më linte që të shkoja për vizitë tek prindërit, por më vonë nuk më la

më. Merreni me mend, të dy familjet tona jetojnë në Tiranë por ne mund të shihem shumë rrallë. Në shumë raste unë kam këmbëngulur që të shkoja për vizitë tek nëna ime, por ai më mbyllte brenda shtëpisë me çels. Dhe një gjë të tillë e bënte përditë. Ka patur raste që ai ka qënë me shërbim jasht Tirane dhe unë rrija e mbyllur me çels në shtëpi. Nëna ime vinte dhe më shikonte nga dritarja. Ajo donte të telefononte policinë por unë nuk e lija. Nëna dhe komshinjtë më jepnin ushqim nga

dritarja..... E kisha të pamundur që të flisja me shoqet. Unë kam patur dy shoqe pune, por i kam humbur lidhjet me to. Ai nuk më lejonte të kisha shoqe ose të ftoja shoqe në shtëpi. Unë isha gjithmonë e izoluar, e vetme brenda shtëpisë, i përkisja vetëm atij. Ky ishte edhe qëllimi i tij.”

Një grua tjetër e divorcuar, 50 vjeç, me banim në Berat thotë: “U gëzova pa masë kur gjeta punë në një farmaci. Megjithatë lumturia ime nuk zgjati shumë sepse ai filloi të më kërcënojë. *“Unë nuk dua të të shoh më me të (me një shoqe të punës),” “Ajo është llafazane,” “Ajo është e përdalë”* etj. Njëherë kur u ktheva nga puna, sapo hyra në dhomë ai filloi të më rrahë dhe të më gjuajë me shqelma. Ai bërtiste: *“A nuk të pata thënë që të mos shoqërohesh më me të përdalat e farmacistë? Pse nuk bën si të them unë?”*

Izolimi social është një aspekt kompleks i dhunës në familje. Abuzuesi mund t’i imponojë gruas izolimin në mënyrë që të fitojë kontrollin ndaj saj. Nga ana tjetër, gruaja e abuzuar mund t’i krijojë vetë kushtet për izolimin e saj, si pasojë e të qenit e pafuqishme dhe e pashpresë. Ariola, një punëtore pastrimi nga Tirana, nënë e dy fëmijëve, ve në dukje: “Ai gjithmonë përpiquej të më izolonte nga shoqëria. Unë nuk mund të shkoja për vizitë tek shoqet. Orari im i punës ishte nga ora 7:00 deri në 3:00, dhe ai donte që unë të isha në shtëpi fiks në

3:00. Nëse vonohesha vetëm një minutë, ai më rrihte, më shqelmonte, më gjuante me grushta. Ai më ofendonte në sy të kolegeve.”

Për të shmangur dhunën, shumë gra e çensurojnë sjelljen e tyre sipas mënyrave që mund të quhen të pranueshme nga partnerët. Një grua e re 28 vjeçare, e papunë thotë: “Atij nuk i pëlqen që unë të lyhem, as të vesh rroba të mira. Ajo që më mërzi më shumë është fakti që ai kërkon prej meje që të izolohehem, të merrem me të gjithë punët e shtëpisë dhe t’i shmang kontaktet me njerëzit. Duhet t’i mar gjithmonë leje përpara se të dal jashtë. Ai më kontrollon dhe më izolon, por kurrë nuk më ka mbyllur brenda me çels, sepse unë i bindem.”

Izolimi social i gruas mund të bëhet faktor reziku për dhunën në familje dhe t’i paraprijë abuzimit. Rritja e kontrolli është një strategji e partnerëve abuzivë për të reduktuar aftësinë e gruas për t’u shkëputur nga marrëdhëniet abusive. Një grua e re 26 vjeçare nga Tirana thotë: “Ai më mbyllte shpesh brenda në shtëpi duke pretenduar se po më mbronte, se nuk donte të më zgjone nëse do të isha në gjumë kur ai të kthehej në shtëpi. Ai u kishte thënë të gjithë nipërve dhe mbesave të tij që të përgjonin lëvizjet e mia gjatë ditës.” Një grua tjetër e re përmend: “Im shoq më rrihte kur largohesha nga shtëpia. Por unë kisha nevojë të dilja, nuk mund të jetoja si në burg. Ai erdhi në shtëpi dhe filloi të bërtiste se pse kisha dalë nga shtëpia.”

Abuzimi ekonomik

“Im shoq nuk ka një punë fikse. Ndonjëherë ka punë e ndonjëherë i duhet të presë. Atij nuk i bëhet vonë për të ardhurat. Unë isha përgjegjëse për të ardhurat dhe mbulimin e problemeve financiare të familjes. Megjithatë, unë nuk kisha asnjëherë të drejtë t’i mbaja paratë për t’i administruar. Paratë i mbante ai, por borxhet duhet t’i kërkoja unë. Nëse nuk do pranoja, ai do më rrihte. Ai merrte paratë e rrogës time apo ato që i kisha marrë borxh, dhe i pinte ose i prishte në bixhoz. (Oriola, juriste, 40 vjeç, e divorcuar, nënë e dy fëmijëve).

Abuzimi ekonomik është një formë tjetër abuzimi në të cilin gratë janë viktimat kryesore. Burrat tradicionalisht kanë kontrolluar dhe dominuar mbi të ardhurat financiare të familjes, dhe kanë patur fuqinë në marrjen e vendimeve

financiare në familje. Taktikat e abuzuesve për të dominuar financiarisht gratë e tyre janë të ndryshme. Një grua 32 vjeçare, punëtore nga Berati, rikujton: “Sa herë që ne mbeteshim pa para, im shoq më detyronte që t’i kërkoja borxh

babait ose vëllezërve të mij. Mua më vinte turp që të kërkoja borxh kaq shpesh. Nëse refuzoja që ta bëja këtë, im shoq më rrihte. Një ditë ai donte që t'i kërkoja babait 2 milion Lekë për të riparuar dyert dhe dritaret e shtëpisë. Unë nuk doja që të kërkoja borxh, por ai më bindi. Kështu, ne shkuam të dy në shtëpinë e prindërve të mij. Kur po bëheshim gati për të ikur, ai më pëshpërti në vesh: *Zoti të ruajtë nëse nuk i ke thënë gjë babait tënd për paratë.* Unë i kisha marrë babait 1 milion Lekë (USD 7,500) por nuk i kisha thënë tim shoqi. Rrugës për në shtëpi ai turfullonte si kalë. Kur arritëm në shtëpi dhe ai më pyeti nëse i kisha marrë paratë, unë pata kurajon t'i thoja: *Shko puno si gjithë të tjerët.* Atë moment ai u nevrikos aq shumë sa filloi të më rrahë e të më gjuajë me shqelma. Në mënyrë që ai të qetësohej, unë i tregova atij paratë që më kishte dhënë babai. Kur pa paratë u çudit dhe u gëzua."

Një grua thotë se abuzimi ekonomik dhe financiar shoqërohet me kontrollimin në përdorimin e parave si dhe mundësisë për t'i siguruar ato, me ndalimin e pjesëmarrjes së gruas në vendimet për shpenzimin e parave, si dhe me refuzimin e dhënies së parave për t'u prishur nga ana e saj për nevojat themelore të shtëpisë. Burrat vazhdojnë të kontrollojnë burimet financiare edhe në rastet kur gjendja financiare e gruas jashtë shtëpisë, është më e favorshme se e burrit. Kontributi financiar i grave në familje nuk zvogëlon apo influencën në pozitën dominante të burrit të saj brenda familjes. Një punëtore nga Tirana, nënë e tre fëmijëve thotë: "Unë isha gjithmonë e mërzitur sepse ai zihej me mua dhe zemërohej gjithmonë për të njëjtën arsye: paratë. Sytë i kisha gjithmonë të nxirë si pasojë e dhunës që ushtronte mbi mua. Ai vinte në shtëpi i dehur dhe i prishte të gjitha paratë që unë kisha fituar, duke pirë alkool. Kur nuk kisha para për t'i dhënë ai fillonte të më bërtiste dhe të më gjuante në sy të kujdo." Një grua tjetër, 37 vjeç, nënë e dy fëmijëve, ve në dukje: "Ai punonte, por të gjitha paratë që fitonte i prishte duke pirë. Akoma më keq, ai i prishte paratë me shokët e tij për të blerë thika, thika të mëdha nga ato që janë të ndaluara. Mesa di unë, ai blinte edhe armë. Ai i shpenzonte paratë vetëm për veten e tij, asnjëherë për familjen. Ai

largohej nga shtëpia në mes të natës, merrte me vete të gjitha paratë dhe i prishte. Ishte bërë e zakonshme për të që të vinte tek puna ime dhe të më kërkonte para të cilat i prishte më pas për të pirë. Unë ia jepja atij sepse më vinte turp që të zihesha me të në punë."

Rëfimet e grave dëshmojnë se burrat e tyre i kanë rrahur ato shpesh dhe u kanë marrë fitimet. Rudina, një grua e divorcuar 36 vjeçare nga Berati, rikujton: "Ai e donte të gjithë rrogën time, por unë nuk doja që t'i jepja atij gjithë çfarë fitoja. Unë duhet të kujdesesha për fëmijët dhe veten, kështu që refuzova t'ia jepja paratë. Prandaj ai më rrahu, më mori paratë dhe u largua nga shtëpia për dy javë." Një grua 62 vjeçare nga Tirana, e tregon si më poshtë episodin e saj të fundit në lidhje me dhunën: "Ai u zemërua dhe u bë i dhunshëm sepse rroga ime nuk ishte e mjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet. Disa ditë më parë unë nuk kisha para që t'i jepja dhe ai më rrahu, më goditi aq keq në sy sa për pak humba shikimin. Siç e shihni, syrin e kam akoma të zi. M'u desh të shkoja në spital për ta mjekuar. Ata më këshilluan që të shkoja në qendrën e këshillimit."


Nëntë nga gratë që janë intervistuar (16%) raportojnë që partnerët e tyre nuk i kanë lejuar që të mbanin para për veten. Një punëtore 44 vjeçare thotë: "Kur jetoja me të unë nuk kisha para për nevojat e mija personale. Unë i jepja atij rrogën dhe ai më jepte para vetëm për të blerë ushqimet." Një grua tjetër 45 vjeçare, nënë e dy fëmijëve, punëtore në një argjendari tregon: "Unë kam një punë por nuk jam e lirë, ai m'i merr të gjitha paratë. Ai nuk pyet për ne dhe për nevojat që kemi."

Abuzimi ekonomi përfshin në dy raste edhe ndalimin e gruas për të qenë e pavarur në fitimin e të ardhurave, nëpërmjet një pune jashtë shtëpisë. Një grua 40 vjeçare nga Shkodra, nënë e tre fëmijëve, thotë: "Ai nuk më linte të punoja. Ai nuk më linte të largohesha nga shtëpia." Dhuna fizike mund të shkaktojë efekt negativ në statusin ekonomik të gruas. "Ndonjëherë unë nuk shkoja dot në punë nga shenjat e shkaktuara nga dhuna. Kisha turp të shkoja në punë kur fytyra ime ishte me të nzira

dhe të çara." thotë një grua 44 vjeçare nga Berati, nënë e dy fëmijëve. Dominimi financiar, ashtu si edhe ai psikologjik, fizik dhe seksual, krijojnë efekte të rënda negative në mirëqenien emocionale, sociale dhe fizike të gruas.

Në historitë e grave, përvojat me dhunën përbëjnë aspektin e heshtur të abuzimit nga partnerët. Viktimat e dhunuara nga partnerët e tyre raportojnë një sërë aktesh abuzive. Ato në përgjithësi lidhen me abuzimin fizik, por pothuajse në të gjitha rastet dhuna e bashkëshortëve përfshin edhe komponentë psikologjikë, seksualë, socialë dhe ekonomikë. Dhuna është e formave të ndryshme, por që

ndërlidhen me njëra-tjetrën. Dhuna ndaj grave bëhet e vazhdueshme dhe shpesh thellohet nga më e lehta në akte dhune tepër serioze. Shumica e grave janë abuzuar disa herë nga partnerët e tyre. Kjo situatë është rrjedhojë e besimit dhe sjelljeve tradicionale të burrave, që favorizojnë marrëdhëniet dominuese dhe të varësisë të burrave ndaj grave të tyre. Është e dukshme që mentaliteti patriarkal është faktor kyç që mbështet dhunën e vazhdueshme në familje. Ndryshueshmëria e rasteve individuale si dhe kombinimi i komponentëve të dhunës në familje, është aq i madh sa është e vështirë që të përcaktohen profilet, si të viktimave ashtu edhe të dhunuesve të tyre.





TË QENIT GRUA E ABUZUAR

“Unë qaj për orë të tëra dhe askush nuk më mbështet. Gjithmonë përpiqem të gjej se si mund të bëhem më e fortë, në mënyrë që ta përballoj situatën dhe të mos dorëzohem. Jam gjithë kohës e stresuar aq sa nuk mund të fle. Kam frikë se mos edhe vajza ime vuan si unë. Më duket vetja si skllave. E ndjej veten si qenie njerëzore inferiore, dhe besoj se divorci me tim shoq do më bëjë të ndjehem akoma më keq. Më ka shkuar mendja edhe tek vetëvrasja, sepse nuk shoh asnjë zgjidhje. Burra si këta nuk duhet të sillen si mostra.” (Inis, 46 vjeç, e martuar me dy fëmijë, punëtore nga Tirana).

Dhuna e vazhdueshme fizike e shoqëruar edhe me abuzimin emocional, seksual dhe ekonomik, krijon tek gratë efekte të shumfishta. Përveç ndryshueshmërisë në format e abuzimit dhe kontekstin në të cilin gratë janë viktimizuar, partnerët e përdorin dhunën edhe për t'i privuar gratë nga mirëqenia dhe integriteti i tyre fizik, psikologjik dhe social. Shumë nga të intervistuarat përmendin pasoja të ndryshme të shkaktuara nga dhuna, si fizike ashtu edhe psikologjike. Gjashtë gra kanë raportuar se barra e abuzimeve është aq e rëndë sa u ka shkuar ndër mend edhe të vetëvriten. Frazat tilla si: “Ndjehem aq e lodhur. Ndonjëherë mendoj se për mua do të jetë më mirë të vdes se sa të jetoj në kushte të tilla.” (Eli, e martuar me tre fëmijë). “Ndonjëherë mendoj të vras veten por me vjen keq për fëmijët. Ata janë aq pa faj.” (Etleva, e martuar me dy fëmijë). Një përvojë e ngjashme sillen nga një grua tjetër, mësuese nga Tirana, nënë e një fëmije: “Kur vinte nata unë ndjehesha në ankth. Kisha probleme me frymëmarrjen dhe zemra më rrihte fort. Mendoja të vrisja veten duke pirë helm. Doktorin më rekomandoi të marr ilaçe. Këto më ndihmuan.”

Trupi dhe dhuna

Shtatë pjesëmarrëse tregojnë se dhuna fizike e ushtruar nga partnerët e tyre u kishte shkaktuar plagë dhe fraktura që kishin nevojë për ndërhyrje mjeksore dhe trajtime afatgjata. Disa prej tyre dëshmojnë se rasti i dhunës që kishin përjetuar mund të kishte sjellë si pasojë edhe vdekjen e tyre. Në përgjithësi, pjesëmarrëset

raportojnë se pasojat e dhunës së ushtruar ndaj tyre ishin të çara dhe nxirje. Për shembull, një grua 33 vjeçare nga Berati, nënë e dy fëmijëve, përmend: “Në fytyrë kisha të nxira, kokën e kisha të enjtur, nga vetulla më dilte gjak. Kërkova ndihmën e një infermjereje që të vinte në shtëpinë time dhe të më mjekonte.” Një grua tjetër nga Shkodra, e papunë, nënë e dy fëmijëve thotë: “Jam aq e lodhur. Trupin e kam gjithmonë copë. Im shoq vjen në shtëpi dhe e ka hobby që të gjuajë, të më shqelmojë e të më ngjisë nofka.”

Por plagët nuk janë i vetmi rezultat i dhunës fizike të meshkujve. Abuzimi sjell si pasojë një shumicë sëmundjesh fizike si çrregullime gastrointestinale, hipertension dhe sindroma të ndryshme dhimbjesh. Në rastin e dy grave, dhuna gjatë shtatzanisë ka rezultuar në dështim si pasojë e goditjes me grusht në bark nga ana e partnerit. Një nga pjesëmarrëset përmend lindjen e parakohëshme. Gjithashtu, disa pjesëmarrëse përmendin se dhuna seksuale u kishte shkaktuar shtatzani të padëshiruara. Një grua tregon se ishte infektuar nga infeksione të transmetuara seksualisht.

Disa gra ndjehen aq të raskapitura, sa që trupi i tyre nuk u intereson më dhe shkëputen prej tij. Kjo lloj shkëputje mendore është shumë e përhapur mes të mbijetuarave. Susana, 34 vjeç, punëtore nga Tirana, e martuar me një fëmijë thotë: “Trupi im është dru. Unë nuk ndjej asgjë, njëlloj sikur trupi im të mos më përkiste”. Një grua tjetër e martuar, 33 vjeç, thotë: “Nuk ndjej më asgjë. Zemra ime është shdëruar në gur.”

Trajtimi i traumës

Thëniet në thonjëza, demonstrojnë gamën e gjërë të pasojave të dhunës në familje për shëndetin e gruas. Është e kuptueshme që një grua që beson se është e pashpresë dhe e pambrojtur si pasojë e abuzimit ndaj saj, e ka të vështirë që të mobilizojë forcat e duhura për t'u shkëputur nga kjo marrëdhënie. Rëfimi i Inisit (shiko thënien) ilustron procesin nëpërmjet të cilit një grua e abuzuar fillon të demoralizohet, të humbasë energjitë dhe të bjerë në kurthin e marrëdhënies abuzive. Suzana përjeton të njëjtën përvojë: "Kam frikë dhe ndjehem e vetmuar. Qaj shumë, sepse jam e vetme dhe e pazonja për të reaguar."

Nuk është aspak çudi, që gratë që kanë pësuar dhunë fizike, psikologjike ose seksuale, vuajnë nga çrregullime emocionale. Edita, e martuar me një fëmijë, punëtore nga Tirana thotë: "Kam dhimbje koke dhe nuk më ze gjumi. Kur ai vjen në shtëpi jam gjithmonë e friksuar. Atë e kam frikë, kam frikë ta kaloj gjithë mbasditën me të." Denada, një punëtore nga Shkodra, nënë me një fëmijë thotë: "Nuk fle dot nga frika. Rri gjithë ditën duke parë televizor dhe më kap ankthi kur afrohet koha që im shoq vjen në shtëpi. Atij nuk i dihet koha e ardhjes në shtëpi, mund të vijë në çdo orë të natës. Kështuqë, unë jam nën presionin dhe frikën se ç'mund të ndodhë kur të kthehet në shtëpi."

Fjalët fyese të partnerit shkaktojnë tek gruaja rënimin e vetë-vlerësimit dhe ndjenjën e të qenit e pazonja si person, grua, punëtore, bashkëshorte dhe nënë. Shumë gra i konsiderojnë pasojat psikologjike të abuzimit shumë më serioze se sa ato fizike. Një grua e divorcuar 37 vjeçare thotë: "Unë ndjehesha si skllavja e tij, si një person jo normal. Ndjehesha e shtypur dhe isha gjithmonë e frikësuar. Edhe tani unë vuaj nga dhimbjet e kokës dhe jam e depresuar." Një e ve 54 vjeçare, mjeke, nënë e dy fëmijëve komenton: "Kishte ditë që unë ndjehesha e padobishme; nuk kisha respekt për veten; isha e depresuar, por meqë isha vetë mjeke, merrja mjekim pa patur nevojë që të konsultohesha me dikë për problemet e mia. Përpiqesha që të mos i tregoja problemet e mia. Nuk shkoja më për vizitë tek shoqet në mënyrë

që ato të mos e kuptonin depresionin tim." Procesi i abuzimit e ndryshon gradualisht mendimin e grave ndaj vetvetes, marrëdhëniet dhe vendin e tyre në shoqëri. "Unë kam frikë dhe e konsideroj ekzistencën time në këtë botë si të kotë. Mbi të gjitha, unë e kam frikë burrin tim dhe gjithashtu ndjehem e ndrojtur përpara të tjerëve," thotë një grua e martuar 28 vjeçare, nënë e dy fëmijëve.

Të intervistuarat, kur komentojnë pasojat psikologjike të dhunës fizike, seksuale dhe emocionale, në shumicën e rasteve përmendin se ndjehen të depresuara dhe në ankth. Të tjera probleme shëndetsore që përmenden nga gratë e abuzuara janë lodhja, dhimbje të shpinës dhe të kokës, acarimi dhe pagjumësia. Një grua e divorcuar 36 vjeçare nga Berati thotë: "Unë kisha probleme serioze me pagjumësinë. Nuk mund të flija gjithë natën. Mund të flija vetëm po të pija ilaçe. Rrija zgjuar dhe mendoja se ç'do të bëhej me jetën time." Nga gratë përmendet shpesh depresioni, që është një nga faktorët më të rëndësishëm që sjell si pasojë mendimin dhe aktin e vetëvrasjes. Një grua tjetër e divorcuar, 28 vjeç thotë: "Unë ndjehesha shumë e mërzhitur. Isha shumë e depresuar. Kur e mendoj them me vete se si munda të eci, punoj, jetoj."

Shumë gra të abuzuara vuajnë nga çrregullime të stresit post-traumatik, një gjendje ankthi që mund të ndodhë kur njerëzit kalojnë, ose janë dëshmitarë të një ngjarje traumatike, si pasojë e të cilës ata ndjehen tejet të pashpresë ose të kërcënuar për vdekje. Simptomat përfshijnë përjetimin e ndodhisë traumatike nëpërmjet rikujtimit ose "rishfaqjes"; përpjekjen për të shmangur çdo gjë që do t'i kujtonte traumën; boshllëku emocional; vështirësi në përqëndrim dhe pagjumësi; dhe alarmimi për çdo gjë. Diana, një grua e divorcuar 50 vjeçare komenton: "Kanë kaluar vite që jam divorcuar dhe akoma përjetoj kujtimet e atyre viteve. Ai më shkatëroi rininë; ai shkatëroi trupin tim dhe donte të më shkatëronte edhe personalitetin. Unë i kam shpesh sytë me lot, dhe për këtë më vjen keq, por shpresoj që të më kuptoni; rinia ime shkoi e nuk kthehet më." Një mësuese nga Tirana, 44 vjeçare thotë: "Unë pi qetësues sepse nuk fle dot. Ndjehem në gjendje ankthi


dhe alarmi edhe kur ai sillet normalisht, sepse mjafton të dalë e të pijë me shokët, dhe të kthehet e të fillojë të njëjtën histori nga e para.”

Të jetosh me pasojat

Dhuna në familje i izolon gratë në mënyrë direkte ose indirekte nga rrjeti i tyre mbështetës. Ato gradualisht pakësojnë aktivitetin e tyre social me kërkesën e partnerëve të tyre, ose nga turpi apo nga merakuri për të mos i shqetësuar miqtë dhe familjen. Një grua nga Shkodra, nënë e një fëmije tregon: “Unë jam shndëruar në një person aspak miqësor, e tërhequr në vetvete dhe pasive. Unë nuk mund të mar pjesë në bisedat e shoqeve të mija; unë nuk mar pjesë dot në gëzimet e tyre. Jam gjithmonë në ankth se ç’më pret në shtëpi.” Pasojat e dhunës përfshijnë gjithashtu paaftësinë për të punuar ose për të kryer aktivitetet ditore. Një grua e divorcuar thotë: “Unë isha gjithë kohës e acaruar, nuk punoja dot. Shoqet i refuzoja. Në mënyrë të vazhdueshme përpiqesha të fshihja të vërtetën nga familja ime.” Denisa, 37 vjeç, e martuar me një fëmijë shpjegon: “Dhuna influencon mbi mua në mënyra të ndryshme. Unë përpiqem të jem një nënë e mirë, por dhuna nuk të lejon të tregosh kujdesin e duhur ndaj fëmijëve të tu, sepse pasi je rrahur nga

burri ose je zënë me të, ndjehesh e shkatëruar psikologjikisht. Pa dyshim që dhuna influencon edhe në punën tënde përdorisa nuk je në gjendje të punosh ashtu si do të doje; duart punojnë por mendja nuk është aty. Dhuna influencon edhe marrëdhëniet sociale sepse bën që të jesh e mërziur dhe e tërhequr. Kur të gjithë qeshin, ti nuk qesh dot sepse e ke mendjen tek ajo që po ndodh me ty dhe burrin tënd. Nuk ke forca të gëzosh në asnjë aktivitet apo në kohën e lirë, sepse nuk të jep leje personi që një natë më parë edhe të ka rrahur.”

Dhuna në familje shkakton pasojat të thella në mirëqenien e gruas në përgjithësi. Ushtrimi i dhunës në familje i ve gratë përpara një reziku të madh për shëndetin fizik dhe mendor duke përfshirë plagosjet, depresionin, ankthin, çrregullime të stresit post-traumatik, pagjumësi, vetëvlerësim të ulët, humbjen e besimit për jetën dhe tendencë për vetëvrasje. Kjo influencë e dhunës në familje, mund të vazhdojë pas ndalimit të dhunës edhe për një kohë të gjatë. Sa më i rëndë të ketë qenë abuzimi, aq më të thella janë pasojat në shëndetin fizik dhe mendor të gruas. Ndikimi i llojeve të ndryshme të abuzimit dhe episodet e shumfishta, duket se vijnë duke u rritur me kalimin e kohës. Në formën e vet më ekstreme, dhuna në familje i vret gratë.



SHQETËSIMI PËR FËMIJËT

“Ai abuzonte edhe me fëmijët. Mua nuk më bëhej vonë në më donte apo jo. E vetmja gjë që doja prej tij ishte që të paktën të donte fëmijët e vet. Ai nuk e donte djalin tonë të madh, sepse njerëzit thonin se ai më ngjante mua. Fëmijët duhet të gëzohen dhe jo të kenë frikë kur vjen babai në shtëpi. Fëmijët e mi e kishin frikë të atin. Kur vinte ai në shtëpi ata rrinin urtë. Një ditë, kur im shoq po më rrihte, djali im i madh rrëmbeu thikën dhe donte ta vriste, por unë munda që ta ndaloj atë në kohë. Im bir më thoshte shpesh “Më mirë të vdes.” (Rudina, 36 vjeç nga Berati, e divorcuar, nënë e tre fëmijëve, e papunë.)

Fëmijët ndikohen thellë nga jetesa në një mjedis të dhunshëm, të frikës dhe kërcënimit, pavarësisht nëse mbi ta ushtrohet dhunë fizike ose jo. Nëntëmbëdhjetë gra (34%) kanë treguar se burrat e tyre i kanë dhunuar fizikisht fëmijët e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Gratë shprehin shqetësimin e tyre për pasojat që ka dhuna në jetën e fëmijëve të tyre. Një grua e divorcuar thotë: “Ai e rrihte vajzën dhe djalin tim, dhe u bërtiste atyre pa asnjë arsye. Në të shumtën e rasteve, kur zihej me mua, i godiste edhe fëmijët. Ai kurrë nuk u fliste atyre ëmbëlsisht. Fëmijët e mi nuk e dinë se çdo të thotë të kesh një baba të dashur dhe të kujdesshëm.” Një nënë tjetër komenton: “Kur fëmijët e shohin të atin të vijë në shtëpi i dehur, duke bërtitur, duke u rrahur mamanë, edhe pse nuk dëmtohen direkt, ata janë të abuzuar, sepse shohin, ndjejnë dhe mbajnë mend gjëra që vetëm të rriturit mund t’i përballojnë; ata bëhen të tërhequr dhe vuajnë brenda vetes. Fëmijët e mi janë të traumatizuar.”

Fëmijët si viktimë

Burrat abuzivë dhe baballarët i viktimizojnë fëmijët në mënyra të ndryshme. Fëmijët bëhen shënjestra alternative e kontrollit dhe dominancës mashkullore. Një grua e re, nënë e dy fëmijëve tregon: “Ai abuzon edhe me vajzën tonë; nuk është dhunë fizike, por psikologjike. Ai i bën asaj presion duke e pyetur: *Tregoi babit se ku ka qenë mami*, e kështu me rradhë. Ajo është e frikësuar. Nëse unë i them atij që ta lerë vajzën rehat, ai fillon të më godasë.... Vajza ime ka parë shumë skena të dhunshme, sepse ai abuzonte me mua në sy të fëmijëve. Kjo është

forma e dhunës që praktikohet tek fëmijët.”

Nënat janë të shqetësuara për të mbrojtur fëmijët nga zemërimi dhe dhuna e baballarëve të tyre. Një grua e divorcuar, nënë e dy fëmijëve thotë: “Unë nuk mund të mendoja se si të mbroja veten nga dhuna e burrit tim. Unë duhet të mendoja 1000 herë për fëmijët e mi. Kur ai vinte në shtëpi dhe fliste me zë të lartë, fëmijët e mi bënin shpesh sikur flinin. Në fillim ata e vlerësonin situatën. Nëse do të ishte i qetë, ata vinin në kuzhinë ngadalë, e një e nga një. Nëse ai ishte i inatosur, ata vazhdonin të bënin sikur ishin në gjumë. Ishtë një situatë e tmerrshme.” Një nënë tjetër me pesë fëmijë, ve në dukje: “Unë nuk qaj kurrë në sy të fëmijëve kur im shoq më rreh. Unë nuk dua t’i stresoj ata. Kur ai më rrihte, unë i largoja fëmijët që ata të mos shikonin skenën, por ata rrinin pas dritares dhe i dëgjonin të gjitha.”

Në situata të tjera, fëmijët janë ata që mbrojnë nënat e tyre. Një nënë 43 vjeçare me tre fëmijë thotë: “Fëmijët e mi janë zënë shpesh me të atin. Me thënë të vërtetën, ata e kanë ndaluar atë në shumicën e rasteve, duke u përpjekur të më ndihmojnë.” Ekziston reziku që fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës si një mjet për zgjidhjen e konflikteve, të bëhen edhe vetë të dhunshëm si në shembullin e mëposhtëm: “Për fëmijët është shumë e vështirë që t’i shohin prindërit e tyre duke u zënë. Për fëmijët e mi ishte shumë e vështirë të më shikonin në të tilla kushte për shkak të babait të tyre. Ata e urrenin atë kur e shihnin fytyrën time me gjak. Djali im donte ta rrihte të atin për të më mbrojtur. Unë futesha në mes të tyre. Unë ndjehesha keq që

im bir donte të godiste të atin, edhe pse ai më kishte abuzuar në mënyrë të tmerrshme.”

Vështirësitë si prind

Gratë e abuzuara reflektojnë se si ndikon dhuna e partnerëve të tyre tek aftësitë prindërore. Ato janë të ndërgjegjshme se dhuna në familje ka ndikim negativ në rolin e tyre si nëna. Gratë shprehin dëshirën për të patur më shumë vetë-kontroll në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, dhe për të mos transferuar stresin tek ata. Ato gjithashtu shprehin dëshirën për të kompesuar efektet negative të dhunës në familje. Një nënë me dy fëmijë nga Shkodra, e papunë, thotë: “Fëmijët e mi po shikojnë skena të tmerrshme, dhe unë kam frikë se kur të rriten do të imitojnë babain e tyre. Ne kemi një shtëpi të vogël me një dhomë e një kuzhinë. Kështu, fëmijët shikojnë dhe dëgjojnë çdo gjë që ndodh në shtëpi. Shpesh ai i rreh edhe ata pasi më rreh mua. Ndonjëherë edhe unë e bëj këtë, sepse jam aq e nevrikosur sa nuk di kujt t’ia nxjerr. Tani jam më e kujdesshme me ta. Unë qaj, mërzitem por nuk i rrah më fëmijët e mi. Ata janë të pafajshëm.” Një nënë tjetër me tre fëmijë, 44 vjeçare thotë: “Unë isha shumë e stresuar gjithë kohës dhe për këtë arsye u bërtisja fëmijëve. E kisha inatin me të, por atij nuk i bërtisja dot se kisha frikë se më rrihte, kështu që ia nxirrja inatin fëmijëve. Ndonjëherë u gjuaja atyre me shpullë, por tani që janë rritur, ata më kanë falur për këtë, sidomos vajza ime që është bërë nënë.”

Humbja e pafajsisë së fëmijërisë

Fëmijët që kanë pësuar dhunë ose që kanë qënë dëshmitarë të dhunës midis prindërve, shfaqin probleme emocionale dhe të sjelljes. Gratë shqetësohen për mënyrën se si dhuna në familje ndikon psikologjikisht fëmijët e tyre. Një nënë e re me dy fëmijë thotë: “Fëmijët e mi kanë gjithmonë frikë se do të ndodhë diçka e keqe. Djali i madh është gjithmonë në ankth dhe shumë i acaruar. Nuk është shumë i shoqërueshëm dhe shpesh i shqetëson të tjerët, u thyen lodrat.”

Fëmijët e abuzuar kanë më pak shokë dhe marin më pak pjesë në aktivitetet e organizuara jashtë

shtëpie. Ata kanë vështirësi në marrëdhëniet e tyre me të tjerët. Fëmijët gjithashtu ndjehen fajtorë dhe të turpëruar nga abuzimi. Frazat e mëposhtme e ilustronë këtë efekt: “Fëmijët e mi ndjehen shumë keq dhe qajnë kur i ati bëhet i dhunshëm. Ata mbyllën në vetvete, kjo është e vetmja gjë që mund të bëjnë.” (Vera nga Berati, nënë e tre fëmijëve), “Vajza ime nuk është si të gjithë fëmijët e moshës së saj. Asaj nuk i pëlqen të flasë. Ajo nuk del asnjëherë jashtë për të luajtur me shoqet. Kam vënë re se u rri larg fëmijëve të tjerë. Asaj i pëlqen të rrijë brenda dhe të vizatojë, por kur i ati vjen në shtëpi, ajo është shumë e frikësuar prej tij.” (Ariana nga Tirana, nënë e një fëmije). “Fëmijët i shohin baballarët e tyre të vijnë në shtëpi krejtësisht të dehur, pa asnjë para, dhe kjo bën që ata ta humbasin respektin për të. Djali ynë nuk duron dot ta shikojë të atin kështu. Vajzat janë bërë akoma më të mbyllura, ato nuk flasin me të tjerët dhe nuk dalin jashtë, ato janë pothuajse gjithmonë të mërzitura.” (Jonida nga Shkodra, nënë e tre fëmijëve).

Fëmijët që bëhen dëshmitarë të dhunës ndërmjet prindërve, ose që abuzohen nga prindërit, shfaqin ankesa psikosomatike si dhimbje të kokës dhe të barkut. Ata shfaqin gjithashtu sjellje regresive si urinimi natën në krevat dhe probleme me gjumin. Një nënë e dy fëmijëve, e divorcuar, thotë: “Djali im ishte vetëm 4 vjeç kur im shoq filloi ta rrahë me rrip përpara se të shkonte në kopësht. Ai ishte aq i frikësuar sa dridhej në gjumë dhe urinonte natën.”

Pjesëmarrëset tregojnë se fëmijët e tyre manifestojnë sjellje të tilla si zënie, ngacmime dhe gënjeshtria. Nënat e tyre raportojnë se ata shfaqin tendenca të bërtituri, acarimi dhe fshehje. Fëmijët janë gjithashtu më të pabindur si në shtëpi ashtu edhe në shkollë dhe kanë rezultate të këqia në mësimet. Një nënë thotë: “Djali im është agresiv ndaj fëmijëve të tjerë. Nëse nuk i shkojnë punët ashtu si do ai, ai nervozohet dhe fillon t’i godasë fëmijët e tjerë. Në shtëpi i hedh gjërat për tokë..... ai kopjon sjelljet e të atit.” Një nënë me pesë fëmijë thotë: “Fëmijët e mi janë agresive ndaj fëmijëve të tjerë. Njëri nga djemtë e mi bëhet nervoz edhe për gjëra të vogla..... Djali më i vogël ka të njëjtat zakone që ka edhe i ati. Kur nervozohet fillon të thyejë gota. Në momente të tilla është




shumë e vështirë ta qetësosh.”

Nënat janë të shqetësuara se mos fëmijët e tyre do të përsërisin të njëjtat sjellje si dhe baballarët e tyre. Një nënë me tre fëmijë thotë: “Fëmija im sillet në të njëjtën mënyrë si i ati. Këtë e kuptova kur ai filloi të më kërkojë para. Nëse nuk i jepja, ai fillonte të bërtiste duke këmbëngulur se i donte ato para.” Një nënë tjetër ankohet për problemet e djalit të vogël që kishte filluar të abuzonte me alkoolin.

Dhuna në familje shkakton efekte të rënda tek

fëmijët. Midis të tjerash, efektet në sjellje përfshijnë edhe agresivitetin dhe tërheqjen nga shoqëria. Efektet psikologjike përfshijnë ankthin, depresionin, vetë-vlerësim të ulët, arritje të ulëta në shkollë dhe mungesë të kompetencës sociale. Gjithashtu, është vërtetuar se dhuna ka edhe efekte afatgjata, si abuzimi me substanca të dëmshme. Disa gra dëshmojnë se dhuna nuk ka patur efekte tek fëmijët e tyre. Shumica janë të ndërgjegjshme, dhe tentojnë që t’i adresojnë efektet negative të dhunës, mbi aftësitë e tyre prindërore si dhe direkt mbi fëmijët e tyre.



PËRBALLIMI I DHUNËS

“Unë jam keqtrajtuar gjatë 20 viteve të martesës. Në tre-katër vitet e fundit kam qenë kliente e rregullt e qendrës së këshillimit për gratë. Tani dhuna është edhe më e egër se më parë, të çarat në fytyrën time e vërtetojnë këtë. Prandaj unë vendosa ta divorcoj, megjithëse ai vazhdon të insitojë duke m'u lutur që të mos e bëj një gjë të tillë. Unë duhet të kujdesem për të ardhmen e fëmijës tim dhe për veten time. (Silvana, 40 vjeç nga Tirana, mësuese, e divorcuar me një fëmijë.)

Përfundimet vërtetojnë se gratë përdorin strategji të ndryshme për të përballuar situatat e dhunshme: përpiqen të kuptojnë, të durojnë, të shmangin, të shpresojnë, të justifikojnë, të bëjnë kompromis dhe të largohen. Në përcaktimin e mënyrës specifike të përballimit të dhunës ndikojnë faktorët socialë, kulturorë, familjarë dhe personalë të secilës grua të abuzuar. Përcaktues të mundshëm të strategjisë mund të jenë: bindjet e vetë gruas për familjen dhe martesën, shpeshësia e dhunës dhe idetë e saj mbi shkaqet që e krijojnë atë, prezenca e fëmijëve, siguria e saj ekonomike dhe mundësitë për përkrahje. Disa nga këta faktorë bëjnë që gratë të të qëndrojnë në marrëdhënie abusive si viktima, ndërsa disa faktorë të tjerë i nxitin gratë që ta sfidojnë dhunën.

Arsyet e dhunës

“Ekzistojnë shumë arsye për shpjegimin e dhunës: së pari, mungesa e hapsirës së nevojshme për banim. Ne jetonim në një apartament dy dhoma e kuzhinë sëbashku me dy kunetërit, vjerrin dhe tre fëmijët. Së dyti, situata ekonomike, tranzicioni dhe mundësitë e pakta të punësimit që ofron tregu i punës. Kur unë mbeta pa punë, im shoq filloi të pijë e të luajë bixhoz. Pastaj, if filloi të ushtrojë dhunë mbi mua dhe fëmijët e mi. Unë mendoj se arsyeja kryesore që sjell dhunën është varfëria; kur mungojnë paratë, burrat fillojnë të ushtrojnë dhunë mbi gratë e tyre. Po ashtu edhe xhelozia dhe papunësia.” (Jonida, 40 vjeç nga Shkodra, punëtore, nënë e tre fëmijëve)

Në përgjithësi, hapi më i rëndësishëm për të marrë vendimin e lënies së partnerit të dhunshëm, është të kuptuarit e arsyeve të abuzimit. Gratë ia atribuojnë dhunën në familje një sërë faktorësh: individualë (probleme

psikologjike, përdorimit të shpeshtë të alkoolit ose xhelozisë); kontekstit familjar (kontrollit të burimeve financiare nga ana e mashkullit, mungesa e mjeteve financiare, konfliktet ndërmjet brezave); komunitarë (izolimi i grave dhe mungesa e mbështetjes sociale); normat kulturore (modeli i ashpër burror, nderi i burrit apo dominimi që legjitimizon dhunën e burrave, rolet tradicionale gjinore të prera dhe imponuese, pranimi i dhunës si një mënyrë për zgjidhjen e grindjeve ndërpersonale dhe koncepti se burri ka ‘pronësi’ mbi gruan); dhe faktorë të shoqërisë (stresi social, varfëria, papunësia).

Megjithëse të intervistuarat identifikojnë arsye të ndryshme të dhunës në familje, dhe shumë nga këto arsye janë përmendur si të ndërthurura, ato përpiqen ta shpjegojnë abuzimin duke vënë theksin tek ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur në Shqipëri që nga viti 1991. Dyzetegjashtë gra (83%) e konsiderojnë dhunën si problem social që vjen si rezultat i një shoqërie pa ekuilibër, e gjetur midis tradicionales dhe modernes. Disa burra nuk e përballojnë dot këtë trysni dhe këto ndryshime sociale. Kjo do të thotë se shumë nga të intervistuarat e gjejnë përgjegjësinë për dhunën, në faktorë të jashtëm. Susana, 34 vjeç nga Tirana, punëtore, nënë e një fëmijë shpjegon: “Këto probleme shkaktohen nga papunësia. Edhe nëse je në punë, rrogat janë të ulta, çmimet janë të larta, dhe është normale që të gjitha këto të krijojnë probleme në çift. Në këtë dekadën e fundit ka patur shumë stres. Gjysmat e çifteve në Tiranë janë divorcuar.”

Jetesa në varfëri sjell stres dhe shqetësim si dhe krijon tek burrat ndjenjën e të qenit të paaftë për të përmbushur atë rol të përkufizuar nga kultura si “fituesi i bukës së familjes”. Burrat shqipëtarë, të mbërthyer nga kjo thënie, si dhe të rënduar

nga stresi, e kanë humbur sensin e identitetit dhe të vetë-vlerësimit. Ata fillojnë ta konsiderojnë shtëpinë si bastionin e fundit të autoritetit mashkullor. Të gjitha shqetësimet shkarkohen në shtëpi, duke bërë viktime më të zakonshme gruan dhe fëmijët. Evisi, 40 vjeç nga Shkodra, punëtore, nënë e tre fëmijëve thotë: “Unë mendoj se dhunën në familje e shkaktojnë faktorët ekonomikë. Dhuna parandalohet nga situatat e mira ekonomike. Dhuna është krejtësisht e mënjanuar nëse ekziston siguria ekonomike.” Shumë gra përmendin se burrat reagojnë kështu si pasojë e zemërimit dhe dhimbjes së grumbulluar nga përballimi me stresin social. Një grua e martuar nga Tirana, nënë e pesë fëmijëve shton: “Situata e paqëndrueshme financiare krijon shumë probleme dhe shume stres. Burrat fillojnë të pijnë dhe të bëjnë skandale të mëdha në shtëpi.”

Një tjetër arsye e dhunës në familje që përmendet shpesh, e përmendur nga 21 gra, është abuzimi i burrave me alkoolin. Një grua 37 vjeçare nënë e dy fëmijëve thotë: “Pasi pinte shumë alkool, ai më godiste me ç’të gjente përpara.” Denada, një punëtore nga Shkodra, e martuar me dy fëmijë shpjegon: “Të pirit është një nga arsyet kryesore (të dhunës) sepse pastaj ata nuk dinë se ç’bëjnë. Unë me të vërtetë mendoj se gjëja e parë që burrat shqipëtarë mendojnë kur zgjohen në mëngjes, është të pijnë alkool. Unë mendoj se ne duhet të aprovojmë një ligj, që baret të mos tregëtojnë alkool në mëngjes. Do të ishte mirë që shitja e alkoolit të ndalohet, sepse ai po shkatërron jetë njerëzish. Unë kam jetuar me një të alkoolizuar për 12 vjet dhe po ju them se ata me të vërtetë që nuk dinë se ç’bëjnë.”

Sipas 16 të intervistuarave, sjellje të dhunshme mund të provokojë gjithashtu edhe xhelozia e dhunuesit. “Ai ishte shumë xheloz. Ai ishte gati të fillonte konflikte në çdo moment. Ai mbërriti deri atje sa të më thoshte se do të ma priste trupin me gërhërë,” tregon një grua e re 28 vjeçare, nënë e dy fëmijëve. Një grua tjetër e martuar me tre fëmijë thotë: “Ai bëhej i dhunshëm nga xhelozia, ngaqë unë vishesha pak më mirë ose lyshesha, kur dilnim bashkë shëtitje. Unë tani kurrë nuk përipiem që ta ndryshoj pamjen time, sepse kjo do më krijojë probleme. Ka patur raste që ai ka përdorur

dhunë fizike ndaj meje vetëm për shkak të ndonjë keqkuptimi të vogël.” Një grua tjetër nga Tirana tregon të njëjtën përvojë: “Në fillim ne kishim marrëdhënie të mira, si një çift normal, por më pas filluan zënie dhe dhuna. Arsyeja kryesore ishte xhelozia. Nga xhelozia e tij m’u desh të le edhe punën. Ai më mbyllte në shtëpi. Më pas ai filloi të pijë dhe nuk hoqi dorë nga ky zakon deri sa u bë i varur prej alkoolit. Sipas meje, arsyet kryesore të sherreve tona ishin xhelozia dhe alkooli.”

Tre gra ia atribuojnë dhunën e partnerëve të tyre faktorëve psikologjikë. Në këtë kuptim, përkufizohet si produkt i çrregullimeve emocionale si depresioni ose vetë-vlerësimi i ulët. Ky fokusim i arsyeve të dhunës në nivel individual përfshin justifikimin e akteve të dhunës si akte që ndodhin jashtë kontrollit të dhunuesit. Besohet se dhunuesit janë të dëshpëruar, se veprojnë kështu si pasojë e problemeve emocionale, dhe paqëndrueshmërisë mendore. Aktet e dhunës kuptohen si rezultat i mbushjes së kupës me ankth, shqetësim dhe zemërim. Elona, 40 vjeçare, nënë e tre fëmijëve thotë: “I shkreti burri im nuk i bën të gjitha këto se i pëlqen, por se është i dëshpëruar. Shumë burra, i godasin gratë e tyre kur gjenden në gjendja depresioni. Ky është edhe rasti i burrit tim.”

Një tjetër arsye e sjelljes së dhunshme që përmendet nga të intervistuarat është edhe “maçizmi”, që do të thotë se sipas opinionit të këtyre grave, burrat janë të dhunshëm vetëm sepse janë burra. Një grua 42 vjeçare shpjegon: “Burrat janë të dhunshëm nga natyra, prandaj nuk mund të bësh asgjë për t’i ndryshuar. Unë u përpoqa shtatë vjet që ta ndihmoja burrin tim të ndryshonte, por ai u bë akoma më keq.” Një grua e re e divorcuar, 22 vjeçare thotë: “Ai e ka dhunën në gjak.” Një farmacistë komenton: “Unë mendoj se arsyeja kryesore e dhunës është egoja e meshkujve dhe mungesa e tolerancës.” Ky kuptim për dhunën e meshkujve bazohet në shpjegime psikobiologjike sipas të cilave burrat janë agresivë nga natyra. Një grua e re 20 vjeçare nga Tirana, e papunë thotë: “Burrave u pëlqen të zihen për asgjë. Ata duan që çdo gjë të bëhet ashtu si u pëlqen atyre, dhe u pëlqen të jenë superiorë ndaj grave të tyre.” Një grua tjetër e papunë nga Berati shpjegon: “Unë mendoj se burrat janë lindur për të qenë të dhunshëm.

Dhuna nuk mund të shpjegohet me situatën ekonomike dhe faktorët financiarë, sepse ai kur kishte para bëhej akoma i dhunshëm.”

Disa të intervistuar përmendin se situatat e dhunshme mund të shkaktohen edhe nga presioni i bërë nga njerëz të tjerë si për shembull vjerra. Pasi ishin denigruar në mënyrë të vazhdueshme, tre nga gratë e bënin veten me faj për abuzimin dhe dështimin që kishte pësuar marrëdhënia e tyre. Ato shprehën besimin se ndofta nuk kishin qenë bashkëshorte të mira sa duhet; Silvana, mësuese, mendon se e ka fajin vetë për abuzimin: “Unë shpesh e konsideroj veten fajtores. Unë kurrë nuk e ngrija zërin dhe gjithmonë i kërkoja të falur. Qaja gjithë natën. Pastaj e kuptoja se nuk kishte qenë faji im.”

Gra të tjera nuk mund ta kuptonin arsyen e dhunës. Milva, një grua e martuar me dy fëmijë thotë: “Unë shqetësohem sepse nuk e kuptoj se pse shkaktohet dhuna, Unë di vetëm që më ndodh, pa qenë e zonja për të kuptuar se pse.” Manjola, një teknike 46 vjeçare nga Tirana thotë: “Shpesh e pyes veten se cila është arsyeja e dhunës në shtëpinë time, sepse për të çdo gjë është një arsye. Ai është i vetmi që e di se pse silltet në mënyrë të tillë.” Etleva, 23 vjeç nga Shkodra, e papunë, shpreh pothuajse të njëjtin konfuzion: “Unë e kam pyetur veten shpesh por asnjëherë nuk e kam gjetur përgjigjen. Unë them se ka të bëjë më tepër me natyrën e tij. Ai është person i dhunshëm, nuk ka arsye tjetër. Ne jetojmë sëbashku me dy fëmijët tanë, dhe askush nuk na ndërhyr në jetën tonë. Ne kemi një situatë financiare normale, ai ka punën e vet.....por megjithatë është i dhunshëm.”

Kur gratë përpiqen që të reflektojnë në lidhje me dhunën, dhe ta shpjegojnë atë në kontekstin shqipëtar, shumica e tyre përmendin faktorët socialë si shkaktarët kryesorë të fenomenit. Gratë në përgjithësi mendojnë se dhuna është më tepër një produkt i marrëdhënieve sociale jofunksionale, se sa i individëve me probleme. Ato përmendin varfërinë, nivelin e lartë të stresit, shoqërinë e pa ekuilibruar, polarizimin e thellë midis të pasurve dhe të varfërve, dhe midis tradicionales dhe modernes. Dhuna e burrave ndaj grave përmendet si një nga sëmundjet e shumta sociale. Supozimi se burrat sillen dhunshëm si

pasojë e stresit të shkaktuar nga tranzicioni, i portretizon ata si viktime të vërteta të ndryshimeve sociale. E parë në këtë këndvështrim, natyra gjinore e dhunës nuk pasqyrohet në mënyrë të vazhdueshme. Fakti që dhuna në familje nuk kuptohet me të vërtetë si një fenomen gjinor, krijon implikime serioze për programet e parandalimit të dhunës. Për të luftuar problemin e dhunës ndaj grave është e domosdoshme që të ndryshohen marrëdhëniet sociale midis burrave dhe grave, në mënyrë që të ndërjegjësohen më shumë për diskriminimin gjinor që ekziston në Shqipëri.

Ndjenja e zënies në kurth

“Unë jam një nga ato gra që megjithëse jam abuzuar nuk mund të bëj asgjë kundër kësaj. Arsyeja kryesore është se ne nuk kemi shtëpi. E ku mund të shkoj unë me tre fëmijë? Nuk mund të shkoj tek prindërit; Unë nuk jam në punë dhe nuk kam para, kështu që është më mirë të qëndroj atje ku abuzohem.” (Aferdita, 27 vjeç nga Tirana, e martuar me tre fëmijë)

Dihet se në një shoqëri patriarkale, nga gratë pritet që të marrin përgjegjësinë për të siguruar suksesin e martesës. Në këtë mënyrë, gratë zihen në kurthin e strukturës patriarkale të familjes dhe mbeten atje për një kohë të gjatë, me qëllim që të shpëtojnë familjen dhe martesën e tyre. Meqënëse nga gratë pritet që ta ruajnë familjen të paprekur me të gjitha mënyrat, nuk është e çuditshme që 30 nga 55 gratë e intervistuar, jetojnë akoma me burrat e tyre abuzivë. Nëntëmbëdhjetë të intervistuar në mënyrë eksplicite përmendin “durimin”, si strategji kundër dhunës. Për shembull, një grua 52 vjeç e martuar, ekonomiste nga Tirana thotë: “Unë mendoj se gruaja duhet të sakrifikojë veten, sepse edhe po te martohet me një burrë tjetër, nëse nuk do të jetë tolerante do të jetë e njëjta gjë. Gruaja duhet të ruajë ekuilibrin në familje.”

Shumë gra vuajnë për vite të tëra nga ushtrimi i dhunës sepse ato i kanë mësuar që ta jetojnë jetën sipas vlerave tradicionale. Këto gra besojnë, se ashtu siç edhe përshkruhet në rolin e tyre si bashkëshorte dhe nëna, duhet të përpiqen ta mbajnë familjen të bashkuar, dhe t'i rindërtojnë marrëdhëniet me çdo mënyrë. Një grua 46 vjeçare punëtore nga Tirana, nënë e një

fëmijë shpjegon: "Arsyeja se pse unë kam duruar gjithë këto vuajtje për 27 vjet, është se unë nuk dua ta shkatërroj familjen time. Kam nevojë që ta edukoj vajzën time. Unë nuk dua që burri i ardhshëm i vajzës time të thotë se ajo ka një familje copë-copë. Ajo gjithmonë do ta kujtojë se e ëma u sakrifikuua që ajo të merrte shkollimin e duhur. Unë i kam duruar të gjitha vuajtjet vetëm për hatër të vajzës time." Juliana, një e papunë me banim në Tiranë shpjegon: "Unë jam martuar me shkes, dhe nga martesja ime 22 vjeçare kam tre fëmijë. Im shoq ka qenë i dhunshëm që në fillim të martesës. Sipas mentalitetit të tij, unë jam pronë e tij, dhe me mua mund të bëjë ç'të dojë. Unë e kam duruar vetëm për hatër të fëmijëve. Gjithashtu, unë gjithmonë shpresoja se sjellja e tij do të ndryshonte."

Pavarësisht problemeve të tjera, gratë ndjehen të angazhuara përkundrejt rolit të tyre si nëna. Këto gra, e lidhin shkëputjen nga marrëdhënia, ose bërjen e ndryshimeve drastike, me mungesën e angazhimit ndaj familjes. Një punëtore nga Tirana, nënë e dy fëmijëve thotë: "Unë nuk mendoj se divorci dhe krijimi i një familje të re është zgjidhje e mirë. Familja e dytë nuk do të jetë më e mirë se e para. Unë nuk do të mund të gëzoja një jetë të re nëse do të divorcohesha dhe të martohesha me një tjetër. Unë mendoj se do të vuaja edhe në martesën e dytë."

Gratë e kuptojnë veten si personi kryesor përgjegjës për kujdesin dhe mirëqenien e fëmijëve. Ato besojnë se duhet të sakrifikojnë interesat e tyre personale për hatër të familjes. Një grua 40 vjeçare shpjegon: "Unë kam tre fëmijë me të, prandaj duhet ta duroj dhunën për hatër të tyre. Unë shpresoj se ai do të ndryshojë një ditë, përpara se të rriten fëmijët. Unë besoj tek zoti, dhe besoj se zoti do ta ndryshojë atë një ditë për hatër të fëmijëve. Nuk është e lehtë të divorcohesha në këtë moshë, me tre fëmijë. Për mua situata është me të vërtetë e vështirë, por është në të mirë të fëmijëve që të rriten me babain e tyre dhe jo pa të. Ndonjë ditë ata do të më pyesnin se ku ishte babai i tyre. Është e pamundur të ndahesh nga burri kur ke tre fëmijë me të. Është me të vërtetë turp i madh."

Fëmijët janë i vetmi faktor që i detyron gratë ta durojnë dhunën për një kohë të gjatë pa kërkuar ndihmë. Fakti që shumica e tyre beson

se kanë nevojë për të dy prindërit, pavarësisht se njëri është i dhunshëm, i mban ato në kurthin e një marrëdhënie të dhunshme. Gratë mendojnë se pavarësisht problemeve të tyre, ato duhet të jenë të duruara dhe të bindura për hatër të fëmijëve. Ato nuk e konsiderojnë divorcin si zgjidhje të situatës abusive në të cilën ndodhen. Një grua 46 vjeçare, nënë e dy fëmijëve thotë: "Këshilla që unë do t'i jepja grave të tjera që janë në të njëjtën situatë, është që të jenë të durueshme deri sa t'u rriten fëmijët. Ne duhet t'i mbrojmë fëmijët, të jemi të durueshme dhe ta mbrojmë veten nga abuzuesi. Ne mund të merremi me këtë problem vetëm pasi të na jenë rritur fëmijët." Një grua tjetër 36 vjeçare, nënë e dy fëmijëve tregon: "Nëse do ta kisha konsideruar divorcin si një zgjidhje, do ta kisha bërë këtë shumë kohë më parë. Por unë mendoj se po të isha divorcuar, do ta kisha shkatërruar familjen time. Fëmijët e mi do të ishin rritur pa baba."

Gratë që jetojnë në marrëdhënie abuzive, fitojnë aftësi mbrojtëse si të shpresuarit dhe të shmangurit. Si rezultat i kësaj, ato në përgjithësi e justifikojnë qëndrimin e tyre në një marrëdhënie të dhunshme, duke menduar se burrat do të ndryshojnë. Pranvera, një grua e martuar me dy fëmijë thotë: "Unë kam 20 vjet që jam martuar dhe kam vuajtur që nga dita e parë e martesës. Jetoj me shpresë vetëm për fëmijët." Një shpresë e përhershme se "ai do të ndryshojë", shprehet edhe Denisa, 37 vjeç, punonjëse civile nga Shkodra, nënë e dy fëmijëve: "Ka një proverbë që thotë: "Shpresa vdes e fundit". Unë shpresoj se një ditë ai do të ndryshojë. Unë shpresoj se ai do të bëhet personi që ka qenë më parë, se do ta lerë pijen dhe bixhozin. Unë gjithmonë shpresoj se ai do të ndryshojë. Akoma shpresoj për një jetë më të mirë."

Një strategji tjetër e përdorur nga gratë është arsyetimi i abuzimit duke e parë situatën nga një këndvështrim tjetër dhe kompromisi. Këto strategji përfshijnë qëndrimin larg syve të burrit, refuzimin për t'u përfshirë në një zënie të filluar nga ai, ose thjesht largimin nga shtëpia për të shmangur ndonjë incident të mundshëm dhune. Një nënë me tre fëmijëve thotë: "Më duhet të largohem nga shtëpia kur ai vjen i dehur. Megjithatë unë kam frikë se po ta le vetëm në shtëpi ai do të thyejë gjithshka. E ç'mund të

bëj? Ai është burri im dhe babai i fëmijëve të mi. Gruaja duhet t'i tolerojë këto lloj sjelljesh për hatër të fëmijëve dhe familjes." Gentiana, 21 vjeçare nga Tirana, me një fëmijë dhe e papunë komenton: "Gruaja duhet të jetë shumë tolerante ndaj burrit të dhunshëm. Ajo duhet të rrijë urtë kur i shoqi është i nevrikosur ose i pirë. Ajo mund t'i flasë atij më vonë në lidhje me problemin, duke përdorur shumë takt. Ajo duhet të përpiqet që t'i shpjegojë atij se çfarë kishte bërë. Gratë nuk kanë se ku të jetojnë nëse divorcohen, ato nuk mund të kthehen mbrapsh tek prindërit e tyre....ato nuk kanë mbështetje. Kjo është arsyeja se pse gratë duhet ta durojnë një marrëdhënie të dhunshme."

Disa gra përdorin si mënyrë për menaxhimin e situatës, shmangjen e çështjeve apo sjelljeve që mund t'i provokojnë burrat e tyre. Gratë fillojnë të bëjnë kompromis duke mbajtur parasysht zakonet dhe sjelljet e burrave, dhe duke kontrolluar me kujdes zemërimin e vetes së tyre. Për shembull, një pjesëmarrëse thotë: "Unë jam person i bindur dhe duroj çdo gjë. Unë përpiqem që të kem gjithmonë punë, në mënyrë që të shmang zënie." Një grua tjetër 50 vjeçare thotë: "Të gjitha herët unë shpresoja që ai nuk do ta bënte më. Megjithatë kishte periudha që ne nuk kishim konflikte, sepse unë gjithmonë përpiqesha që t'i shmangia ato. Megjithatë, nuk kalonte pak dhe ai fillonte të bënte të njëjtën gjë. Ishte një torturë e vërtetë." Disa gra përpiqen të ruajnë qetësinë duke u dorëzuar përpara kërkesave të burrave të tyre. Një grua 52 vjeçare, ekonomiste nga Tirana, komenton: "Ai sillte shumë keq, ai ishte i dhunshëm dhe më rrihte. Unë ndjehesha e ofenduar dhe e poshtëruar. Por ky nuk ishte problem për të. Më duhej t'i hidhja të gjitha prapa krahëve, të bëja sikur kisha harruar, sepse im shoq nuk kërkonte as të falur. Unë prisja deri dy javë që ai të kërkonte të falur, por ai nuk e bënte këtë. Unë vendosa ta toleroja vetëm për hatër të fëmijës. Dhe ishte zgjidhja më e mirë që mund të bëja."

Reagimi i një gruaje ndaj abuzimit është shpesh i kufizuar nga mundësitë që ajo ka në dispozicion. Gratë vazhdimisht përmendin të njëjtat arsye për qëndrimin në marrëdhënie abusive. Përveç shqetësimit për fëmijët, ato përmendin mungesën e shtëpisë dhe e mjeteve të tjera për mbështetje ekonomike, si dhe

mungesën e mbështetjes nga familja dhe miqtë. Gratë kërkojnë shumë rrallë ndërhyrje ligjore. Një grua e martuar me një fëmijë thotë: "Arsyeja kryesore për një grua që të qëndrojë në një marrëdhënie të dhunshme, është faktori ekonomik. Nëse ajo do të kishte se ku të shkonte, problemi do të ishte zgjidhur fare lehtë. Ajo nuk do të ishte e detyruar që të jetonte me dhunën. Arsyeja e dytë, në shumicën e rasteve janë fëmijët. Gratë do të bënin gjithshka për fëmijët e tyre. Ato pranojnë të rrihen sepse mendojnë se është shumë e vështirë për një fëmijë që të rritet pa baba. Arsyeja e tretë që i detyron ato të qëndrojnë në një marrëdhënie të dhunshme, lidhet me opinionin publik."

Disa gra, janë të ndërgjegjshme se kanë rënë në kurthin e ndjenjës së pafuqisë, mungesës së mbrojtjes dhe shpresës. Një grua 31 vjeçare thotë: "Ishte e tmerrshme. Unë nuk reagoja aspak, nuk munda, isha e pafuqishme. Nuk thashë asnjë fjalë. Duke qenë se jam e dobët, si të gjitha gratë në kushtet e mia, unë e fala atë. E ç'mund të bëja tjetër? Isha shtatzënë dhe nuk kisha se ku të shkoja me gjithë dy fëmijët e mi, dhe nuk besoja se policia mund të ma zgjidhte problemin. Edhe nëse do të ishte kështu, kjo do të ishte e përkohshme. Ai do të më kërcënonte përsëri. Unë nuk mund të kthehesha tek imë sepse kisha probleme me njerkun." Një nënë 44 vjeçare me tre fëmijë, e papunë thotë: "Unë nuk mund të bëja asgjë. Që ditën e parë të martesës unë e dija se do të më duhej të rija me të, pavarësisht çmimit që do të më duhej të paguaja." Një punëtore nga Berati, nënë e tre fëmijëve shton: "Unë merzitesha shumë por e mbaja përbrenda. E çfarë mund të bëja? Ky ishte fati dhe nuk mund të bësh asgjë kundër tij."

Mungesa e burimeve ose burimet e pamjaftueshme financiare të grave për të jetuar të pavarura, si dhe shqetësimi i tyre për fëmijët, bën që ato të mos shkëputen nga marrëdhëniet abusive. "M'u desh të duroja për ca kohë, por të paktën i rrita fëmijët e mi në shtëpi dhe jo në rrugë," thotë Fatjona, 38 vjeç, nënë e pesë fëmijëve. Po ashtu, turpi dhe frika e stigmës sociale, bën që gratë të mos kërkojnë ndihmë nga të tjerët. Disa gra tregojnë se ato nuk kanë folur kurrë me ndonjë njeri për abuzimin e tyre. Shembulli i mëposhtëm e vërteton këtë: "Kur nxehej ai bëhej si bishë. Të nesërmen e ditës që

më kishte abuzuar fizikisht, sillej sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Unë vendosa ta mbyll gojën e të mos i tregoj asnjëri. Mendoja se ai nuk do ta bënte më.” Shumica e të intervistuarave përmendin se nuk kanë shkuar kurrë në polici. Drita, një grua e martuar me dy fëmijë thotë: “Jo, nuk e kam çuar ndonjëherë në mend që ta denoncoja në polici. Isha aq tolerante..... Ai ishte burri im i dytë, unë nuk dija se ku të shkoja po ta divorcoja. Nuk mund të kthehesha tek familja ime.”

Ka gra që mendojnë se familja dhe miqtë nuk e kuptojnë situatën e tyre, prandaj është e kotë që t’i kërkosh atyre ndihmë. Mungesa e mirëkuptimit, turpi, histori abuzimi në familjen e origjinës, dhe dëshira për të mos e zhgënjyer familjen, janë disa nga faktorët që i detyrojnë gratë të mos hapen për ndjenjat e tyre. Lira, 28

vjeçare nga Shkodra, e papunë me dy fëmijë thotë: “Unë i kam treguar prindërve për dhunën që ushtron burri ndaj meje. Për ata kjo nuk është diçka e pazakonte, pasi kjo është e zakonshme në shumë familje në Shkodër.” Një tjetër tregon: “Unë vuajta shumë edhe në martesën e dytë. Më kanë dhunuar fizikisht, poshtëruar, por nuk kisha kurajo që t’i tregoja prindërve për këtë. Unë e di se si do të më përgjigjeshin. Ata do të thonin: “*Ik tek yt shoq. Ti je divorcuar njëherë, dhe nëse do ta bëjë këtë për së dyti, do ta turpëroje familjen.*”

Shumë gra përmendin se dhuna e partnerëve të tyre, ishte përforcuar si rezultat i shfaqjes së dëshirës nga ana e grave për t’u shkëputur nga një marrëdhënie e tillë. Shumë gra, frika e shtimit të dhunës i ka fundosur akoma më keq në kurthin e marrëdhënieve abuzive.

Negocijimi për një identitet të ri

“Unë jam tani një person tjetër; Unë jam një nënë që po e shijon jetesën me dy fëmijët e saj. Unë jam nëna e dy fëmijëve që nuk kanë më frikë. Ky është për mua një fillim i ri. Që kur shpëtova nga dhuna e tij, unë jam krejtësisht e përgatitur për të përballuar të gjitha sfidat e jetës.” (Oriola, 40 vjeç, juriste, e divorcuar me dy fëmijë).

Megjithë pengesat e përmendura, 19 (35%) nga 55 gratë e intervistuar janë ndarë nga partnerët e tyre të dhunshëm. Vendimi për t’u ndarë nuk ka qenë i lehtë për shumë prej tyre, dhe shpesh ka qenë i shoqëruar nga probleme financiare ose konfuzion dhe shqetësim për efektin që do të kishte ndarja mbi fëmijët. Një grua 23 vjeçare thotë: “Në momentet e dhunës unë mendoja në mënyrë instiktive se si ta mbroja veten. Më vonë, unë fillova të mendoj për mundësitë se si të shkëputesha nga kjo situatë, sepse nuk e përballoja dot më.” Një grua tjetër 20 vjeçare thotë: “Unë nuk isha e lumtur. Përballoja një problem të madh, por nuk dija se ç’të bëja. Unë nuk mund të rrija më me tim shoq, dhe nuk mund të kthehesha as tek familja ime. Im atë ma kishte bërë të qartë: *Nëse do të martohesh me të, me ne nuk ke më punë.* Jeta m’u bë e papërballueshme. Unë vuajta shumë dhe vendosa t’i jap fund kësaj situatë.”

Në përgjithësi, vendimi për t’u ndarë nga partneri nuk është i menjëhershëm. Shkëputja nga një marrëdhënie abuzive është një proces i shkaktuar nga disa situata specifike: dhuna egërsohet gjithmonë e më shumë, bëhet më e shpeshtë dhe e vazhdueshme; dhuna fillon të shtrihet tek fëmijët; arritja në përfundimin se “ai” nuk ka për të ndryshuar. Për shumë gra, shkatari kryesor për ndryshimin e qëndrimit “pa mbështetje – pa shpresë” dhe shkëputjen nga marrëdhëniet abuzive, është të kuptuarit se jeta e tyre dhe e fëmijëve ishin në rrezik. Disa nga gratë e intervistuar, ishin ndarë dhe rikthyer disa herë, përpara se të vendosnin për t’u ndarë një herë e përgjithmonë.

Gratë që vendosin të ndahen nga partneri abuziv, duhet të përballojnë edhe sjelljet e tij problematike. Ai mund të bëhet shumë i përlulur, të kërkojë të falur dhe t’i lutet asaj që të pajtohet, mund të premtojë se do të ndryshojë, ose mund

ta kërcënojë se do ta godasë apo vrasë, se do t'i marrë kujdestarinë e fëmijëve, apo se do t'i rrëmbejë apo dëmtojë ata. Juliana, nënë me tre fëmijë thotë: "Tani unë jam nën presion, sepse familja e tij kërkon prej meje që të kthehem. Unë mendoj se fëmijët e mi janë tashmë të rritur sa duhet për ta përballuar jetën vetë. Nuk mund ta duroj më dhunën. Kthimi mbrapsh mund të më kushtojë edhe jetën, sepse ai nuk është në gjendje ta kontrollojë veten."


Divorci është një nga strategjitë vepruese për gratë që përjetojnë marrëdhënie abuzive. Dituria, nëna e gjashtë fëmijëve thotë: "Më në fund unë vendosa të ndahem prej tij. Tani unë jetoj me fëmijët e mi. Ne nuk kemi kushte të mira banimi dhe ekonomike, por kur kam fëmijët pranë, unë ndjej se kam gjithshka." Siç tregohet edhe nga shembulli i mëposhtëm, shumë gra që janë ndarë, kanë patur mbështetjen e familjes dhe miqve: "Është e tmerrshme kur një burrë abuzon me gruan e tij. Unë qaja çdo natë. Të dëgjosh kërcënime ditë për ditë është e papërbalueshme. Unë kisha frikë se çdo të ndodhte me mua po ta divorcoja. Kisha frikë edhe nga opinioni i të tjerëve. Unë vendosa të gjeja forcat për ta luftuar dhunën dhe opinionin publik. Prindërit e mi e mbështetën vendimin tim. Unë kërkova divorcin. Ai nuk mundi ta besojë; ai mendonte se unë do ta duroja përgjithmonë. Më në fund po jetoj si qenie njerëzore. Më vjen keq për djalin që u rrit pa babain, por një baba i dhunshëm do të kishte ndikim negativ mbi të."

Shumë gra përmendin përfitimin që kanë patur nga divorci me partnerin abuziv. Ato përpiqen të kuptojnë se çfarë u ka ndodhur, të gjejnë vetveten si dhe se si t'i japin fund viktimizimit. Rudina, e papunë nga Tirana tregon: "Ka patur raste që kam dashur ta vras, veçanërisht kur sillte të dashurën e tij në dhomën ku unë jetoja. Sikur ta kisha vrotë tani do të isha në burg për vrasje. Këshilla ime për gratë e tjera që abuzohen është: nëse vuani nga dhuna në familjen tuaj, është më mirë që ta ndani burrin se sa ta vrisni. Unë u ndava prej tij pas 13

martese, dhe kur kisha tre fëmijë. Do të kishte qenë më mirë sikur të isha ndarë më parë. Por megjithatë, tani ndjehem më mirë. Familja dhe komshinjtë më ndihmojnë duke më dhënë mbështetje sociale. Unë them se është më mirë të kesh probleme financiare, se sa të vuash nga dhuna në familje."

Pjesëmarrëset mendojnë se ato kanë fituar dinjitetin dhe ndjenjën e vetëvlerësimit dhe fuqisë personale. Gratë përpiqen për të rigjetur vendin e tyre në shoqëri, dhe mënyra të reja jetese. Zhdukja e viktimizimit bëhet më e lehtë nëse ato bëhen të afta për të fituar të ardhurat e veta. Dorina, 22 vjeçare thotë: Nuk pres gjë prej tij. Unë e di se do të më duhet të përballoj çdo gjë vetë. Unë punoj dhe i zgjidh vetë problemet e mia." Një grua tjetër 31 vjeçare thotë: "Tani ndjehem më mirë. Më vjen keq për veten kur i kujtoj ato situata. Më vjen keq për vitet e humbura. Tani ndjehem e qetë. Të paktën nuk kam më frikë kur vjen nata; frika se ai do të vijë në shtëpi i dehur dhe do më rrahë. Tani nuk ndodhem në situatë të mirë. Nuk kam as punë dhe as ku të jetoj. Por ndjehem e lirë prej terrorit në të cilin jetoja."

Për gratë është e rëndësishme që të përcaktojnë një kuptim të ri për veten, të rishikojnë, ri-interpretojnë dhe rivlerësojnë veten dhe jetën gjatë martesës, në mënyrë që të rimarin kontrollin dhe të gjejnë forcën për të përballuar sfidat e reja. Kjo i ndihmon ato që të përballojnë situatën dhe jetën e tyre të re. Në një fazë të tillë, gratë ndjehen të afta për të ndarë përvojat e tyre me gratë e tjera të abuzuara. Kjo u siguron grave të divorcuara mbështetje psikologjike, si dhe i ndihmon të rivlerësojnë identitetin e tyre të ri. Sonila shpjegon: "Unë i këshilloj gratë e tjera që të mos qëndrojnë në marrëdhënie abuzive. Ato nuk duhet të thonë: *Jeta ime mbaroi, duhet ta pranoj atë*. Jo, ato nuk duhet të mendojnë kështu. E pse duhet t'i pranojmë ata? Gjeni një zgjidhje! Gjejini siç e gjeta unë! Unë gjeta mënyrën për ta çliruar veten nga gjithë ajo dhunë; tani jam e lirë, jam një grua tjetër!"



THYERJA E HESHTJES

“Do të doja të mos dëgjoja që gra të tjera kanë hequr njëlloj si unë. Ato duhet të ngrenë zërin dhe të mos jenë të bindura siç isha unë. Të durosh dhunën do të thotë të jetosh në agoni, ti dhe fëmijët e tu.” (Diana, 50 vjeç, e divorcuar me një fëmijë, farmacistë nga Berati).

Heshtja për dhunën në familje, është padyshim një mënyrë që i përforcon marrëdhëniet e fuqisë midis burrit dhe gruas. Heshtja nuk është vetëm shenjë e viktimizimit, por edhe e nënshtrimit. Dhuna, nënshtrimi dhe heshtja janë të ndërlidhura në përpjekjet për të ruajtur dominimin dhe kontrollin. Gjatë regjimit komunist, dhuna në familje në Shqipëri ishte pothuajse e padukshme. Nuk kishte qendra pritëse apo qendra këshillimi, mediat nuk e trajtonin si problem, nuk ekzistonte ndihma e policisë apo e institucioneve të tjera. Si rezultat i kësaj, është e vështirë të flitet për dhunën në familje, pasi akoma konsiderohet si turp. Shumë viktima të dhunës në familje akoma i mbajnë abuzimet sekret. Por hapja ndaj një personi tjetër, në lidhje me atë që po ngjan me ty dhe me trupin tënd, është një mënyrë e fuqishme për zhdukjen e velit që mbështjell dhunën në familje. Tregimi i ndodhive të fshehura për dhunën në familje, është një katalist i rëndësishëm për ndryshim.

Pjesëmarrëset e këtij studimi e thyen heshtjen nëpërmjet tregimit të historive të tyre të abuzimit. Të treguarit për dhunën, është një hap i rëndësishëm për sfidimin e hegjemonisë së abuzuesit. Megjithëse në Shqipëri në vitet e fundit janë bërë shumë ndryshime, vendi akoma nuk ka mundur të shkulë qëndrimet e rrënjësura thellë në lidhje me statusin inferior të grave. Një grua 34 vjeçare, e martuar me tre fëmijë thotë: “Njerëzit nëpër botë flasin për të drejtat e njeriut. Atëherë pse në Shqipëri gratë trajtohen sikur të jenë pronë e burrave? Ata duhet të meren e dhe me këtë.” Stela, një mësuese 31 vjeçare shton: “Gratë duhet ta ngrenë zërin që

në rastin e parë të dhunës. Asnjë grua nuk duhet ta pranojë dhunën, sepse nëse ajo fal një herë, ajo bëhet e përhershme. Gratë duhet të krijojnë personalitetin e tyre, sepse ato nuk janë skllave, shërbëtoreshë për punët e shtëpisë apo për të lindur fëmijë.”

Fuqizimi i grave

Nëpërmjet tregimeve të tyre, gratë krijojnë një mjet për ta çliruar veten nga abuzimi i partnerëve. Në këtë kontekst, thyerja e heshtjes mund të jetë një veprim i rrezikshëm, dhe nuk është e çuditshme që të ngarkohet edhe nga ankthi dhe frika e turp. Gratë kanë frikë se familja nuk do t'i mbështesë nëse ato e bëjnë dhunën publike, se do të ndjeheshin të turpëruara dhe fajtoreshë që e bënë të njohur, burrat e tyre do të reagonin, dhe do t'ia merrnin fëmijët. Një grua punëtoreshë nga Shkodra, 40 vjeçare, komenton: “Unë nuk mund të flas me prindërit e mi, sepse isha unë ajo që doja të martohesha me të. Ata as që e kishin idenë për tmerret që po kaloja. Kur prindërit e mi e morën vesh, ata nuk më mbështetën. Më këshilluan që ta pranoja situatën sepse kisha tre fëmijë dhe kushtet e mia të jetesës nuk më lejonin që të kërkoja ndonjë zgjidhje apo rrugëdalje tjetër. Për fat të mirë të fëmijëve të mi dhe timin, unë nuk e ndoqa këshillën e tyre.”

Këto gra vendosën të flasin pasi kishin prituri për një kohë kaq të gjatë, sepse e dinë që nuk e meritojnë trajtimin abuziv që kanë patur prej vitesh. Vetëm pasi kanë bërë këtë vetëvlerësim të ri, ato bëhen të afta të mbrojnë veten dhe të veprojnë. Deklarime si i mëposhtmi, e ilustron:

një qëndrim të tillë: "Shumë gra kanë hequr njëllor si unë. Ato vuajnë shumë dhe ndonjëherë ato nuk i thonë asnjëri sepse kanë turp. Ato nuk kanë mbështetje nga familjet e tyre. Unë do t'i këshilloja që të mos vepronin si unë. Ato nuk duhet t'i lejojnë burrat e tyre që t'i abuzojnë. Ato nuk duhet ta tolerojnë dhunën, sharjet dhe poshtërimin. Kjo është e tmerrshme dhe nuk ka grua që ta meritojë një trajtim të tillë," thotë një grua 44 vjeçare, e papunë me tre fëmijë. Gratë e dhunuara që vendosin t'i ndajnë bashkëshortët e tyre, shpesh rezikojnë jo vetëm vështirësi ekonomike por edhe stigmën sociale të dështimit si bashkëshorte dhe nëna. Duke patur parasysh qëndrimet ekzistuese në lidhje me dhunën, nuk është aspak çudi që gratë e dhunuara hezitojnë të hapen me ndonjë njeri për situatën e tyre. Megjithatë heshtja, ndërkohë që mbron gruan nga stigmatizimi social, në përgjithësi rrit ndjenjën e izolimit dhe frikës. Megjithatë historitë e pjesëmarrëseve, dokumentojnë vështirësitë që përballojnë gratë, si dhe vullnetin e tyre për të folur për dhunën, si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e grave. Një grua 40 vjeç, punëtore nga Shkodra thotë: "Unë do të doja që t'i thoja grave të tjera se ato nuk duhet të tolerojnë as edhe një fjalë të rëndë, apo fyerje nga burrat e tyre, sepse nëse ato tolerojnë njëherë, ato do të tolerojnë për së dyti, së treti, derisa të bëhet zakon i jetës së tyre." Ngritja e zërit për këto çështje, i informon gratë e tjera për betejat e tyre, ilustron rëndësinë e këtyre çështjeve në jetën e tyre, dhe demonstroi kurajon për të folur për to. Dafina, një grua e re shtatzënë thotë: "Unë do t'i këshilloja gratë që të mos e toleronin dhunën. Ato kanë mundësi për të gjetur një zgjidhje për problemin. Unë e di që kjo është e vështirë për arsye të fëmijëve, por unë mëndoj se është më mirë që të ndahesh nga një burrë i dhunshëm. Kush e di se ç'pasoja të tjera mund të sjellë dhuna? Unë mëndoj se në situata të tilla, divorci është zgjidhja e vetme. Po, e di që është e vështirë për arsye të fëmijëve dhe publikut, por më parë ajo duhet të mëndojë për veten."

Ndërgjegjësimi i grave se situata në të cilën jetojnë është e gabuar, dhe mbi të gjitha se ka mundësi që kjo situatë gradualisht të ndryshojë në të mirë të tyre, ilustron nga fjalët e Shpresës, ekonomiste me banim në Shkodër, nënë me një fëmijë: "Shumë herë nuk reagoja

ndaj fyerjeve të tim shoqi. Unë e toleroja atë, ndofta për hatër të djalit, ose ngaqë doja t'i qëndroja larg problemeve. Isha shumë e kujdeshme për përshtypjet e të tjerëve për familjen tonë. Unë nuk jam duke thënë se gratë janë të afta 100% të luftojnë dhunën, kjo do të ishte ideale, por shumica e tyre janë të afta për t'i dhënë fund asaj. Unë jam e zonja që të siguroj të ardhurat e dhura për familjen; megjithatë unë e pranoj mentalitetin patriarkal të burrit tim, që e bënë marrëdhënien tonë të pamundur. Për gra të moshës time është jashtëzakonisht e rëndësishme që ta ruajnë familjen nga thashethemet. Kështuqë, unë e toleroja burrin tim, heshtja, dhe e duroja dhunën. Unë jam e ndërgjegjshme dhe e bindur se nëse do të kisha reaguar që në fillim, gjërat do të kishin qenë ndryshe tani." Gratë nuk do të largohen prej dhunës nëse do ta gjejnë vlerën e tyre sociale vetëm tek roli i tyre si bashkëshorte dhe nëna. Një grua punëtore nga Berati përshkruan situatën në familjen e saj: "Im shoq më akuzonte për shumë gjëra: se unë nuk isha nikoqire e mirë për shtëpinë, se nuk kujdesesha për djalin dhe familjen. Kështuqë, ai filloi të më rrahë dhe të më trajtojë shumë keq." Fuqizimi i grave nuk është vetëm një qëllim i vlefshëm, por edhe një strategji kyç për eliminimin e dhunës.

Hapësira sociale për dhunën në familje

Rëfimet e grave venë në dukje kulturën e tolerancës përkundrejt dhunës ndaj grave. Dhuna në familje në përgjithësi pranohet si nga pjesëtarët e familjes, edhe nga ata që nuk i përkasin asaj. Në përgjithësi ajo konsiderohet si më pak serioze se forma të tjera të dhunës. Oriola, juriste, e divorcuar me dy fëmijë thotë: "Për rastet e dhunës në familje është e nevojshme që të ketë një kuadër ligjor. Nëse do të kishte një ligj për këtë, askush nuk do të guxonte të abuzonte me gruan e vet. Gratë janë qëniet njerëzore më pak të mbrojtura në Shqipëri. Kjo është arsyeja se pse abuzohen nga të tjerët." Grave u duhet të kapërcejnë shumë bariera personale, familjare dhe institucionale, që të mund të përfitojnë ndihmën që u nevojitet. Një punëtore nga Tirana, nënë e dy fëmijëve, komenton: "Kam menduar shumë herë që ta lija burrin, por mentaliteti më

ndalonte që ta bëja këtë. Prindërit, vëllezërit, motrat, të gjithë të afërmit më thonin: *Ti po na turpëron publikisht. Do ta poshtërosh familjen. Duhet të qëndrosh me të. Ai ishte fati yt.. Vetëm pas shumë përplasjesh me veten, unë e kuptova se duhet ta kisha jetën time në dorë.*"

Për tolerimin e dhunës ka disa arsye. Dhuna në përgjithësi pranohet dhe tolerohet për arsye se viktimat nuk kuptohen, të besimit se viktimat mund ta parandalojnë viktimizimin e tyre duke mos e vënë veten në situata të rrezikshme, të besimit se gratë e meritojnë që të viktimizohen për pasojë të sjelljeve të tyre, nga shqetësimi për veten në rast se do të ndërhyjnë për ta shmangur dhunën. Një grua e divorcuar 36 vjeçare nga Beratit tregon: "Ka patur raste që njerëzit e kanë parë tim shoq tek abuzonte me mua dhe nuk kanë reaguar. Ata të paktën mund të kishin telefonuar policinë." Nëse nuk merren masat e duhura për të shpërëndarë mesazhin se edhe aktet e thjeshta të dhunës nuk duhet të pranohen apo justifikuar, një tolerancë e tillë për dhunën mund të shkaktojë që abuzimi të shkallëzohet në akte të tjera më të egra. Sipas Julianës, një e papunë nga Tirana: "Shteti duhet të ndërhyjë në familjet ku gruaja dhe fëmijët abuzohen. Askush nuk e bëri këtë në rastin tim. Njerëzit që e njihnin familjen tonë, e dinin se si sillej im shoq. Por ata kurrë nuk ndërhyjnë, për shkak të mentalitetit se një grua duhet të jetë e durueshme."

Dhuna në familje duhet trajtuar njësoj si dhuna fizike e shkaktuar nga dhunues të huaj. Megjithatë, faktikisht kjo nuk ka ndodhur. Ndodh shumë shpesh që policët nuk veprojnë ose nuk e konsiderojnë situatën seriozisht, me justifikimin se dhuna në familje është një çështje private, në të cilën ata nuk duhet të ndërhyjnë. Ariola, një grua e divorcuar me një fëmijë tregon: "Me thënë të vërtetën, policët nuk më kanë ndihmuar aspak. Njëherë unë u largova nga shtëpia dhe shkova me gjithë djalin në polici. Unë ika nga shtëpia se im shoq donte të më vriste mua dhe djalin. Unë shkova në polici për të raportuar situatën, por ata nuk u dukën. Ata e mbajtën shënim emrin dhe adresën, por nuk erdhën asnjëherë. Ishte një situatë e tmerrshme. Ata duhet të kishin ardhur ta arrestonin atë, por nuk e bënë. Gratë nuk kanë ku të shkojnë kur ndodhen në situata të

tilla të ngajshme, për to nuk ka strehëza, mbështetje financiare, mundësi për punë." Një grua tjetër, mësuese dhe nënë me një fëmijë tregon: "Për mbrojtjen e grave duhet të ketë më shumë ligje. Unë mendoj se policët duhet të jenë më proaktivë, ata duhet ta arrestojnë një burrë që është i dhunshëm dhe ta mbajnë atë në polici të paktën për disa ditë."

Jo vetëm që policët nuk e kuptojnë dhunën në familje si krim, por gratë përmendin edhe barriera procedurale. Një grua 36 vjeçare, nënë me tre fëmijë thotë: "Në Shqipëri ligji nuk ekziston. Unë e kam denoncuar atë më shumë se 10 herë dhe ata akoma nuk e kanë dënuar sepse nuk ka dëshmitarë. Unë kam dëshmitarë, por ata nuk dalin të dëshmojnë se kanë frikë. Pse nuk pranon ligji të dëgjojë zërin tim dhe të fëmijëve të mi? Pse nuk konsiderohemi në dëshmitarë?"

Nuk është e çuditshme që shumë gra në studimin tonë, kanë vuajtur në heshtje duke qënë se kanë parë pak mundësi për ta thyer heshtjen. Sipas një gruaje 46 vjeçare, punëtore nga Tirana, "Këtu nuk ka ligje për mbrojtjen e grave. Në Shqipëri ligjin e bën paraja. Kush ka paranë, ka edhe fuqinë, dhe mund të të nxjerrë jashtë nga shtëpia. Megjithatë, gratë shqipëtare duhet të binden." Shumë nga të intervistuarat ndjehen të injoruara dhe të abandonuara nga shoqëria. Një grua e papunë nga Shkodra, nënë e tre fëmijëve, ve në dukje: "Shoqëria duhet të bëjë shumë më tepër për të zgjidhur problemin e dhunës në familje. Duhet të ketë më shumë ligje në mbrojtje të grave. Shoqëria nuk më ofroi mua ndonjë përkrahje, po ashtu edhe familja ime. E ku të shkojë atëherë një grua e abuzuar? Unë nuk kam ku të shkoj. Kam mbetur në shtëpi e detyruar të duroj dhunën. Për një grua si unë me tre fëmijë, nuk ka mundësi për punë, prandaj unë nuk kam kurajo ta divorcoj, sepse nuk gëzoj pavarësi ekonomike për të ushqyer fëmijët e mi. Mundësitë e punësimit për gratë e divorcuara janë shumë të domosdoeshme."

Vështirësi të tjera lidhen me shërbimin shëndetsor të pa përshtatshëm. Shumë gra të dhunuara mund të jenë të detyruara që të shkojnë tek mjeku në klinikë ose tek urgjenca e spitalit. Mjekët janë profesionalë në ndihmën që i sigurojnë ature për mjekimin e plagëve. Po ndihma mbaron me aq. Vetëm dy gra përmendin

se mjekët i kishin referuar tek qendra e këshillimit për gratë. Punonjësit e shërbimit shëndetsor kanë përgjegjësi ndaj viktimave të dhunës në familje. Duke qënë profesionistë, ata duhet të jenë të ndërgjegjshëm për rolin që mund të luajë abuzimi në disa nga problemet e shëndetit emocional. Një punëtore 37 vjeçare nga Berati ve në dukje: “Unë kisha shqetësime emocionale çdo ditë. Edhe tani që nuk jetoj më me të, unë paguaj pasojat e atyre ditëve. Kam dhimbje të tmerrshme të kokës, kam vështirësi që të më zerë gjumi, kam makthe. Doktorit më ka dhënë valium, librium dhe atenonol.”

Në shumicën e rasteve dhënia e medikamenteve psikotropikë nuk është e përshtatshme. Punonjësit e shëndetit duhet të kuptojnë se gratë e dhunuara nuk kanë probleme të shëndetit mendor, dhe nuk duhet të trajtohen si të tilla. Simptomat emocionale të grave janë shpesh herë shenja të një regaimi të shëndetshëm përkundrejt rrethanave të pashëndetshme të jetës së tyre. Efektet afatshkurtëra dhe afatgjata të qetësuesve nuk duhen neglizhuar. Përveç frikës së varësisë, qetësuesit krijojnë pasivitet dhe kufizojnë aftësinë e gruas për të vepruar me qartësi. Punonjësit e shëndetsisë duhet t’u sigurojnë grave informacion për mundësitë dhe burimet e ndihmës, (qendra këshillimi, strehëza) dhe t’u krijojnë mundësi kontaktimi me individë dhe grupe të specializuara për trajtimin e problemeve të dhunës. Vihet në dukje se ka nevojë urgjente për programe trajnimi dhe sensibilizimi për punonjësit e shëndetësisë për dhunën në familje.

Toleranca sociale për dhunën në familje reflektohet në besimin e vazhdueshëm se dhuna midis partnerëve është një çështje private. Ndërkohë që një numër i madh i të

intervistuarave e kuptonin dhunën në familje si një çështje publike, gjashtë të intervistuarave nga 55, deklaruan se kjo ishte një çështje private. Një grua nga Berati thotë: “Dhuna nuk është punë e botës, është problem i familjes dhe i të afërmeve. Për zgjidhjen e problemit është përgjegjës vetë çifti. Policia nuk ka të drejtë të ndërhyjë. Vërtet im shoq më rreh mua shpesh, por fëmijët ndërhyjnë dhe ai ndryshon. Bota nuk ka punë me problemet e familjes time.”

Duke dashur që të ndihmojnë në thyerjen e heshtjes për dhunën në familje, gratë japin sugjerime për rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë. Një grua 38 vjeçare, ekonomiste, nënë me një fëmijë thotë: “Institucionet shtetërore bashkë me OJQ-të, duhet të angazhohen më tepër për luftën kundër dhunës në familje. Është shumë e rëndësishme që t’i bësh gratë të ndërgjegjshme se duhet të luftojnë kundër dhunës. Gratë duhet të fuqizohen që ta ndejnë se ato mund të kontribuojnë në zgjidhjen e problemit. Së dyti, unë mendoj se është shumë e rëndësishme që të hartohen programe për burrat në lidhje me këtë çështje. Duhet të organizohen diskutime midis burrave dhe grave. Për zgjidhjen e këtij problemi ka shumë mënyra.”

Është shumë e rëndësishme që në çdo shoqëri, të thyes heshtja e thellë që mbulon çështjen e dhunës në familje, si dhe të njihet shtrirja e gjërë e problemit si dhe thellësia e dhimbjes së fshehur të viktimave. Le të shpresojmë se me kalimin e viteve, gratë që flasin njëzëri për dhunën në familje dhe patriarkalitetin, do të bëjnë të mundur që të rritet vëmendja sociale, gjë që do të rezultojë në bërjen e ndryshimeve të normave kulturore, ligjeve dhe politikave sociale, që do të përmbushnin nevojat e grave të dhunuara.



KONKLUZIONE

Ky studim është një studim cilësor i hartuar për të zbuluar perceptimet, besimet, qëndrimet dhe sjelljet e grave të dhunuara shqipëtare, si dhe pasojat dhe mënyrat e përdorura për të përballuar dhunën në familje. Fokusi kryesor i kësaj punë ishte “t’i jepej zë” grave të abuzuara që të shprehnin problemet me fjalët e tyre. Për arsye se ku vlerësim cilësor nuk prezanton statistikisht të gjithë Shqipërinë, konkluzionet kufizohen për grupin e investiguar. Të dhënat zbulojnë kuptimin e dhunës nga këndvështrimi i grave të abuzuara të intervistuar. Intervistat e thelluara u përqëndruan në tre zona të ndryshme të Shqipërisë, dhe u realizuan me 55 gra të abuzuara të moshës, rrethanave social-ekonomike dhe prejardhjes kulturore të ndryshme. Një nga pikat e forta të kësaj analize narrative, është mundësia që ajo siguron për njohjen e kontekstit kulturor në të cilin ndodhin abuzimet.

Studimi sugjeron se ekziston një ndërthurje komplekse e faktorëve kulturorë, socialë, ekonomikë dhe ndërpersonalë, që mund t’i venë gratë Shqipëtare përpara rizikut të dhunës. Përfundimet e mohojnë mitin se dhuna në familje është kryesisht problem i njerëzve të varfër dhe të pashkolluar, dhe vërteton se abuzimi i kapërcen kufijtë social-ekonomikë. Dëshmitë në këtë raport sugjerojnë se marrëdhëniet tradicionale gjinore u kushtojnë shumë shtrenjt grave. Megjithëse në vitet e fundit në Shqipëri kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme, vendi akoma nuk ka mundur të shkulë qëndrimet e rrënjësura thellë në lidhje me statusin e ulët të gruas. Intervistat identifikuan tragjeditë atafgjata që kanë tejshkuar jetët e grave, disa prej të cilave janë vrarë nga dhimbja e fshehur, por gjithashtu bënë të ditur edhe rezistencën e bërë nga shumë prej tyre.

Vlerat tradicionale i shtojnë shumë gra që ta

kuptojnë martesën si qëllimin më të rëndësishëm të jetës së tyre. Gratë presin që nëpërmjet martesës të arrijnë kushtet e dëshirueshme sociale, dhe një jetë të vlëfshme. Gratë e shohin martesën si një element kyç për identitetin e gruas. Gratë akoma përmendin traditat patriarkale të martesave me shkes nga një autoritet mashkullor. Martesa kuptohet gjithashtu edhe si një mënyrë për t’u larguar nga varfëria dhe/ose mjedisi abuziv i familjes.

Ëndrat e grave për martesën shpesh kontradiktohen nga realiteti i jetës së përditshme, dhe nga statusi i tyre i ulët në martesë. Studimi tregon se abuzimi në marrëdhëniet midis partnerëve ka më shumë gjasa të ndodhë dhe të vazhdojë, kur çifti, veçanërisht burri, është mbartës i qëndrimeve tradicionale përkundrejt roleve familjare. Përfundimet vërtetojnë se burrat abuzivë janë dominantë në procesin e marrjes së vendimeve të familjes, ndërsa nga gratë kërkohet që të marrin përsipër përgjegjësitë për punët e shtëpisë dhe kujdesin ndaj fëmijëve. Edhe kur gruaja ndodhet në nivel të lartë profesional dhe social, ajo nuk përjashtohet nga detyrimi i mbajtjes së barrës për të gjitha punët e shtëpisë. Gratë duhet të përmbushin rolin e tyre si gra dhe nëna, dhe të jenë të përgatitura për të sakrifikuar edhe jetët e tyre për hatër të martesës. Partneriteti midis burrave dhe grave për përballimin e problemeve të jetës familjare, është i panjohur për shumë çifte shqipëare. Grave akoma u duhet të veprojnë sipas normave të përcaktuara nga burrat.

Kundërshtimi i roleve dhe i pritshmërive gjinore tradicionale, sjell si rezultat abuzimin fizik dhe psikologjik. Abuzimi në çift në përgjithësi, është më tepër pjesë e një modeli sjelljeje abuzive dhe kontrolli, se sa akt i veçuar agresioni fizik. Rëfimet e grave, kanë vërtetuar se abuzimi në familje është një fenomen kompleks, dhe përfshin forma të ndryshme si verbale, emocionale, fizike, seksuale dhe ekonomike. Dhuna fizike e ushtruar ndaj grave varion nga

një shpullë e deri tek goditja me armë. Ky studim tregon se për gratë shqipëtare ekziston mundësia e rezikut nga akte dhune vdekjeprurëse. Gratë përmendin se u kanë thyer krahët, u kanë djegur trupin me cigare, u kanë drejtuar armën në kokë dhe i kanë kërcënuar me thika e granata. Shumë gra jetojnë me frikë jo vetëm për jetën e tyre, por edhe për atë të fëmijëve, familjes dhe miqve.

Përvoja e grave me dhunën seksuale varion nga rrahjet, përdhunimi dhe keqtrajtimi, e deri tek kërcënimet, poshtërimi verbal, dhe forma jo-fizike të presionit për marrëdhënie seksuale kundër vullnetit të tyre. Pranimi për seks kundër dëshirës për disa gra, kuptohet si mënyrë për të ndaluar zemërimin e burrit, dhe për të shmangur dhunën e mëtejshme. Disa gra ndjehen të detyruara për të përmbushur detyrën dhe për t'i shërbyer nevojave të burrit, pavarësisht dëshirave të tyre. Aktet seksuale me dhunë, rezultojnë se janë një nga mënyrat më të cilën gruaja qëndron e heshtur, e kontrolluar dhe e nënshtruar.

Gratë përmendin shpesh poshtërimin dhe manipulimin emocional. Izolimi social përmendet gjithashtu si një strategji që përdoret nga përtnerët abuzivë, për të rritur kontrollin dhe për të zvogëluar aftësinë e grave për t'u shkëputur nga marrëdhënia abuzive. Disa nga burrat abuzivë, i ndalojnë gratë që të marrin pjesë në marrjen e vendimeve për shpenzimin e parave, ose refuzojnë t'i japin grave para për nevojat themelore të shtëpisë. Kontributi ekonomik i grave në familje, nuk e zvogëlon apo influencon pozicionin dominues të burrave të tyre brenda familjes.

Përvojat e dhunës në familje, i venë gratë përballë rezikut të shumë problemeve të shëndetit mendor dhe fizik si plagosjet, depresioni, ankthi, shqetësime të stresit post-traumatik, pagjumësi, vetëvlerësim të ulët dhe mendim për vetëvrasje. Plagosjet nuk janë e vetmja pasojë e dhunës fizike: plagë, dështime, lindje të parakohëshme dhe shtatzani të padëshiruara, janë disa nga pasojat e rënda të dhunës fizike, që grave u duhet të përballojnë. Në pasojat e dhunës përfshihen edhe paaftësia për të kryer punë të përditshme si dhe aktivitete sociale.

Gratë mendojnë se pasojat psikologjike të abuzimit, janë edhe më serioze se efektet fizike. Kur gratë ndjehen të konsumuara nga përdorimi i strategjive të tyre personale, ato i drejtohen mjekimeve të cilat shpesh i perceptojnë si mbrojtëse nga ndodhitë traumatike. Përfundimet ilustrojnë procesin gjatë të cilit gratë demoralizohen dhe bien në kurthin e marrëdhënieve abuzive. Procesi i abuzimit u shndëron atyre mendimin për veten, për marrëdhëniet e tyre, dhe për vendin që u takon në shoqëri.

Dhuna në familje efektin thellë fëmijët, pavarësisht nëse ata pësojnë dhunë fizike apo jo. Fëmijët e grave pjesëmarrëse në këtë studim shfaqin probleme të sjelljes, emocionale dhe somatike. Përveç të tjerash, gratë përmendin nivel të ulët të kompetencës sociale dhe rezultateve në shkollë, ankth, acarim dhe sjellje agresive, dhimbje koke, urinim në krevat dhe shqetësime të gjumit. Gratë gjithashtu shprehin shqetësim në lidhje me efektet që mund të ketë modeli i babait në zhvillimin e fëmijëve.

Një hap i rëndësishëm për të përballuar dhunën, është kuptimi i shkaqeve të saj. Megjithatë të intervistuarat identifikojnë shkaqe të shumfishta të dhunës në familje, shumica e tyre e përshkruajnë atë si problem social që ka ardhur si rrjedhojë e shoqërisë të paekuilibruar, që ndodhet midis traditës dhe modernes. Arsyeja kryesore e dhunës në familje është varfëria, e cila gjeneron tek burrat stres dhe ndjenjë e paaftësisë për sigurimin e bukës së familjes, që është edhe roli i tyre tradicional. Shkaqe të tjera të dhunës në familje që janë përmendur shpesh, janë abuzimi me alkoolin nga ana e abuzuesit si dhe xhelozia. Dhuna në familje kuptohet gjithashtu edhe si produkt i çrregullimeve emocionale të burrave si depresioni dhe vetëvlerësimi i ulët. Ky fokus në shkaqet emocionale të dhunës në nivel individual, krijon justifikim për aktet e dhunshme, që mendohet se ndodhin nga mungesa e kontrollit të abuzuesit. Të tjera gra mendojnë se burrat janë nga natyra genie njerzore agresive. Disa gra bëjnë me faj veten e tyre, pasi mendojnë se ato kanë dështuar në përmbushjen e rolit të tyre si bashkëshorte dhe nëna. Rëfimet e grave reflektojnë se gratë janë pajtuar me faktin se ato duhet të pranojnë përgjegjësinë kryesore për suksesin e martesës

së tyre, si dhe për kujdesin dhe mirëritjen e fëmijëve. Ato besojnë se duhet të sakrifikojnë edhe të drejtat e tyre, për hatër të fëmijëve. Ky lloj qëndrimi ka përfshirë shumë gra në marrëdhënie abuzive për shkak të qëllimit të tyre për të ruajtur familjen me çdo mënyrë. Gratë përmendin shpresën, shmangien, kompromisin dhe arsyetimin e abuzimit duke e parë situatën nga një këndvështrim tjetër, si strategji që i kanë ndihmuar ato për të përballuar dhunën.

Strategji kyçe për eliminimin e dhunës është ndërgjegjësimi i grave se situata që po kalojnë është e gabuar, dhe se ato mund të ndërmarin hapa për përmirësimin e jetës së tyre. Divorci është një nga strategjitë aktive të përmendura nga gratë. Pavarësisht disa pengesave, gratë e divorcuara nuk kanë pranuar të jenë viktima pasive të dhunës në familje. Gratë përmendin përfitimin që kanë patur nga divorci prej partnerit abuziv. Pjesëmarrëset përmendin se ato kanë fituar dinjitetin e tyre, ndjenjën e vetëvlerësimit, dhe kontrollin personal të jetës së tyre. Gratë përpiqen shumë për të fuqizuar veten, në mënyrë që të gjejnë mënyra të reja jetese si dhe vendin e tyre në shoqëri.

Rëfimet e grave hedhin dritë mbi tolerancën kulturore dhe sociale për dhunën në familje. Thyerja e heshtjes që rrethon këtë problem të ndjeshëm, nxjerr në pah shtrirjen e gjërë të dhunës në familje dhe pasojat e rënda të saj. Përfundimet e studimit venë në dukje edhe

dëshirën e grave për të fuqizuar nëpërmjet rëfimeve të tyre, viktima të tjera të dhunës. Gratë shpresojnë se deklaratimet e tyre kundër dhunës në familje, do të krijojnë mundësi për ndryshime në normat kulturore, në ligjet dhe politikat sociale për mbrojtjen e të drejtave të grave. Megjithatë, gratë në Shqipëri nuk duhet të presin që shteti të ketë rol kryesor në trajtimin e këtyre problemeve kritike – janë vetë gratë, në nivelin e shoqërisë civile, që duhet të udhëheqin betejën për vetveten.

Përgjigjet e grave në këtë studim, sqarojnë se në përpjekjet për të mbrojtur thelbin e identitetit të tyre, dhuna shkatëron kapacitetin e tyre emocional dhe fizik. Për kapërcimin e këtyre ndjenjave negative, dhe për të rigjetur vendin e tyre në shoqëri, gratë e abuzuara kanë nevojë për këshillim profesional. Përfundimet e studimit venë në dukje nevojën për ndryshime në politikat sociale që ruajnë fuqinë gjinore, si në sferën publike të jetës ashtu edhe në atë private.

Ky raport përfaqëson një hap përpara në drejtim të dëgjimit të zërit të grave shqipëtare, dhe inkurajimit për fuqizimin e tyre. Ne parashikojmë se procesi i njohjes së domethënies lokale kulturore të dhunës në familje, dhe perceptimeve individuale, qëndrimeve dhe reagimeve përkundrejt tyre, mund të përdoren si baza shkencore për hartimin e ndërhyrjeve të duhura, për zvogëlimin dhe parandalimin e dhunës në Shqipëri.

dhuna ndaj grave

dhuna ndaj grave në familje në shqipëri

ndaj grave

SHTOJCA 1

Profili i të intervistuarave

1	2	3	4	5	6	7	8
1	21	Tiranë	Bashkëjeton.	Universitet	Mësuessa	1	Ortodokse
2	50	Berat	E divorcuar	Universitet	Farmaceute	1	Muslimane
3	37	Tiranë	E divorcuar	8 vjeçar	E papunë	2	Muslimane
4	52	Berat	E martuar	8 vjeçar	E vetëpunësoar	1	Muslimane
5	27	Tiranë	E divorcuar	8 vjeçar	Punëtore	3	Muslimane
6	28	Tiranë	E martuar	8 vjeçar	E vetëpunësoar	2	Muslimane
7	21	Tiranë	E fejuar	8 vjeçar	E papunë	1	Muslimane
8	31	Tiranë	E divorcuar	Universitet	Mësuessa	1	Katolike
9	38	Tiranë	E divorcuar	8 vjeçar	E papunë	3	Ortodokse
10	44	Berat	E martuar	8 vjeçar	E papunë	3	Muslimane
11	20	Tiranë	E divorcuar	8 vjeçar	E papunë	0	Muslimane
12	52	Tiranë	E martuar	Universitet	Ekonomiste	1	Muslimane
13	48	Tiranë	E martuar	8 vjeçar	E punësoar	2	Muslimane
14	23	Shkodër	E martuar	8 vjeçar	E papunë	2	Muslimane
15	37	Shkodër	E martuar	1 mesëm	Mëpunëso	2	Ortodokse
16	35	Shkodër	E divorcuar	8 vjeçar	Punëtore	1	Katolike
17	37	Shkodër	E divorcuar	8 vjeçar	E vetëpunësoar	3	Muslimane
18	34	Tiranë	E divorcuar	8 vjeçar	Pastruese	2	Muslimane
19	33	Shkodër	E divorcuar	Universitet	Juriste	2	Muslimane
20	55	Tiranë	E divorcuar	8 vjeçar	E papunë	3	Katolike
21	35	Tiranë	E divorcuar	Universitet	Mësuessa	1	Muslimane
22	38	Shkodër	E martuar	8 vjeçar	Punëtore	3	Ortodokse
23	43	Berat	E martuar	8 vjeçar	Punëtore	3	Muslimane
24	25	Shkodër	E martuar	8 vjeçar	Punëtore	3	Katolike
25	54	Berat	E ve	Universitet	Mjekë	2	Ortodokse
26	40	Berat	E martuar	1 mesëm	Electricite	3	Ortodokse
27	33	Berat	E martuar	1 mesëm	Punëtore	2	Muslimane
28	34	Tiranë	E martuar	8 vjeçar	Punëtore	1	Muslimane
29	32	Berat	E divorcuar	Universitet	Mësuessa	2	Ortodokse
30	27	Tiranë	E martuar	8 vjeçar	E papunë	3	Muslimane
31	39	Tiranë	E divorcuar	Universitet	E papunë	2	Ortodokse
32	39	Berat	E martuar	Universitet	Mësuessa	2	Katolike
33	38	Berat	E divorcuar	1 mesëm	Punëtore	1	Muslimane
34	42	Tiranë	E martuar	1 mesëm	Pastruese	5	Muslimane
35	46	Tiranë	E martuar	1 mesëm	Punëtore	2	Katolike
36	37	Shkodër	E martuar	Universitet	Ekonomiste	1	Muslimane
37	28	Tiranë	E divorcuar	8 vjeçar	E papunë	1	Ortodokse
38	31	Tiranë	E martuar	8 vjeçar	Punëtore	3	Katolike
39	37	Berat	E martuar	Fllor	Punëtore	5	Muslimane
40	22	Tiranë	E divorcuar	1 mesëm	Kuzhinere	1	Muslimane
41	18	Tiranë	Bashkëjeton	8 vjeçar	E papunë	1	Katolike
42	44	Tiranë	E divorcuar	Fllor	Punëtore	5	Ortodokse
43	30	Tiranë	E divorcuar	8 vjeçar	Punëtore	4	Muslimane
44	41	Tiranë	E martuar	1 mesëm	E papunë	2	Katolike
45	30	Tiranë	E martuar	1 mesëm	Punëtore	2	Muslimane
46	30	Tiranë	E martuar	1 mesëm	Punëtore	2	Ortodokse
47	28	Shkodër	E martuar	1 mesëm	E papunë	2	Muslimane
48	35	Shkodër	E martuar	1 mesëm	Angjendarë	2	Muslimane
49	34	Shkodër	E martuar	8 vjeçar	E papunë	3	Muslimane
50	19	Shkodër	E fejuar	Universitet	Studente	0	Muslimane
51	34	Shkodër	E martuar	1 mesëm	Mëpunëso	2	Muslimane
52	35	Berat	E martuar	1 mesëm	Punëtore	2	Muslimane
53	31	Berat	E martuar	1 mesëm	Lezoreme	3	Muslimane
54	32	Berat	E martuar	1 mesëm	Punëtore	3	Muslimane
55	67	Tiranë	E ve	Fllor	Vetë punësoar	6	Muslimane

***Në shqipëri: Shkolla 8 vjeçare quhet nga klasa e 5-të në të 8-tën, dhe shkolla e mesme quhet nga klasa e 9-të në të 12-tën.

dhuna ndaj grave

dhuna ndaj grave në familjenë shqipëri

ndaj grave

BIBLIOGRAFIA

- Atlas.ti (1997) *Analiza e të dhënave cilësore, Menaxhimi dhe krijimi i modeleve. Manuali i përdoruesit*. Scientific Software Development, Berlin.
- Shoqata e Grave Refleksione, Raporti (1996) *Dhuna ndaj grave*. Tiranë.
- Baban, A. (2000) Intervista dhe vëzhgime në studimet cilësore. *Cognition, Brain and Behavior*, 4: 317-328.
- Baban, A. (2002) *Metodat e studimit cilësor*. University Press, Cluj.
- Charmaz, K. (1999) *Teoria Grounded*. In J.A. Smith dhe R. Harre (Eds.), *Metoda të rimenduarit në psikologji*, Sage: London.
- De Soto, H., Gordon, P., Gedeshi, I. dhe Sinoimeri, Z. (2002) *Varfëria në Shqipëri; Vlerësim cilësor*. Raport i Bankës Botërore, Washington, D.C.
- Gelles, R. (1997) *Dhuna intime në familje*. Sage: Thousand Oaks, CA.
- Gjipali, S. dhe Ruci, L. (1994) Gratë shqipëtare: Hezitime dhe Perspektiva. *Fitore dhe Humbje: Gratë dhe tranzicioni në Europën Lindore dhe Qëndrore*, Bukuresht.
- Kligman, G. (1996) *Gratë dhe negocijimi i identitetit në Europën Lindore post-komuniste*
In V. Bonnel (ed.) *Identitete në tranzicion: Europa Lindore dhe Russia Pas rëzimit të Komunizmit*. Studime Ndërkombëtare dhe të Rajonit: Berkeley, CA.
- Kvale, S. (1996) *Intervista: Prezantim me intervistat e studimit cilësor*. Sage: Thousand Oaks, CA.
- Lawson, C.W. and Saltmarsh, D.K. (2002) Psikologjia e transformacionit ekonomik: Ndikimi i tregut në institucionet sociale, Statusi dhe vlerat e një fshati të Shqipërisë së Veriut. *Revista e psikologjisë ekonomike* 23: 487-500.
- Mills, L. (1996) Fuqizimi transnacional i grave të dhunuara: Rasti i ndërhyrjeve post – moderne. *Punë sociale* 46 (3): 261-268.
- Raporti i 'Mbrotësve për të drejtat e njeriut të Minesotës' (1996) *Dhuna në familje në Shqipëri*. Minneapolis, MN.
- Parker, I. (1992) *Dinamikat e bashkëbisedimit: Analiza kritike për psikologjinë sociale dhe individuale*, Routledge: London.
- Report për popullsinë (1999) *Ndalimi i dhunës ndaj grave*, vol. XXVII (4), New York.
- Raporti i Save the Children (2001) *Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri*, Tiranë.
- Smith, J.A. (1999) *Intervistat gjysëm të strukturuar dhe analiza e të dhënave cilësore*, në J.A. Smith dhe R. Harre (Eds.), *Metodat e të rimenduarit në psikologji*, London: Sage.
- UNICEF (2000) Qendra për studime Innocenti, *Dhuna në familje ndaj grave*, Innocenti Digest.
- Raporti i UNICEF (2000a) *Hartimi i informacionit ekzistues për dhunën në familje në Shqipëri*, Tiranë.
- Raporti i UNICEF (2000b) *Multiple Indicator Cluster Survey Report*, Tiranë.
- Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (1993) *Deklarata për eliminimin e dhunës ndaj grave*. Rezultatet e takimit plenar të 85-të. Dhjetor 20, Gjenevë.
- Kombet e Bashkuara-ACER (2002) Vlerësimi i përgjithshëm i vendit - *Shqipëria*. Tirana
- Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (2000) *Raporti i Zhvillimit Njerëzor: Shqipëria 2000*. Tiranë.
- Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - HDPC (2002) *Raporti i Zhvillimit Njerëzor: Shqipëria 2002*. Tiranë.
- Van Hook, M., Haxhiymeri, E. dhe Gjermani, E. (2000) Në përgjigje të dhunës gjinore në Shqipëri. *International Social Work* 43 (3): 351-363.
- Wolcott, H. (1994) *Transformimi i të dhënave cilësore: Përshkrimi, Analiza dhe Interpretimi*. Sage: Thousand Oaks, CA.
- Raporti i Bankës Botërore (2002a) *Tranzicioni, dhjetë vitet e para: Analizë dhe mësim për Europën Lindore dhe ish Bashkimin Sovjetik*. World Bank, Washington, D.C.
- Raporti i Bankës Botërore (2002b) *Gjinia në tranzicion*. World Bank, Washington, D.C.

